



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE**

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ___/___/2025

V E N D I M

PËR SUBJEKTIN E VLERËSIMIT MITHAT TOLA

Nr. 1, datë 20.01.2025

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Henri Naqellari	Kryesues
Edona Dushaj	Relatore
Ornela Dyli	Anëtare

Asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga anëtare e Sekretariatit Teknik, znj. Ersila Kalaja, në datën 20.01.2025 ora 10:00, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket

SUBJEKTI I VLERËSIMIT: **Mithat Fari Tola**, me funksion aktual, Pedagog, në Departamentin e Ruajtjes dhe Sigurisë Publike, në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, në Akademinë e Sigurisë.

OBJEKTI: Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Ligji nr. 12/2018** “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.




TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoi relatimin e relatores së çështjes Edona Dushaj; dëgjoi subjektin e vlerësimit, z. Mithat Tola, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 27.12.2024, kërkoi konfirmimin e tij në detyrën e Drejtorit të Kabinetit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në tre kriteret e vlerësimit të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4, të ligjit 12/2018, i ndryshuar,





V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të neneve 2, 4 dhe 6 të Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, shtetasi Z. Mithat Tola është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit të parë datë 07.04.2023 si Drejtor i Kolegjit Profesional i Formimit Policor - Akademia e Sigurisë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
3. Subjekti i vlerësimit, **Z. Mithat Tola** iu nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar 04.07.2023, nga Trupat e Vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.7 datë 17.01.2023, “Për procedurat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit sipas ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar”.
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga: Znj. Edona Dushaj, **Relatore**, Z. Henri Naqellari, **Kryesues** dhe Znj. Ornela Dyli, **Anëtar**.
5. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr.197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”, me Vendimin datë 05.07.2023, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Mithat Tola.



6. Relatorja e çështjes, Znj. Edona Dushaj, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 28.07.2023 ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.
7. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore në datën 28.07.2023 duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.
8. Relatorja e çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
9. Në vijim të procesit të mbështetur në nenet 33/1, nenin 42, nenin 46 të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, relatori i çështjes ka dërguar pranë institucioneve ndihmëse deklaratimet e subjektit të vlerësimit, si më poshtë vijon:
 - a. me shkresën nr. *** prot, datë 19.04.2023, ka dërgua pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin shoqërues;
 - b. me shkresën nr.*** prot, datë 19.04.2023, ka dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit deklaratën e vlerësimit të aftësive profesionale;
 - c. me shkresën nr. *** prot, datë 19.04.2023, ka dërguar pranë Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit, në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, deklaratën e kontrollit të figurës.
10. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
11. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:
 -  vlerësimin e pasurisë;
 -  kontrollin e figurës;
 -  vlerësimin e aftësive profesionale.
12. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:
 - a. Ligji nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar.
 - b. Ligji nr.128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”
 - c. Ligji nr.40/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”
 - d. Ligji nr.49/2012 “Për gjykatën Administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”
 - e. Ligji nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”

- f. Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7, datë 17.01.2023 “Për procedurat e hedhjes së shortit”
- g. Rregulloren nr.197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar” duke verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht deklaratat e dorëzuara nga vetë subjekti i vlerësimit që janë:

-  *Deklarata e Pasurisë,*
-  *Deklarata për Kontrollin e Figurës,*
-  *Formulari i Vlerësimit Profesional*
-  *Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet,*

- h. Raportet përmbledhëse të ILDKPKI-së, Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit në AMP, dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- i. Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar.
- j. Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.
- k. ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.

13. Trupa e vlerësimit, më datë 19.12.2023, pasi dëgjoi relatorin, dhe krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Mithat Tola, me Vendimin nr. 05, datë 19.12.2023 vendosi;

- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Mithat Tola;
- b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 -  *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*
 -  *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;*
- c. Të ftojë subjektin për t’u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme , prej 5 ditëve për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

14. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5 i Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, si dhe nenit 34, pika 1, e Ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.

15. Në datën 29.01.2024, trupa e vlerësimit, njoftoi subjektin e vlerësimit për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 02.02.2024 ora 10:30, në ambiente e sallës së mbledhjes së Ministrisë së Brendshme, në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit z. Mithat Tola, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar si dhe Kodin e Procedurave Administrative. Subjekti i vlerësimit kishte zgjedhur të mos përfaqësohej me mbrojtës ligjor në këtë seancë. Në fund të seancës dëgjimore të datës 27.12.2024, subjekti i vlerësimi z. Mithat Tola kërkoi konfirmimin në detyrë. Në datën 20.01.2025, trupa e vlerësimit shpalli vendimin.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

Me subjektin e vlerësimit është komunikuar me anë të postës elektronike, duke i bërë pyetje dhe kërkuar sqarime, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave. Subjekti i vlerësimit z. Mithat Tola, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të vlerësimit, në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar. Subjekti i vlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë hetimit.

II. VLERËSIMI I PASURISË

16. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, dhe veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.
17. Në zbatim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit Z. Mithat Tola ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 07.03.2023. Formulari i Pasurisë ka nr.6 index, viti 2023 .
18. Procedurat e deklarinimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe 33 ndërsa vlerësimi i pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34 të ligjit 12/2018, i ndryshuar.
19. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridik, publikë apo privatë.
20. Gjithashtu Trupa e Vlerësimit ka mbajtur në konsideratë deklarinimet e dhëna nga subjekti për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së në zbatim të neneve 33/1 dhe 34 , shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare. Ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite,

burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.

21. Trupa e vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:

- ✚ deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur;
- ✚ raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI;
- ✚ provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;
- ✚ dokumentacionin e paraqitur në deklaratimet e subjektit, si përgjigje të pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike.

22. Hetimi administrativ konsistoi në:

- ✓ verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- ✓ verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- ✓ evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- ✓ evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

23. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja;

ILDKPKI-ja, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, ka dërguar një raport¹, të hollësishëm dhe të arsyetuar, bazuar në dokumentacionin e administruar, për subjektin e vlerësimit z. Mithat Tola, ku është konstatuar se:

- ✓ deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;
- ✓ nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- ✓ nuk është kryer fshehje e pasurisë;
- ✓ nuk është kryer deklarim i rremë;
- ✓ subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

A. PROCEDURA E VLERËSIMIT/HETIMIT E KRYER NGA TRUPA E VLERËSIMIT

24. Bazuar në nenin 34, të ligjit 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe

¹ Raporti nr. 41/55, datë 29.04.2024, i ILDKPKI-së.

Ankesave”, i ndryshuar, Trupa e Vlerësimit hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e vlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, (b) raportin/vlerësimin e kryer nga ILDKPKI; (c) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private sipas nenit 34 të ligjit 12/2018; (ç) deklaratimet e subjektit të vlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (d) shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit; (dh) deklaratimet në seancë dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

25. Trupa e Vlerësimit hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur, (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllimin evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (ik) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo ndonjë konflikti të interesit.

III. DEKLARIM I SUBJEKUTIT TË VLERËSIMIT, MITHAT FARI TOLA **DEKLARIMI I PASURIVE**

Subjekti i vlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë në zbatim të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si vijon:

Pasuria nr. 1

Apartament me sip. 57.7 m², Rr. "Llambro Rexha", Vlorë, përfituar nga këmbimi i apartamentit me sip. 60 m², Durrës (blerë në vitin 2007 me çmim 2.000.000 lekë). Vlera 2.000.000 lekë. Zotëron 50%.

Burimi i krijimit: kursimet familjare nga punësimi/ konsulencat/ licencat, si dhe hua nga motra e bashkëshortes (hua aktualisht e shlyer).

Vlera e apartamentit në momentin e këmbimit, sipas çmimeve minimale fiskale të zonës është vlerësuar 5.000.400 lekë, vlerë mbi të cilën është paguar tatimi për diferencën sipas legjislacionit në fuqi. Ap. në Vlorë, nuk është marrë ende në disponim e përdorim, për shkak të një konflikti gjyqësor në proces, midis pronarëve të truallit, ku është ndërtuar objekti.

Bashkëlidhur Deklaratës

- **Kontratë shkëmbimi** nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.6.2020, ku Mithat dhe Arjola Tola shkëmbejnë apartamentin me sip. 54 m², nr. pasurie ***, me apartamentin me sip. 57. m², nr. pasurie ***. Vlera e pasurive referuar çmimit të referencës është: për ap. 54 m² x 61.800 lekë/m²=3.343.380 lekë, ndërsa për ap.me sip. 57.70 m² x 61.800 lekë/m²=3.565.860 lekë. B/lidhur praktika.
- **Certifikatë për vërtetim pronësie** nr. ***, datë 14.7.2020, për apartament me sip. 57.7 m², nr. pasurie ***, Zk. ***, vol. ***, faqe ***, Rr. "****", Vlorë, në b/pronësi të Mithat dhe Arjola Tola.

- **Kartela e pasurisë së paluajtshme** për ap. me sip. 57.7 m2, nr. pasurie ***, Zk. ***, vol. ***, fq. ***, Rr. "**** " Vlorë, në b/pronësi të Mithat dhe Arjola Tola, me shënimin "përfitur me K.SHK".

Hetimi administrativ:

ASHK, Drejtoria Vendore Vlorë, me shkresë nr. ***prot., datë 9.10.2023, përcjell përgjigjen se për marrjen e shërbimit të kërkuar, duhet të aplikohet online.

ASHK, Drejtoria Vendore Durrës, me shkresë nr. ***prot, datë 29.12.2023, konfirmon se Mithat Tola dhe familjaret e tij, nuk kanë pasuri të regjistruara

ASHK,(online)konfirmon se Mithat Tola dhe Arjola Tola kanë në b/pronësi pasurinë nr.***, Zk. ***, vol. ***,fq. ***, Rr. "****".

Në proces-verbalin e datë 20.3.2024 mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se: *"...apartamenti në Durrës është blerë në vitin 2007, sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 11. 10.2007, me çmim 2.000.000 lekë, vlerë e cila është likuiduar me para në dorë, para lidhjes së kontratës, siç edhe është cituar edhe në kontratën e shitjes. Nuk kanë ruajtur mandate apo fatura, pasi pagesa është konfirmuar nga të dy palët në kontratën e shitjes. Në datë 7.12.2011, ap. është rivlerësuar në vlerën 5.040.000 lekë.*

Apartamenti me sip. 54 m2, i këmbyer në vitin 2020 me ap. me sip.57.7 m2, me të njëjtën adresë në Rr. "Llambro Rexha" Vlorë, ka si origjinë këmbimin e tij me ap. me sip. 60 m2, në Plazh, Durrës, sipas kontratës së këmbimit të vitit 2016. AP. me sip. 54 m2 në Vlorë, përfitur nga shkëmbimi në vitin 2016 dhe ap. me sip. 57. m2, rezultoni të okupuar dhe në përdorim nga një klient tjetër. Në momentin e këmbimit janë paguar detyrimet përkatëse mbi ndryshimin në sipërfaqe dhe vlerë.

*Apartamenti në qytetin e Vlorës, nuk është marrë ende në disponim e përdorim, për shkak të një konflikti të gjatë gjyqësor ende në proces, midis pronarëve të truallit, ku është ndërtuar objekti — Numri i Çështjes ***, datë 28.01.2022, në vijim të Vendimit Nr. *** i Regj. Themeltar Nr *** i Vendimit (***) të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë). Në këtë situatë, në pamundësi përdorimi të tij, në marrëveshje me palën shkëmbyese, palët do vazhdojnë të mbajnë në përdorim duke shlyer detyrimet për apartamentet përkatëse në pronësi të tyre, para shkëmbimit. Konkretisht, subjekti ka në përdorim apartamentin në Durrës, deri në përfundimin e proceseve gjyqësore dhe marrjen në dorëzim të ap. Objekt i kontratës së këmbimit. Burimi i krijimit të shumës 2.000.000 lekë, për blerjen e apartamentit në Plazh, Durrës, janë 1.000.000 lekë nga kursimet familjare nga të ardhurat në vite dhe vlera 1.000.000 lekë, pjesë e huasë prej 50.000 euro marrë nga motra e bashkëshortes, M.H, në vitin 2007, para blerjes së këtij apartamenti. 190 hua ka filluar të shlyhet nga viti 2008 deri në vitin 2014, periudhë gjatë të cilës, nuk ishte subjekt deklarues. Shlyerja e huasë është bërë me këste, sipas mundësive, me burim të ardhurat familjare dhe aktiviteti privat. Burimi financiar i motrës së bashkëshortes ishin të ardhura e saj nga punë të ndryshme e përkthime në Hamburg, Gjermani, pasi ajo ka jetuar dhe punuar atje prej vitit 1998 e në vijim, si dhe më pas nga aktiviteti i saj si person fizik.*

Lidhur me mënyrën e marrjes së shumës, subjekti sqaron se është sjellë nga vetë motra e bashkëshortes dhe familjarët e tyre, të cilët kanë udhëtuar në atë periudhë nga Hamburgu Gjermani për në Shqipëri.

Sqaron se shuma 50.000 euro është marrë për blerjen e apartamentit në Plazh, Durrës si dhe për blerjen e apartamentit në Kashar, Tiranë në fund të vitit 2007. Pas daljes në reformë dhe largimit nga puna në Policinë e Shtetit, ka kërkuar mënyra dhe forma për të siguruar të ardhura për familjen. Bashkëshortja e subjektit, si eksperte në tregun e Shitjes së sipërfaqeve ndërtimore ka sugjeruar blerjen e apartamentit në Kashar, Tiranë, pasi, në dijeninë e saj, çmimi i apartamenteve do vinte duke u rritur.

Lidhur me vlerën prej 2.000.000 lekë të blerjes së ap. në Plazh, Durrës, subjekti sqaron se është pothuajse i njëjtë me çmimet e shitjes së kohës për apartamentet në atë zonë. Subjekti ka siguruar një kontratë të të njëjtit shitës, e Cila është pothuajse me ato çmime me të cilat subjekti dhe b/shortja kanë blerë ap. e tyre në Plazh, Durrës. Në vitin 2011 kanë kryer rivlerësimin e këtij apartamenti, për ta sjellë në vlerën e tregut, dhe për këtë rivlerësim kanë paguar tatimin përkatës.

Shpenzimet për mobilimin e apartamentit në Durrës ishin rreth 300.000 lekë, mobilim i cili është kryer përgjatë viteve 2008 — 2010 dhe në mënyrë modeste, referuar banesës në plazh. Nuk disponon fatura për mobilimin.”

Subjekti paraqiti:

- **Kontratë Shitje** nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.10.2007, ku Mithat dhe Arjola Tola blejnë apartament me sip. 60 m², zk. ***, nr. pasurie ***, Durrës, Plazh, në vlerën 2.000.000 lekë, shumë e Cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale; Bashkëlidhur praktika;
- **Vërtetim nga dokumenti hipotekor**, datë 17.1.2012, që konfirmon se në regjistrin hipotekor me nr. 3011, datë 30. I I. 2007, figuron e regjistruar pasuria me nr. 58/64-ND + 1-14, zk. ***, apartament banimi me sip. 60 m², me adresë L.***, Plazh, ap.***, shk. ***,k. **, në pronësi të shtetasve Mithat Tola dhe Arjola Tola. Rivlerësuar në datë 7.12.2011 në shumën 5.040.000 lekë. Bashkëlidhur praktika;
- **Kontratë shkëmbimi pasuri e paluajtshme**, me nr. *** rep., dhe nr. ***kol, datë 22.4.2016, ku Mithat Tola dhe Arjola Tola shkëmbejnë ap. me sip. 60 m², nr. pasurie *** me ap. me sip. 54 m², nr. pasurie ***. Bashkëlidhur praktika;
- **Kontratë Shkëmbimi** nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 18.6.2020, ku Mithat Tola dhe Arjola Tola shkëmbejnë ap. me sip. 54 m², nr. pasurie ***me ap. me sip. 57.7 m² me nr. ***. Vlera e pasurive referuar çmimit të referencës është: për apartamentin 54 m² x 61.800 lekë/m² =3.343.380 lekë, ndërsa për apartamentin me sip. 57.70 m² x 61.800 lekë/m² =3.565.860 lekë. Bashkëlidhur praktika,
- **Formulari i llogaritjes së tatimit nga ASHK**, datë 18.6.2020 dhe mandat bankar nga BKT, datë 29.6.2020, për pagesën e tatimit, sipas kontratës së shkëmbimit me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 18.6.2020, në vlerën 33.472 lekë.
- **Vendim** me nr. *** i Reg). Themeltar nr. 00-2021-1935, i Vendimit (***) të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- **Deklaratë noteriale** nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 24.7.2019. nga M.H, motra e bashkëshortes, që deklaroi në përgjegjësi personale se "Unë M.H. me të ardhurat e mia të siguruar përgjatë viteve 2000-2009, fillimisht e punësuar dhe nga viti 2006 nga aktiviteti im privat në Hamburg — Gjermani, kam ndihmuar me një hua pa afat motrën time Arjola Tola (Tabaku) dhe bashkëshortin e saj Mithat Tola, në shumën prej 50.000 euro. për të plotësuar nevojat e tyre të familje. Gjithashtu deklaroi se kjo hua më është shlyer nga

familjarët e mi, motra dhe bashkëshorti i saj, në shuma të ndryshme, herë pas here, duke më likuiduar përfundimisht në muajin shtator 2014. Deklaroj se aktualisht nuk kanë detyrime të pashlyera ndaj meje. Për shkak të marrëdhënieve të ngushta familjare, në kohën e marrjes dhe shlyerjes së huasë, nuk kemi bërë ndonjë dokument shkresor në lidhje me marrjen dhe shlyerjen e kësaj huaje, ndaj kjo deklaratë bëhet sot, më datë 24.7.2019, me kërkesën e familjarëve të mi, për ta përdorur si të duan dhe kudo që atyre i 'u intereson ". Bashkëlidhur pasaporta Gjermane e shtetases M.H Tabaku.

- **Kopje e dëshmisë së të ardhurave dhe taksave**, lëshuar nga Zyra e Financës Hamburg Gjermani, që konfirmon se shtetasit M.H dhe J.H, për vitin 2007 kanë realizuar të ardhura vjetore bruto 74.049 euro dhe neto 62.709 euro. Kopje e dëshmisë së të ardhurave dhe taksave, lëshuar nga Zyra e Financave Hamburg Gjermani, që konfirmon se shtetasja M.H, për vitin 2008 ka realizuar të ardhura në shumën 36.099 euro.
- **Kopje e Pasaportës e Mithat Tola**, me nr. ID (***) . Kopje e Pasaportës e Arjola Tola, me nr. ID ***.
- **Certifikatën e Trungut Familjar**, datë 24.1.2024, të familjes së bashkëshortes, që i referohet gjendjes civile të vitit 1990, ku konfirmohet se Arjola Tabaku dhe S.T janë motra;
- **Certifikatë familjare** e M.T datë 24.1.2024, që i referohet certifikatës familjare të vitit ***, e Cila konfirmon ndryshimin e emrit nga S.T në M.T. Certifikatë personale, datë 24.1.2024, që konfirmon se M.H ka lënë shtetësinë shqiptare me Dekretin e Presidentit nr. ***, datë 3.10.2006.
- **Deklarim i të ardhurave dhe taksave**, lëshuar nga Zyra e Financës Hamburg Gjermani, që konfirmojnë të ardhurat e saj për vitin 2006, në shumën rreth 113.957 euro. Bashkëlidhur: dokumente justifikues që konfirmojnë të ardhurat e M.H pas vitit 2007 e në vijim, që vërtetojnë mundësitë e saj financiare për dhënien e huasë në vlerën e 50.000 euro.
- **Kontratë shitje** nr. *** rep., dhe nr. ***kol., datë 25.9.2007, për apartament me sip. 43 m2 (në të njëjtin pallat me subjektin), me çmim blerje 1.600.000 lekë;

Konstatohet:

- ✓ *Apartamenti me sip. 57.7 m2, në Vlorë, në b/pronësi të subjektit dhe b/shortes, është përfutuar nga shkëmbimi me apartamentin me sip. 54m2 në Vlorë, në v. 2020, ndërsa ky i fundit është shkëmbyer me apartamentin me sip. 60 m2, në Durrës, në v. 2016.*
- ✓ *Apartamenti me sip. 60 m2, Plazh, Durrës është përfutuar në v. 2007, me kontratë shitje në vlerën 2.000.000 lekë dhe rivlerësuar në vitin 2011, në vlerën 5.040.000 lekë. Subjekti ka dhënë shpjegime se burimi i krijimit të shumës 2.000.000 lekë janë kursime nga të ardhurat familjare, 1.000.000 lekë dhe huamarrja ndaj motrës së b/shortes, me banim në Hamburg, Gjermani në shumën 1.000.000 lekë. Subjekti ka dokumentuar të ardhurat familjare deri në vitin 2007, si dhe të ardhurat e motrës së b/shortes për burimin e krijimit të shumës 50.000 euro marrë hua në v. 2007. Huamarrja totale ka qenë në shumën 50.000 euro dhe është përdorur pjesërisht për blerjen e ap. në Durrës dhe pjesa tjetër për blerjen e ap. në Kashar. Shlyerja është bërë gjatë periudhës 2008 - 2014, me burim të ardhurat nga pagat dhe aktivitetet private familjare, të ardhura të cilat janë dokumentuar dhe konfirmuar nga sistemi bankar dhe organet tatimore.*
- ✓ *Në vitin 2016, ap. me sip. 60 m2, në Plazh, Durrës, është shkëmbyer me ap. me sip. 54 m2, në Vlorë, ndërsa në vitin 2020, ap. me sip. 54m2, në Vlorë është shkëmbyer me ap. me sip.57. 7 m2, me të njëjtën adresë, duke paguar detyrimet përkatëse mbi ndryshimin*

në sipërfaqe dhe vlerë, për këto apartamente. AP. me sip. 57.7 m2, Vlorë, rezulton i okupuar dhe në përdorim nga një klient tjetër, për shkak të një procesi gjyqësor me pronarin e truallit. Në marrëveshje me palën këmbyesi, subjekti vazhdon të ketë në posedim apartamentin në Durrës.

- ✓ *Subjekti ka dhënë shpjegime se mobilimi i ap. në Durrës ka qenë modest, si për një ap. plazhi dhe shpenzimet janë kryer gjatë viteve 2008 — 2010, në një shumë totale prej rreth 300.000 lekë.*
- ✓ *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar, shpjegimet e dhëna dhe ASHK online. Rezultojnë shpenzime mobilimi për apartamentin në Durrës, gjatë periudhës 2008 - 2010, në vlerën rreth 300.000 lekë.*
- ✓ *Dokumentacioni i burimit të financimit për blerjen e ap. me sip. 60m2, Durrës, si dhe shlyerjes së huasë në shumën 50.000 euro, gjatë periudhës 2008 - 2014, nga të ardhurat familjare dhe aktiviteti privat, trajtohet në vijim, në rubrikat përkatëse të të ardhurave.*

Pasuria nr. 2

Bashkëpronar me prindërit dhe vëllanë tim, i një shtëpie banimi, e ndërtuar në vitet 1992 — 1995, me sipërfaqe trualli 332.9 m2 dhe sipërfaqe ndërtese 136 m2. Adresa: Rruga "Imzot Mark Sopi" , Nr. ***, Tiranë.

Burimi i krijimit : Ndërtimi i vërtetuar me "Vendim Fakti" — Gjykata Tiranë, Nr. ***, viti 1995. Shtëpia është legalizuar në qershor 2013. Shtëpia është ndërtuar me të ardhurat e krijuara nga kursimet familjare (nëna, babai, vëllai dhe unë) në vite. Të ardhura nga shitja e apartamentit të familjes, apartament i privatizuar në vitin 1995, Gramsh, si dhe të ardhurat nga aktiviteti privat "Autoshkollë 1992 — 1994".

Vlera e shtëpisë, sipas dokumentacionit të legalizimit është Llogaritur 12.368.580 lekë. Vlera 840.000 lekë. Zotëron 50 %.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Certifikatë për vërtetim pronësie nr. *****, datë 5.6.2015, për truall me sip. 332.9m2 dhe ndërtesë me sip. 136.3m2, nr. pasurie ***, zk.***, vol. ***, faqe ***, R". "Imzot Mark Sopi " Tiranë, në b/pronësi të Fari dhe Mithat Tola.
- **Kartela e pasurisë së paluajtshme**, datë 5.6.2015, ku shuma e paguar figuron 1.255.068 lekë. Harta treguese e regjistrimit.
- **Shkresë me nr. *** prot., datë 27.8.2013**, nga Drejtoria e ALUIZNI-t Tiranë (1), ndaj ZVRPP Tiranë, që i dërgon dokumentacionin tekniko — ligjor, për ndërtimin informal të legalizuar, nga F.T dhe Mithat Tola, të gatshëm për t 'u regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Shitësi është i autorizuar nga Këshilli i Ministrave për të kryer veprimet e kalimit të pronësisë, mbi këtë sipërfaqe toke blerësit, pasi blerësi ka paguar: Taksën e ndikimit në infrastrukturë: 8.374+56.469,4 lekë; Parcelën ndërtimore: 108.792 + 411.433 lekë; Pagesën me Bono Privatizimi: 100.000 + 280.000 + 290.000 lekë, vlera të cilat së bashku me dokumentet e tjera bashkëngjitur, janë paguar dhe nënshkruar nga palët, para lidhjes së kësaj kontrate, si edhe ka plotësuar të gjithë dokumentacionin tekniko - ligjor, për legalizimin e objektit që ndodhet në parcelën ndërtimore. Bashkëlidhur Genplani.
- **Kontratë Shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., dt. 30.12.1995**, për ap. 2+1, Lagjja "Xhile Liçi " Gramsh, me palë shitëse F.T dhe palë blerëse M.Z , në vlerën 600.000

lekë. (F.T bashkë me pjesëtarët e tjerë të familjes, ka qenë bashkëpronar i apartamentit, sipas kontratës blerje datë 21.2.1993)

Hetimi administrativ:

ASHK, Drejtoria Vendore Tirana Veri me shkresë nr. ***prot., datë 13.9.2023, konfirmon se në emër të Mithat F.T , figuron e regjistruar pasuria: "Truall me sip. 332.9 m2 + ndërtesë me sip.136.3 m2, zk. ***, vol. ***,fq. 78, në b/pronësi. B/lidhur:

- Kartelë e pasurisë së paluajtshme me kod unik: ***, printuar në datë 8.9.2023, për pasurinë në zk.***, nr. pasurie ***, me sip. totale 332.9 m2, nga kjo ndërtesë me sip. 136.3 m2, me adresa: "Imzot Mark Sopi", ndërtesa nr. ***, Tiranë, në bashkëpronësi të F.T dhe Mithat F.T . Vlera fillestare: 1.255.068 lekë. Regjistruar: Nr. *** , datë 21.10.2014.
- Vet deklaram datë 6.9.2006, për legalizimin e objektit "godinë banimi 2(dy) kat + papafingo, Rr. "Lord Bajron Laprakë", Tiranë, nga F.T , firmosur nga Mithat Tola. Sipërfaqe e zënë 350m2, sipërfaqe ndërtimi 120 m2, viti i ndërtimit 1993.
- Certifikatë familjare, dt. 1.9.2006, me k/familjar F.Z. Tola.
- Certifikatë familjare, dt. 1.9.2006, me kryefamiljar Mithat F.T .
- Foto të godinës 2 (dy) kate + papafingo, datë 25.8.2006.
- Akt kualifikimi nr. *** , datë 20.6.2013, për objektin informal, që posedohet nga F.T dhe Mithat Tola.
- Leje legalizimi me nr.88941, datë 25.6.2013, që i jepet shtetasve F.T dhe Mithat Tola për legalizimin e objektit: Godinë banimi 3 (tre) kate, sip. parcelës ndërtimore 332.9 m2, sipërfaqe ndërtimi 136.3 m2 dhe sip. Totale e ndërtimit për banim 411.6 m2, zk. ***, nr. pasurie ***.
- Kontratë nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 17.6.2013, për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore me sip. 332.9 m2, në emër të F dhe Mithat Tola. Blerësit kanë paguar; taksën e ndikimit në infrastrukturë, 8.374+56.469 lekë; parcelën ndërtimore, 108.792 lekë + 411.433 lekë, pagesën me Bono Privatizimi, 100.000 + 280.000 + 290.000 lekë. B/lidhur praktika, përfshirë mandatpagesat nga Credins Bank dhe BKT. Vlera e paguar për parcelën ndërtimore, rezulton rreth 520.000 lekë.
- Formulari datë 14.6.2013, i pagesës së taksës, së ndikimit në infrastrukturë, vlera e investimit 12.368.580 lekë.
- Planimetria e katit përdhe, sip. ndërtimi 136.3 m2; katit të parë, sip. ndërtimi 154.3 m2; katit të dytë, sip. ndërtimi 121 m2.

ASHK, Drejtoria Vendore Gramsh me e-mail, datë 15.1.2024, nuk e konfirmon pasurinë në emrin e Mithat Tola dhe personave të lidhur me të.

Raiffeisen Bank. me shkresë me nr. *** prot., datë 7.8.2023, përcjell CD që konfirmon se në datë 17.2.2014, Llogaria e subjektit është kredituar nga F. T, në shumën 400.000 lekë.

BKT me shkresën nr.*** prot., datë 14.8.2023, konfirmon pagesat e kryera nga Mithat dhe F.T , për llogari të ALUIZIT, Qarku Tiranë, dt. 7.4.2010, shuma 56.469 lekë dhe dt. 8.6.2010, shuma 411.433 lekë, për taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe vlerën e parcelës ndërtimore.

Në proces-verbalin e datë 20.3.2024 të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga trupa e vlerësimit subjekti sqaroi se: "...shtëpia është ndërtuar në vitet 1992 — 1995 dhe ndërtimi në

këtë periudhë është vërtetuar me Vendim Fakti nga Gjykata Tiranë, me nr.***, regjistruar me nr. Hipotekor *** , datë 22.09.1995. Në datë 19.9.1995, babai i subjektit ka bërë kontratë dhurimi, sipas së cilës shtëpinë e banimit me 2 kate, e mbuluar me çati, i 'a dhuron bashkëshortes së tij (nënës së subjektit) me qëllim regjistrimin e kësaj pasurie, pasi sipas akt — vendimit duhej të kishe një kontratë për regjistrimin e pronës. Vlera prej 840.000 lekë e deklaruar në deklaratën e pasurisë së vlerësimit kalimtar është vlera e shpenzimeve për blerje materialesh për ndërtimin e shtëpisë, pasi puna e krahut është realizuar nga babai i subjektit — usta ndërtimi, me ndihmën e të afërmeve të tyre edhe ata ustallarë ndërtimi. Babai i subjektit, F.T , ishte me profesion murator i kategorisë VII dhe ka punuar si ndërtues në ndërmarrjen e ndërtimit në Gramsh. Pas daljes në asistencë në vitin 1992, punoi privatisht si usta ndërtimi, duke ndërtuar njëkohësisht edhe shtëpinë, së bashku me të afërmit e tij me origjinë nga Golloborda e Dibrës, zonë e njohur për ustallarë ndërtimi. Në ato vite, pagesat i kanë kryer me para në dorë në furnitorë të ndryshëm dhe nuk janë ruajtur fatura lidhur me blerjen e materialeve. Shpenzimet e kryera në vitet 1992 - 1995 janë Llogaritur mbi bazën e situacionit me çmimet e materialeve të ndërtimit për atë periudhë. Aplikimi në vitin 2006 për legalizimin e shtëpisë 2 kate + papafingo është bërë, pasi deri në fund të vitit 1995, u realizua rikonstrukcioni i çatisë, duke u kthyer në papafingo. Ky aplikim është bërë nga babai, firmosur edhe nga subjekti. Lidhur me vitin 1993 të ndërtimit ne formularin e vetëdeklarimit, sqaroi se është shënuar me përafërsi dhe mund të ishte lapsus, referuar edhe kohës kur është plotësuar. Ndër vite dhe deri në vitin 2014, sipas mundësive financiare, kanë kryer punime të ndryshme lidhur me përmirësime në fasadën e banesës, rinovime dhe punime të brendshme përmirësuese, të cilat në total Llogariten rreth 1.500.000 lekë. Këto punime janë kryer së bashku me babain dhe vëllain, F.T , ku pjesa takuese e subjektit ishte 50%. Lidhur me këtë fakt, disponon disa foto të vjetra dhe të kohëve të fundit të shtëpisë së banimit, pasi nuk ka ruajtur dokumente dhe nuk ka pasur preventive, lidhur me përmirësimin e ambienteve të shtëpisë pas vitit 1995, punime të cilat janë kryer, po nga babai. Transferta e shumës 400.000 lekë, datë 17.2.2014, e kryer nga vëllai F.T , në Raiffeisen Bank, ka qenë pagesë pikërisht për shpenzimet e kryera bashkërisht, në vitin 2014, për suvatimin e shtëpisë. Ky shpenzim lidhet me shpenzimet e tjera për përmirësimin e fasadës së shtëpisë. Burimi i kësaj shume janë të ardhurat e vëllait nga puna e tij në profesionin e lire si Avokat. Lidhur me burimin financiar të deklaruar për ndërtimin e shtëpisë deri në vitin 1995, sqaron se ishin të ardhurat e krijuara nga kursimet familjarë (nëna, babai, vëllai dhe subjekti), shitja e apartamentit të privatizuar në vitin 1993 në Gramsh, të ardhura nga aktiviteti privat "Autoshkollë " në vitet 1993 — 1995, si dhe kursimet dhe puna e babait si usta ndërtimi. Sqaron se pavarësisht se kontrata për shitjen e apartamentit në Gramsh në shumën 600.000 lekë është bërë në muajin dhjetor 1995, shitja e tij "de facto " ishte bërë në maj të vitit 1994, ndërsa kontrata e shitjes është formatizuar në vitin 1995. Shuma e përfituar nga shitja e shtëpisë në Gramsh është investuar totalisht në ndërtim, pasi jetonin bashkë (nëna, babai, vëllai dhe subjekti). Lidhur me kontributin e tij në ndërtim, sqaroi se sikurse evidentohet edhe në vërtetimin e faktit, lëshuar nga gjykata, shtëpia është ndërtuar nga babai dhe meqenëse jetonin familjarisht dhe në një ekonomi të përbashkët familjare, kontributi financiar ka qenë i përbashkët dhe nuk mund të përcaktohej egzaktesisht vlera konkrete në investim. Pra, pavarësisht kontributit të tij në ndërtimin e shtëpisë, pjesa takuese e subjektit është 500/0, pasi edhe aplikimi për legalizimin e shtëpisë është bërë nga babai dhe subjekti, si kontribuues të përbashkët.

Lidhur me të ardhurat nga aktiviteti autoshkollë, sqaroi se në muajin mars 1993 ka hapur aktivitetin sipas Vendimit të Gjykatës, datë 3.3.1993, licencuar nga Ministria Rendit Publik dhe Ministria e Transporteve, datë 8.4.1993. Ky aktivitet ka vazhduar deri në vitin 1995, sipas

konfirmimit nga DRT Elbasan, shkresa datë 30.9.2020. Gjatë kësaj periudhe ka krijuar të ardhura në vlerën 1.168.000 lekë, nëpërmjet kurseve për leje drejtimi për persona të ndryshëm privatë, të cilët në atë kohë i kanë kryer pagesat në cash. Për shkak të djegies së dokumentacionit të Degës Tatimore Gramsh, gjatë trazirave të vitit 1997 (konfirmuar me shkresë), nuk ekzistojnë të dhëna mbi të ardhurat e periudhës. Vlera e të ardhurave është deklaruar sipas një përlllogaritje, duke i 'u referuar disa dokumenteve, si lista me gjeneralitetet e kursantëve, bazuar në praktikën për çmimet / tarifat e pagesave të kursanteve, të cilët janë ushtruar dhe kanë përfutur lejen e drejtimit të kategorisë përkatëse. Nga këto lista, ka llogaritur me përafërsi, se janë ushtruar afërsisht 160 kursantë, për drejtues mjeti, në periudhën në fjalë. Çmimi mesatar ka qenë rreth 10.000 - 12.000 lekë/personi, për gjithë kategoritë e mjeteve dhe të ardhurat janë llogaritur pas pagesave të tatimeve dhe zbritjes së shpenzimeve të tjera. Lidhur me vlerën 1.255.068 lekë, cituar në kartelën e pasurisë, sqaroi se janë pagesat e kryera prej tyre për blerjen e truallit, taksa, etj., ku është ndërtuar shtëpia e banimit, të cilat janë të dokumentuara sipas faturave të lëshuara dhe mbi bazën e përcaktimeve ligjore, ashtu siç është llogaritur nga ALUIZNI. Pagesat janë kryer pjesërisht në lekë dhe pjesërisht me letra me vlerë, sipas ligjit të kohës.

Lidhur me vlerat e deklaruara ndër vite, sqaroi se janë vlera tregu, sipas çmimeve që kanë përlllogaritur për zonën ku ndodhet shtëpia.

Lidhur me b/pronësinë e dekluaruar me babain dhe vëllain, sqaron se aplikimi për legalizim është bërë nga babai dhe subjekti, ndërsa vëllai me familjen e tij jetojnë së bashku me prindërit në pjesën e tyre takuese, regjistruar në pronësi të babait dhe për këtë arsye ka deklaruar edhe vëllain si bashkëpronar. Lidhur me shpenzimet për mobilimin, sqaron se fillimisht kanë përdorur mobilet e apartamentit në qytetin e Gramshit dhe më pas, ndër vite, subjekti ka shpenzuar për rinovimin e mobilimit dhe pajisjeve shtëpiake përpjesën e tij, afërsisht rreth 5.250 euro dhe 90.000 lekë; TV Samsung blerë në vitin 2018, rreth 400 euro; Lavatrice, blerë në vitin 2012 në vlerën rreth 900 euro; Tavolinë dhome së bashku me karriget blerë në vitin 2016, rreth 500 euro; Kënd divan blerë në vitin 2011 rreth 1.300 euro; Pajisje kuzhine blerë në vitin 2017, në vlerën rreth 950 euro; Frigorifer, blerë në vitin 2009 në vlerën rreth 300 euro; Raftë rrobash porositur në punishte artizanale përgjatë viteve *** — 2009, 3(tre) copë nga 30.000 lekë/secili; Kuzhine e porositur në vitin 2007, në vlerën rreth 900 euro. Nuk ka ruajtur fatura blerje për këto shpenzime...”

Subjekti paraqiti:

- **Vendim** nr. ***, dt. 5.9.1995, Gjykata e Rrethit Tiranë, për vërtetimin e faktit juridik të ndërtimit nga F.T, të një shtëpie banimi me 2 kate dhe themele guri në Rr. J. Pashko.
- **Kontratë Dhurimi** me nr. ***rep., nr. *** kol., dt. 19.9.1995, ku F.T i dhuron znj. N.T, shtëpi banimi 2 kate me themele guri, murr tulle, e mbuluar me çati, në Rr. "J. Pashko", nr. ***, Tiranë;
- **Kontratë Shitblerje** me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.12.1995, për apartament banimi 2+1, Gramsh, me palë shitëse F.T dhe palë blerëse M.Z, në vlerën 600.000 lekë.
- **Dokument nga ALUIZNI**, Drejtoria Rajonale Tiranë, me nr. *** prot., datë 8.3.2010 për "Njoftimin për formularët e pagesave", drejtuar F.T dhe Mithat Tola. Formular i pagesës për taksën e ndikimit në infrastrukturë të parcelës ndërtimore për objektin e ndërtimit poseduar nga F.T dhe Mithat Tola. Vlera e taksës 56.469 lekë; Formular i pagesës me bono privatizimi të parcelës ndërtimore, për objektin e ndërtimit i poseduar nga F.T dhe

- Mithat Tola. Vlera e parcelës ndërtimore është 400.000 lekë, nga të cilat janë paguar 70 % e vlerës, në shumën 280.000 lekë, me bono privatizimi;
- **Formular i pagesës me bono privatizimi** të parcelës ndërtimore shtesë, me sip. 28.4 m², për objektin e ndërtimit poseduar nga F.T dhe Mithat Tola. Vlera e parcelës ndërtimore është 581.433 lekë, nga të cilat janë paguar 50 % e vlerës, në shumën 290.000 lekë me bono privatizimi;
 - **Projekt IDE**, me nr. ***, dt. 4. 1. 1996, punuar nga Ing. A. K me nr. Liçence ***;
 - **Situacion punimesh**, që konfirmon se sipas çmimeve të materialeve të ndërtimit të viteve 1992 — 1995, vlera e shpenzuar për shtëpinë e banimit 2 kate + papafingo, Rr. "Imzot Mark Sopi " Tiranë, është 839.547 lekë. Vlerësuese L.L.
 - **Foto të shtëpisë** ndër vite.
 - **Librezë pune e F.T**, ku figuron specialiteti si Karpentier, Kategoria VII deri në vitin 1992, kur ka dalë në asistencë.
 - **Vërtetim për bazën e vlerësuar nga ISSH**, datë 19.3.2024, për të ardhurat e F.T gjatë periudhës 2012 — 2024.
 - **Leje nr. ***, datë 8.4.1993**, nga Ministria Rendit Publik dhe Transporteve, Drejtoria e Policisë "Për lejimin e veprimtarisë në përgatitjen e kandidatëve për drejtimin e automjeteve ", sipas së cilës Mitat Tola lejohet të ushtrojë veprimtarinë private në Gramsh, për përgatitjen e kandidatëve për dëshminë e aftësisë së grupit B, C.
 - **Shkresa nr.***prot**, datë 29.9.1993; nr.005, datë. 15.6.1993; nr.006, datë15.6.1993; nr. 007, datë26.7.1993; nr. 008, dt. 5.9.1993; nr. 003, datë3.5.1993; drejtuar Degës së Rendit Publik, Sektori i Policisë Rrugore Gramsh, ”Paraqitje listë kursantësh për miratim drejtues i autoshkollës, Mithat Tola:
 - **Fletë njoftim tatimi**, datë 4.3.1993, Dega e Tatimeve Gramsh, për tatimpaguesin Mithat Tola ”Autoshkollë
 - **Mandat Arkëtimi nga Banka e Shtetit Shqiptar**, për pagesën e tatimit për autoshkollën nga Mithat Tola.
 - **Kthim përgjigje** nr. *** prot., datë 30.9.2020, DR T Elbasan, që konfirmon se Mithat Tola ka pasur të regjistruar aktivitetin ”Autoshkollë ” në Degën e Tatimeve Gramsh, si person fizik, sipas Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gramsh, datë 3.3.1993, me Kod Fiskal 8***. Data e Regjistrimit të; aktivitetit është 4.3.1993, deri në Vitin 1995, por për të ardhurat e aktivitetit për vitet 1993, 1994 dhe 1995, për shkak të situatës së vitit 1997, nuk disponohet dokumentacion.
 - **Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gramsh** me nr. 125, datë 3.3.1993, që vendosi regjistrimin e Mithat Tola si person fizik, me aktivitet autoshkollë.

Konstatohet:

- ✓ *Bazuar në deklarin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar, në mënyrë të përmbledhur rezulton se; Shtëpia e banimit 3 kate me sip. të parcelës ndërtimore 332.9 m², sip. ndërtimi 136.3 m² dhe sip. totale e ndërtimit për banim 411.6 m², Tiranë, në b/pronësi të subjektit dhe babait, me pjesë takuese 50 % secili, është ndërtuar gjatë viteve 1992 — 1995. Ndërtimi është kryer nga babai, i cili ka qenë usta ndërtimi (me origjinë nga Golloborda e Dibrës, zonë e njohur për ustallarë ndërtimi). Subjekti ka dokumentuar, me anë të Vendimit të Faktit nr.***, nga Gjykata Tiranë, shtëpinë e banimit me 2 kate, e mbuluar me Fakti, ndërtuar nga F.T. Subjekti ka dokumentuar profesionin e babait, si ndërtues i kategorisë VII. Në*

Vitin 2006 u aplikua për legalizim nga babai dhe subjekti, pasi deri në fund të vitit 1995 u realizua rikonstruksioni i çatise, duke u kthyer në papafingo dhe në v. 2013 është marrë leja e legalizimit. Vlera e shpenzuar për materialet e ndërtimit gjatë viteve 1992 - 1995 ka qenë rreth 840.000 lekë dhe i përket periudhës para vitit 2008. Burimi i krijimit të kësaj shume janë deklaruar të ardhurat familjare, shitja e apartamentit në Gramsh, si dhe të ardhurat nga aktiviteti privat i subjektit si Autoshkollë. Subjekti ka dokumentuar vlerën e materialeve të ndërtimit me çmimet e kohës, shitjen e apartamentit në Gramsh (për të cilin ka dhënë shpjegime se shitja de fakto është bërë në Vitin 1994), si dhe kryerjen e aktivitetit të Autoshkollës. Ka dokumentuar gjithashtu, punësimin e tij prej vitit 1988 (trajtuar në rubrikën e të ardhurave)

- ✓ Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me jetesën në ekonomi të përbashkët familjare dhe pjesën takuese të tij prej 50%.
- ✓ Nga viti 1995 dhe deri në Vitin 2014 janë shpenzuar për përmirësimin e fasadës, rinovime dhe punime të brendshme (përmirësuese) rreth 1.500.000 lekë, dokumentuar kjo me anë të; pamjeve fotografike (para dhe pas). Këto shpenzime kanë qenë të përbashkëta me vëllain dhe janë shtrirë në kohë. Punimet janë kryer po nga babai.
- ✓ Subjekti ka dokumentuar të ardhurat e vëllait, F.T . RFZ Bank konfirmon në v.2014, kreditimin e shumës 400.000 lekë nga ana e vëllait, shumë e Cila ka shërbyer për kryerjen e shpenzimeve të mirëmbajtjes.
- ✓ Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me pagesat për legalizimin e objektit rreth 585.000 lekë kryer nga ai dhe vëllai, si dhe shpenzimet për mobilimin ndër vite të pjesës së tij takuese, prej rreth 5.250 euro+90.000 lekë.
- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur, shpjegimet e dhëna dhe përgjigjen e ASHK. Shtëpia e banimit me vlerë 840.000 lekë është ndërtuar në v. 1992 - 1995. Rezulton se për parcelën ndërtimore janë paguar në v.2010, rreth 520.000 lekë dhe për përmirësimin e godinës ndër vite janë investuar rreth 1.500.000 lekë (vlera totale rezulton 2.860.000 lekë).
- ✓ Rezultojnë shpenzime ndër vite, për mobilimin e pjesës takuese të subjektit, rreth 5.250 euro + 90.000 lekë.

Pasuria nr. 3

Pasuri e tjetërsuar - shitur. Apartament banimi me sipërfaqe 116.1 m2, Unaza e Re, Kashar, Tiranë. Kontrata e shitblerjes datë 17.11.2020.

Burimi i krijimit: Apartamenti është paguar me këste në vite sipas kontratës së porosisë, me kursimet familjare dhe një hua e marrë nga motra e bashkëshortes — hua e cila është aktualisht e shlyer. Apartamenti është shitur në datë 1 1.6.2021, me vlerën 9.348.000 lekë.

Vlera 47.880 euro. Zotëron 100 %.

Hetimi administrativ:

ASHK DV Tiranë dhe Zonat e Stimuluara me shkresat me nr. ***prot., datë 13.9.2023; 4.9.2023; 11.9.2023; 11.9.2023; 4.8.2023, nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme të tjetërsuar, në emrin e Mithat F.T dhe familjarëve të tij.

OTP Bank me shkresë me nr*** prot., datë 4.8.2023 konfirmon se Mithat Tola dhe Arjola Tola kanë pasur llogari rrjedhëse në euro pranë kësaj banke. Në datë 15.7.2021, E.B, P.P me

përshkrimin: kalim sipas kontratës së shitjes PP, me rezervë kalim pronësie me nr. *** rep., dhe nr.*** kol, datë 11.6.2021, ka transferuar shumën 76.000 euro.

Me postën elektronike datë 20.3.2024 të dërguar pranë ILDKPKI dhe administruar nga trupa e vlerësimit subjekti sqaroi se “...apartamenti me sip. 116.1 m2 me adresë Kashar, Tiranë është porositur në Vitin 2007, me kontratë porosie, dt. 29.12.2007, me shoqërinë ndërtuese ”*** ShPK, me çmim 47.880 euro, e cila është paguar me disa këste gjatë viteve 2007 - 2008. Me dakordësim, sipas kontratës së porosisë, pagesat i janë kryer Shoq. *** ShPK dhe Shoq. ***, me nënkontraktor Shoq. ”****” ShPK., nëpërmjet Credins Bank dhe mandate pagesash me para në; dorë. Kontratën përfundimtare të shitblerjes e kanë realizuar në; nëntor 2020, pasi shoqëria ndërtuese, nuk arriti ta përfundonte apartamentin në afatin e premtuar dhe regjistrimi në ZVRPP Tiranë është kryer në qershor 2020.

Burimi i krijimit për blerjen e këtij apartamenti janë: shuma 42.000 euro nga huaja prej 50.000 euro, marrë nga motra e b/shortes në vitin 2007 dhe shuma 5.880 euro, nga kursimet familjarë në vite. Huaja është marrë në vitin 2007 dhe shlyerja e saj është bërë nga v.2008 deri në muajin shtator 2014, periudhë gjatë së cilës, nuk ka qenë subjekt deklarimi. Deklaratën e parë të pasurisë, pas marrjes së detyrës, e ka bërë pasi huaja ishte shlyer dhe nuk ekzistonte. Për blerjen e apartamentit, subjekti nuk ka ruajtur të gjitha mandatpagesat. Apartamenti është rivlerësuar dt.22. I l. 2020 dhe për diferencën është paguar tatimi në shumën 201.125 lekë. ... ”

Subjekti paraqiti:

- **Kontratë porosie** me nr. *** prot., dhe nr. *** kol., datë 29.12.2007, me porositës Mithat Tola, për apartament banimi me sip. 133 m2, që Shoq. ”****” ShPK ndërton në zonën e Unazës së Re, Tiranë, me çmim 41880 euro. Kësti i parë 15.000 euro u pagua në momentin e nënshkrimit të kontratës; Kësti i dytë 30.880 euro do të likuidohet deri në datë 8.1.2008; Kësti i tretë 2.000 euro do të likuidohet në momentin e marrjes së apartamentit në dorëzim nga porositësi. Likuidimin e çmimit, porositësi do ta bëjë pranë Shoq. ”****” ShPK., e cila ka kryer punime në favor të shoq. ”****” ShPK. Bashkëlidhur praktika.
- **Kontratë shitje pasurie e paluajtshme** nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 17.11.2020 për ap. me sip. 116.1 m2 (sip e përbashkët 12.5 m2), në Yzberisht, Tiranë, me palë shitëse Shoq. ”****” ShPK dhe palë blerës Mithat Tola, në vlerën 47.880 euro, vlerë e Cila është likuiduar sipas Kontratës së Porosisë nr. *** prot., dhe nr. *** kol., datë 29.12.2007.
- **Certifikatë për vërtetim pronësie**, datë 9.6.2020, për apartamentin me sip. 116.1 m2, zk. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, në Yzberisht Tiranë, me pronar Shoq. ”****” ShPK. Bashkëlidhur: Kartela e pasurisë.
- **Kartelë e pasurisë së paluajtshme**, datë 18.11.2020, për ap. me sip. 116.1 m2, zk. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, me adresë Yzberisht Tiranë, me pronar Mithat Tola, me vlerë 47.880 euro.
- **Mandat arkëtimi nga Credins Bank**, datë 29.12.2007, që konfirmon pagesën e vlerës 15.000 euro, nga Mithat Tola për Shoq. ”****” ShPK.
- **Mandat pagese** nr.***, datë 29.12.2007, që konfirmon pagesën e vlerës 15.000 euro, nga Mithat Tola për Shoq. ”****” ShPK.
- **Mandat pagese** nr. ***, datë 16.1.2008 që konfirmon pagesën e vlerës 9.900 euro, nga Mithat Tola për Shoq. ”****” ShPK.
- **Dokument i printuar për pagesën rivlerësimit** në masën 3% të pasurisë së paluajtshme, me kërkesën nr. 33349, datë 22.11.2020 nga Mithat Tola, në shumën 201.125 lekë.

- **Kontratë shitje pasurie e paluajtshme me rezervë, me kalim pronësie** nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 11.6.2021, ku Mithat Tola dhe Arjola Tola, shesin apartamentin me sip. 116.1 m², Yzberisht, Tiranë, në vlerën 9.348.000 lekë. Kësti i parë në vlerën 27.220 euro, e barasvlershme me 3.348.000 lekë është paguar pranë OTP Bank, nëpërmjet llogarisë së noterit E.B, me përshkrimin: Kalim kësti i parë për blerje pasurie nr. ***, zk***, vol. ***, faq. ***. Shuma prej 48.780 euro e barasvlershme me 6.000.000 lekë është paguar pranë OTP Bank, nëpërmjet llogarisë së noterit E.B, PP deri në momentin e likuidimit total dhe lëshimit të deklaratës noteriale, por jo më vonë se 90 ditë nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate me afat opsional mes palëve. Bashkëlidhur praktika.
- **Deklaratë noteriale** (për fshirje hipoteke) me nr.***rep., dhe nr. *** kol., datë 9.12.2021, ku deklaruesit Mithat Tola dhe Arjola Tola deklarojnë në përgjegjësinë e tyre personale, se janë dakord që ZVRPP Tiranë (ASHK) të bëjë fshirjen e kufizimit në seksionin përkatës të kartelës dhe regjistrin kadastral, fshirjen e inskriptimeve në seksionin përkatës, duke mos ngritur asnjë pretendim sot apo në të ardhmen, për pasurinë apartament banimi me Sip. 116.1 m², me nr. pasurie ***, zk. ***, vol. ***, fq. ***, me adresë Yzberisht, Tiranë;
- **Mandat pagese nga OTP Bank**, datë 17.6.2021, që konfirmon pagesën e shumës 27.220 euro, në favor të E.BPF.
- **Mandat Pagese nga OTP Bank**, datë 1.7.2021, për pagesën e shumës 48.780 euro, në favor të E.B., PF, sipas kontratë shitje pasurie e paluajtshme me nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë 11.6.2021;
- **Udhëzim nr. ***, datë 26.2.2008** "Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme i ndryshuar ", i cili përcakton se vlera e shitjes së apartamentit në zonën Kashar, Tiranë, në vitet 2007 — 2008, ka qenë rreth 48.800 lekë/m².

Konstatohet:

- ✓ *Apartamenti me sip. 116.1 m², Yzberisht, Tiranë është përfituar në v. 2007, me kontratë porosie në vlerën 47.880 euro, me burim kursime nga të ardhurat, shuma 5.880 euro dhe huamarrje nga motra e b/shortes me banim në Hamburg, Gjermani, shuma 42.000 euro. Shuma totale e marrë hua prej 50.000 euro, është shlyer gjatë periudhës 2008- 2014. Në vitin 2020 është bërë kontrata e shitblerjes dhe në vitin 2021 është shitur në vlerën 9.348.000 lekë/76.000 euro. Destinacioni i përdorimit të kësaj shume trajtohet në vijim, në rubrikën e deklaramit të pasurive të b/shortes.*
- ✓ *Deklarimi bazohet në dokumentacionin e dorëzuar dhe shpjegimet e dhëna. ASHK nuk e konfirmon pasurinë në emër të subjektit dhe b/shortes.*
- ✓ *Rezultojnë të ardhura nga shitja e apartamentit në Tiranë, në shumën 28.120 euro (blerë 47.880 euro/shitur 76.000 euro).*
- ✓ *Dokumentacioni i burimit të krijimit të huasë në shumën 50.000 euro, nga motra e b/shortes, trajtuar më sipër. ndërsa i shumës 5.880 euro nga të ardhurat familjare, trajtohet në vijim, në rubrikat përkatëse të ardhurave.*

Pasuria nr. 4

Automjet Toyota Verso, me targa AB **** GA, Viti i prodhimit 2011, blerë në Gjermani sipas kontratës datë 24.2.2022.

Burimi i krijimit: Të ardhura nga shitja e mjetit Mitsubishi fuoristradë, me targa AA ***HH. Vlora 2.100 euro. Zotëron 100 0/0.

Pasuri e tjetërsuar/shitur: Mitsubishi Pajero, me targa AA***HN; blerë 5.600 euro/shitur 2.000 euro.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Certifikatë e pronësisë** datë 7.3.2022, për mjetin me targa AB *** GA, marka TOYOTA, regjistruar në datë 24.2.2022, në pronësi të Mithat Tola.

Hetimi administrativ:

DPSHTRR me shkresë nr. *** , datë 10.8.2023, konfirmon se Mithat Tola: ka të regjistruar automjetin me targa AB *** GA, tip Toyota Verso, blerë në Gjermani në vlerën 2.100 euro. Bashkëlidhur; Kontrata e blerjes datë 24.2.2022, në gjuhën gjermane, si dhe dokumenti i zhdoganimit që konfirmon vlerën e zhdoganimit, në shumën 72.250 lekë.

Ka pasur të regjistruar automjetin me targa AA *** HN, tip Mitsubishi Pajero, blerë në Gjermani me Kontratë Shitje Automjeti, e vitit 2013 (e përkthyer) në vlerën 5.600 euro. Me kontratë, datë 21.4.2022, është shitur automjeti në vlerën 2.000 euro.

Në proces-verbalin e datës 20.3.2024 të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga trupa e vlerësimit subjekti sqaroi se: *“... mjetin fuoristradë Mitsubishi, e ka shitur tek një i njohur dhe dorëzimi dhe marrja e vlerës të parave nga ky transaksion ka ndodhur përpara së të kryhej përpilimi i deklaratës noteriale pranë zyrës noteriale, e cila është bërë më vonë, për arsye të angazhimeve të ndryshme. Mjeti Toyota është sjellë nga Gjermania (Hamburgu) dhe është mjeti privat/personal i familjes së baxhanakut të subjektit, P.F. Për të dy mjetet, veprimet noteriale janë kryer në data, që nuk përkojnë me momentin e marrjes/dhënies së shumave të të hollave jashtë zyrave noteriale, duke qenë se transaksionet janë kryer me persona të rrethit familjar. Gjithashtu, në momentin e shitje/blerjeve të mjeteve, familjarisht kanë patur burime financiare të mjaftueshme. Në deklaratimet ndër Vite, ka deklaruar vlerën e tregut, mënyrë kjo e sugjeruar nga burimet njerëzore....”*

Konstatohet:

- ✓ *Automjeti Toyota Verso, me targa AB *** GA, është blerë nga subjekti në v.2022 në; vlerën 2.100 euro, me burim nga shitja e automjetit tip Mitsubishi Pajero. Automjeti Mitsubishi Pajero me targa AA *** HN, është blerë në; Gjermani në v. 2013, në vlerën 5.600 euro, me burim të ardhurat familjare. Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me kryerjen e veprimeve noteriale për shitblerjet e automjeteve.*
- ✓ *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar, shpjegimet e dhëna dhe përgjigjen e DPSHTRR. Dokumentacioni i burimit të krijimit të shumës 5.600 euro, v.2013, për blerjen e automjetit Mitsubishi Pajero, me targa AA *** HN, trajtohet në; rubrikat përkatëse të të ardhurave. Automjeti është shitur në v. 2022, në vlerën 2.000 euro.*

Pasuria nr.5

Pasuri e tjetërsuar/shitur: Autoveturat të poseduara në pronësi dhe të shitura ndër vite:

Wolksvagen Golf 2, targa GR*** (1992 - 93); Vlerë 180.000 lekë/shitur 200.000 lekë;
Wolksvagen Golf 2, targa TR***B, Blerë 150.000 lekë/shitur 250.000 lekë. 1996 - 1998;
Ford Escort, targa TR *** I; Blerë 1.000 euro / shitur 250.000 lekë,
Wolksvagen Golf 3, targa TR*** L (AA *** AY); Blerë 500.000 lekë/shitur 430.000 lekë,
Ford Focus, targa TR***P (AA*** HN); Blerë 5.000 euro/shitur 290.000 lekë,
Mercedes Benz 200, targa AA *** CB; Blerë 6.300 euro / shitur 5.500 euro.

Hetimi administrativ:

DPSHTRR me shkresë nr. *** , datë 10.8.2023, konfirmon se Mithat Tola, ka pasur të regjistruar automjetin tip Mercedes Benz me targa dhe AA *** CB, blerë në Gjermani me kontratë blerje datë 2.10.2011 (e përkthyer), në vlerën 1.000 euro, me palë shitëse AG. Bashkëlidhur; dokumenti i zhdoganimit të mjetit. Me kontratë nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 18.4.2018 ka shitur automjetin tip Mercedes Benz në vlerën 550.000 lekë, me palë blerëse A.S .

DPSHTRR me postë elektronike, datë 10. 11. 2023, konfirmon se Mithat Tola ka pasur të regjistruar automjetet, si vijon:

- Automjetin tip Wolksvagen, blerë me Kontratë Shitje me nr. *** rep., dhe nr. *** kol. datë 26.10.***, me palë shitëse shtetasin: P.F dhe palë blerëse Mithat Tola, në vlerën 500.000 lekë.
- Automjetin tip Ford Focus, blerë me kontratë shitje automjeti e përkthyer nga gjuha Gjermane, me nr. *** , datë 25.2.2008, me palë shitëse J.L-Automobile dhe palë blerëse Mithat Tola, në vlerën 5.000 euro.
- Për automjetin me targa me targa TR *** B, konfirmohet se është mjet tip Kamion i llojit MA". Bashkëlidhur; Autorizim nga DPSHTRR nr. *** , datë 8.8.2002, që konfirmon se pronar i mjetit Kamion MAN, është shtetasi G.K. Për automjetin me targa me targa TR *** , konfirmohet se është mjet tip Kamion, i llojit "VOLVO". Bashkëlidhur praktika e dosjes, që konfirmon se pronar i mjetit tip Kamion i llojit "VOLVO" është ***ShPK, dhe ky mjet ka dalë jashtë përdorimit.

Në proces-verbalin e 20.3.2024, mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga trupa vlerësuese subjekti sqaroi se: "... Lidhur me mjetet Wolksvagen Golf 2, me targë GR *** dhe Wolksvagen Golf 2, me targa TR *** B, nisur nga koha shumë e gjatë që ka kaluar, nuk e disponon dokumentacionin e blerjeve dhe shitjes. Burimi i krijimit për blerjen e mjetit të markës Wolksvagen Golf 2, me targë GR *** , ishin të ardhurat nga pagat dhe kursimet e krijuara ndër vite. Mjetet pasardhëse, në përgjithësi, janë blerë duke shfrytëzuar të ardhurat nga shitja e mjetit paraardhës.

Autovetura e markës Ford Eskort, ka targa TR*** dhe deklarimi i targës TR***1 është lapsus. Lidhur me konstatimin nga DPSHTRR, për shkak të deklarimit gabim të targës (19' mjet ka targa TR *** dhe jo TR *** 1), mjeti me targa TR *** , rezulton i tipit Kamion "MAN". Burimi i krijimit për blerjen e tre mjeteve: Wolksvagen Golf 3 me targa TR *** L (AA *** AY), Ford Gal (Eskort) me targa TR *** 1 dhe Ford Focus me targa TR *** P (AA *** FIN), janë të ardhurat e krijuara nga shitja e mjetit paraardhës, të ardhurat e krijuara nga aktiviteti privat autoshkollë, si dhe të ardhurat e krijuara nga puna në vite.

Automjetin e markës Wolksvagen Golf 2, me targa TR***B, e ka zotëruar për periudhën 1996 - 1998, kohë në të cilën i 'a ka shitur një shtetasi në Tiranë dhe nuk ka ruajtur kopjen e kontratës

së shitjes. Lidhur me konstatimin nga DPSHTRR, sqaroi se mund të ketë ndodhur ripërdorimi i targës, gjë që ka qenë praktikë e njohur ligjore. Pra, targat e autoveturës Golf 2, mund t'i kenë kaluar mjetit kamion i tipit MAN.

Vlera prej 6.300 euro, e deklaruar për autoveturën "Mercedes Benz 200 me targa AA*** CB është lapsus në deklarim, pasi, gabimisht, për këtë mjet është shënuar vlera e blerjes në vitin 2017, të mjetit Mercedes Benz me targa AA *** PV. Hera e blerjes së automjetit Mercedes Benz 200, me targa "*** CB, në vitin 2011, është l. 000 euro dhe është kapur si okazion në atë periudhë. Kjo është arsyeja, që vlera e shitjes është më e lartë, ku përfshihen edhe shpenzimet doganore, që u paguan në atë kohë. Vlera e deklaruar në deklaratën e interesave privatë, ndër vite, është vlera e tregut, mënyrë kjo e sugjeruar nga burimet njerëzore....”

Subjekti paraqiti:

- **Kontratë blerje**, datë 24.4.2004 (e përkthyer nga gjuha Gjermane), për automjetin Ford Gal (Eskort) me targa TR ***, me palë shitëse shtetasin Z.H dhe palë blerëse Mithat Tola, në vlerën 1.000 euro; Kontratë shitje me nr. *** rep., dhe nr.*** kol. datë 24.6.2004, për automjetin Ford Gal (Eskort), me targa TR *** 1, me palë shitëse Mithat Tola dhe palë blerëse J.L, në vlerën 250.000 lekë. B/lidhur: Leja e Qarkullimit në emrin e Mithat Tola.
- **Kontratë blerje** nr. *** rep. , nr. *** kol., datë 26.10.***, për automjetin Wolksvagen Golf 3, me targa TR *** L (AA *** A Y), me palë shitëse shtetasin P.F dhe palë blerëse Mithat Tola, në vlerën 500.000 lekë; Kontratë shitje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.6.2010, për automjetin Wolksvagen Golf 3, me targa TR *** L (AA *** A Y), me palë shitëse shtetasin Mithat Tola dhe palë blerëse Fatos Spahiu, në vlerën 430.000 lekë.
- **Kontratë blerje**, datë 25.2.2008 (e përkthyer nga gjuha Gjermane), për automjetin tip Ford Focus, me targa TR *** P (AA *** FIN) me palë shitëse J.L Automobile dhe palë blerëse Mithat Tola, në vlerën 5.000 euro; Kontratë shitje me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 9.10.2013, për automjetin tip Ford Focus, me targa TR *** P (AA *** FIN) me palë shitëse Mithat Tola dhe palë blerëse Shoq. "****" ShPK, në vlerën 290.000 lekë.

Konstatohet:

- ✓ *Lidhur me automjetet Wolksvagen Golf 2, me targa GR*** dhe TR***B, subjekti nuk disponon kontratat e shitblerjeve, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar. DPSHTRR nuk i konfirmon këto automjete. Burim krijimi për blerjen e tyre kanë qenë të ardhurat nga pagat dhe kursimet e krijuara ndër vite. Mjetet pasardhëse, në përgjithësi janë blerë duke shfrytëzuar të ardhurat nga shitja e mjetit paraardhës.*
- ✓ *Subjekti ka dokumentuar kontratat e shitblerjeve për automjetet me targa TR ***; TR *** L (AA *** AY) dhe TR *** P (AA *** FIN).*
- ✓ *Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me vlerat e deklaruara dhe ato sipas kontratave, të automjetit Mercedes Benz 200, me targa AA***CB.*
- ✓ *Subjekti ka dhënë shpjegime, lidhur me automjetet Wolksvagen Golf 2, me targë GR*** (the TR***B. për të cilat nuk disponon dokumentacion. DPSHTRR nuk i konfirmon këto automjete.*
- ✓ *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar, shpjegimet e dhëna dhe përgjigjet e DPSHTRR, lidhur me automjetet e tjetërsuara Ford Escort, me targa TR ***1, Wolksvagen Golf 3, me targa TR***L (AA***AY) dhe Ford Focus, me targa TR***P (AA***HN).*

- ✓ *DPSHTRR konfirmon vlerën e blerjes së automjetit Mercedes Benz 200, me targa AA***CB, prej 1.000 euro dhe atë të shitjes prej 550.000 lekë.*

Pasuria nr. 6

Llogari page në BKT. Vlera 1.993.063 lekë. Vlera e overdraft-it 41.000 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga në Policinë e Shtetit. Zotëron 100 %.

Hetimi administrativ:

BKT me shkresë nr.***, datë 14.8.2023, konfirmon Llogari rrjedhëse me gjendje në datë 8.3.2023, në shumën 2.313.901 lekë. Në llogari janë kryer transferta, si vijon:

Në datë 26.11.2009, shtetasi A.D ka kredituar shumën 40.000 lekë, me përshkrimin: likuidim për vlerësim pasurie për kolateral.

Në datë 29.7.2013, Mithat Tola ka transferuar shumën 400.000 lekë, për shtetasin A.V.

Në datë 09.06.2014, Mithat Tola ka transferuar shumën 1.000.000 lekë, për shtetasin T.T, me përshkrimin: Dhënie huaje.

Në datë 01.03.2017, Arjola Tola ka kredituar shumën 300.000 lekë.

Në datë 09.06.2017, shtetasi A.V ka transferuar shumën 500.000 lekë, me përshkrimin: kthim paradhënie për dëmin e shëndetit.

Në proces-verbalin e datës 20.3.2024 të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga trupa e vlerësimit subjekti sqaroi se: *"...gjendjen e llogarisë së pagës e ka deklaruar me përfaqësi, referuar gjendjes së muajit dhjetor 2022, e cila është shtuar gjatë muajve janar - mars 2023, nga pagat dhe shpërblime, të kredituar në Llogari. Overdraftin në shumën 41.000 lekë nuk e ka përdorur.*

*Në muajin nëntor të vitit 2009, b/shortja ka kryer një raport vlerësimi në kuadrin e aktivitetit të saj privat, si vlerësuese e pasurive të paluajtshme për shtetasin A.D dhe kundrejt marrëveshjes midis palëve, ky shtetas ka kryer pagesën në llog. e subjektit. Lidhur me huadhënien ndaj shtetasit T.T sqaroi se ky shtetas ka qenë një nga pronarët/aksionerët e Kompanisë së Sigurimeve "****" sha " dhe subjekti ka pasur një marrëveshje/marrëdhënie bashkëpunimi në shumë fusha dhe drejtime. Në fund të vitit 2013 dhe fillim të vitit 2014, ky shtetas është gjendur në vështirësi ekonomike. Nisur nga fakti se ka qenë një nga bashkëpunëtorët e afërt dhe person që është gjendur në kohën e shkëputjes dhe largimit të subjektit nga puna në polici, i kanë dhënë shumën 1.000.000 lekë nga llogaria, me përshkrimin "dhënie huaje por që në fakt ishte ndihmë financiare në moment vështirësie dhe pa të drejtë kthimi. Shuma 1.000.000 lekë është e përbashkët me kolegun B.K (50%/secili), ashtu sikurse figurojnë edhe transaksionet që përbëjnë këtë shumë.*

*Shuma 300.000 lekë e kredituar nga b/shortja në dt. 1.3.2017 është tërhequr nga llogaritë e saj në banka të tjera dhe është kredituar në llogarinë e subjektit, duke qenë se në atë periudhë (muaji shkurt 2017), subjekti ka kryer pagesën e doganës së autoveturës tip Mercedes Benz, me targa AA *** PV, që kaloi në pronësi b/shortes.*

Për transfertën, e datës 9.6.2017, nga A. V, në shumën 500.000 lekë, me përshkrimin: kthim paradhënie për dëm shëndeti, sqaroi se nga viti 2012 deri në vitin 2013, gjatë aktivitetit të QSSRRR, janë ndjekur të gjithë procedurat e përfitimit të dëmit shëndetësor për këtë shtetas, si pasojë e një aksidenti rrugor me pasojë plagosjen e rëndë dt. 15.6.2011, i autorizuar me prokurë të posaçme datë 14.1.2012. Nga subjekti dhe më pas nga b/shortja, janë suportuar të

*gjithë procedurat pranë korrespondentit të Byrosë Greke të Sigurimeve "****" për të përfituar dëmin shëndetësor në zbatim të dispozitave të legjislacionit Shqiptar, procedura që u finalizuan në vitin 2017, ku me Vendim të Gjykatës së Apelit Tiranë, u vendos dhënia e dëmshpërblimit. Shuma 500.000 lekë, e transferuar nga ky person në llogarinë e subjektit në vitin 2017, ka qenë rimbursim për shpenzimet që janë kryer për llogari të tij, gjatë ndjekjes së proceseve për marrjen e dëmit, për një periudhë të gjatë kohore prej v. 2012. Konkretisht; 400.000 lekë janë transferuar për A.V, nga Llogaria e subjektit në BKT, datë 29.7.2013 dhe 100.000 lekë është pagesa e kryer cash nga subjekti për aktin e ekspertimit shëndetësor, në vitin 2012...."*

Subjekti paraqiti.

- **Postë elektronike** dt. 13.2.2024, nga BKT, për limit overdrafti në shumën 41.000 lekë.
- **Deklaratë** datë 24.11.2023, nga B.K , i cili deklaron se në vitet 2007 — 2013 ka punuar me Mithat Tola, në aktivitetin privat si konsulent tekniko-ekonomik, në fushën e sigurisë rrugore. Në shumën 1.000.000 lekë, që Mithat Tola i ka kaluar shtetasit T.T, shuma 500.00 lekë i përket B. K. Bashkëlidhur: Kartë identiteti e B.K , me nr. ID . G***.
- **Prokurë e Posaçme** nr. *** rep., nr. ***kol., datë 14.1.2012, ku A.V, emëron si përfaqësues të posaçëm "Qendrën e Studimeve të Sigurisë Rrugore ", përfaqësuar nga ing Mithat Tola dhe B.K , për të ndjekur të gjitha procedurat lidhur, me rastin e dëmshpërblimit nga BSSH.
- **Konfermë bankare** nga BKT, dt. 30.11.2016, ku Mithat Tola transferon për llogari të shtetasit A.V., shumën 100.000 lekë, me përshkrimin "paradhënie dëm shëndetësor në aksident rrugor"
- **Faturë për arkëtim** nr.***, datë 16.10.2012, me përfitues Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe pagues shtetasi A.V, shuma 288.000 lekë me emërtimin: Të ardhura nga veprimet gjyqësore (3% kërkesë padi).
- **Dokument bankar**, nga BKT, datë 18.10.2012 "Kërkesë për transaksion " nga "Qendra e Sigurisë Rrugore " për pagesën e vlerës 288.000 lekë, me përfitues Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me përshkrim "Taksë 3% për kërkesë padi e A.V
- **Vendim nr. *****, datë 8.11.2016 i Gjykatës së Apelit Tiranë, me palë paditëse: A.V dhe palë e paditur: Shoqëria "****" Shpk, korrespondent në Shqipëri e shoqërisë greke të sigurimit "****", e cila vendosi: Lënien në fuqi të Vendimit nr. ***, datë 3.11.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, për detyrimin e palës së paditur, të paguajë në favor të paditësit dëm pasuror dhe jo pasuror, si dhe shpenzimet e tjera të arsyeshme dhe të nevojshme, të shkaktuara nga aksidenti i datës 15.06.2011, nga automjeti me targa greke ZYX ***.

Konstatohet:

- ✓ *Llogaria e pagës së subjektit në BKT është krijuar nga muaji tetor 2013 dhe gjendja e saj në datë 8.3.2023, konfirmohet 2.313.901 lekë. Burimi i krijimit janë të ardhurat nga pagat në Policinë e Shtetit. Subjekti ka dokumentuar vlerën e overdraftit prej 41.000 lekë, si dhe transaksionet e konfirmuara.*
- ✓ *BKT konfirmon Llogari në vlerën 2.313.901 lekë, datë 8.3.2023.*
- ✓ *Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion, lidhur me transaksionet e konfirmuara nga BKT. Dokumentacioni i burimit të krijimit të Llogarisë, trajtohet në vijim, në rubrikën përkatëse të ardhurave të subjektit.*

Pasuria nr.7

Llogari rrjedhëse në Alpha Bank. Llogaria është hapur në periudhën e ushtrimit të aktivitetit privat dhe nuk është përdorur prej më shumë se 10 vite. Vlera 0 lekë. Zotëron 100 %

Hetimi administrativ:

OTP Bank me shkresë me nr*** prot., datë 4.8.2023, konfirmon se Mithat Tola ka pasur llogari në lekë pranë kësaj banke (duke qenë se Alpha Bank është përthithur nga OTP Bank, duke filluar nga data 1. 12.2022, banka ka dhënë informacionin edhe mbi llogaritë që klientët kanë pasur në dy sistemet bankare). Gjendja në llogari është 0 lekë. Në llogari janë kryer transfertat, si vijon: Në datë 7.7.2011, kredituar shuma 4.357.554 lekë me përshkrimin: pagesë dëmi karton jeshil për A.Ll, nga ***. Në datë 8.7.2011, tërhequr shuma 1.000.000 lekë dhe kaluar N. Ll, shuma 3.200.000 lekë. Në datë 12.9.2011, tërhequr shuma 100.000 lekë.

Në proces-verbalin e datës 20.3.2024 të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga trupa e vlerësimit subjekti sqaroi se: *“...në vijim të aktivitetit privat të licencuar, si rezultat i prokurës lidhur me trashëgimtarët e shtetasit A.Ll, shtetasen N. Ll (nëna e tij), së bashku me kolegun B.K kanë mundësuar përfitimin e vlerës së dëmit shëndetësor, në shumën 4.357.554 lekë, pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimeve, dt. 7.7.2011, në llogarinë e përbashkët pranë Alpha Bank nga kompania greke ***. Tërheqjet e kryera në datat 8.7.2011 dhe 12.9.2011, në shumën totale 1.100.000 lekë, pjesa e mbetur nga dëmi në bazë të deklaratës, janë kryer, pasi kjo llogari është hapur dhe përdorur vetëm në funksion të këtij rasti, me kërkesë nga shoqëria siguruese në atë kohë. Shuma ka rimbursuar shpenzimet e kryera për përfitimin e këtij dëmi dhe kompensimin për asistencë dhe është përdorur për nevoja familjare dhe pjesërisht shlyerje huaje marrë M.H, motrës së bashkëshortes...”*

Subjekti paraqiti:

- **Deklaratë noteriale** nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.7.2011, lidhur midis shtetasen N. Ll dhe QSSRR, përfaqësuar nga Mithat Tola dhe B.K , ku specifikohet se nga shuma e përfituar prej 4.357.554 lekë, do të zbriten shpenzimet e kryera me herët, nga shtetasit Mithat Tola dhe B.K , ndërsa trashëgimtarja ka përfituar shumën 3.200.000 lekë.
- **Deklaratë**, datë 01. 07.2011, për pranimin e shumës së dëmshpërblimit dhe tërheqjen e çekut, që konfirmon se B.K , me adresë QSSRRR Tiranë, ka marrë nga BSHS, shumën 4.357.554 lekë, për shkak të aksidentit të ndodhur në datë 15.8.2009.
- **Mandat urdhërpaguese**, datë 8.7.2011, nga Alpha Bank, për kalimin e shumës 3.200.000 lekë nga Mithat Tola tek N. Ll.

Konstatohet:

- ✓ *Llogaria e subjektit në Alpha Bank është hapur dhe përdorur vetëm në funksion të përfitimit të vlerës së dëmit shëndetësor, për të cilin ka paraqitur dokumentacionin përkatës. Shuma totale prej 1.100.000 lekë, si rimbursim i shpenzimeve të kryera për përfitimin e këtij dëmi dhe kompensimin për asistencë, është përdorur për nevoja familjare dhe pjesërisht shlyerje huaje ndaj motrës së b/shortes (50% e saj, si pjesë takuese e subjektit).*

- ✓ *Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e OTP Bank. Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion, lidhur me transfertat e konfirmuara në Llogari.*

Pasuria nr.8

Llogari page në Raiffeisen Bank. Vlera 20.601 lekë. Zotëron 100 %

Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga.

Hetimi administrativ:

Raiffeisen Bank me shkresë me nr. *** prot., datë 7.8.2023, përcjell CD, që konfirmon llogari rrjedhëse në datë 8.3.2023, në shumën 19.202 lekë.

Konstatohet:

- ✓ *Raiffeisen Bank konfirmon gjendje llogarie në dt. 08.03.2023, në shumën 19.202 lekë.*

Pasuria nr.9

Llogari rrjedhëse në BKT. Vlera 0 euro. Zotëron 100 %

Hetimi administrativ:

BKT me shkresë nr.***, datë 14.08.2023, konfirmon Llogari rrjedhëse në euro, me gjendje në datë 8.3.2023, shumën 0 euro. Në llogari janë kryer transfertat, si vijon:

- Në datë 07.10.2009, depozituar cash shuma 4.000 euro dhe transferuar për shtetasin F.B shuma 5.000 euro;
Në datë 08.04.2010, transferuar nga shtetasi U.K shuma 500 euro;
Në datë 29.10.2010, transferuar nga H*** shuma 220 euro;
- Në datë 09.07.2012, transferuar nga shtetasi M.H shuma 13.000 euro, me përshkrimin: për pagesë kësti për apartament privat. Në datat 09.07.2012 dhe 27.07.2012, Mithat Tola ka tërhequr përkatësisht shumat 9.000 euro dhe 3.000 euro;
- Në datë 14.08.2012, transferuar shuma 1.500 euro nga F***;
- Në datë 01.11.2012, transferuar shuma 2.000 euro për shtetasin I.M ;
- Në datë 22.08.2013, transferuar nga shtetasi E.P shuma 190 euro;
- Në datë 26.09.2014, transferuar shuma 3.000 euro për AOL Studio ShPK; Gjithashtu figurojnë transaksionet si vijon:
- Dt. 29.12.2009, tërhequr shuma 1.000 euro;
- Dt. 06.04.2010, transferuar shuma 1.500 euro nga konvertimi; tërhequr shuma 2.500 euro;
- Në datat 11.05.2010, 29.07.2011, 07.10.2011, depozituar cash shuma totale 8.000 euro,
Në datat 28.02.2012, 20.03.2012, 05.04.2012, tërhequr shuma totale 5.500 euro;
- Dt. 26.04.2012, transferuar shuma 503 euro nga konvertimi; tërhequr shuma 2.000 euro;
Në datat 10.05.2013, 31.05.2013, 03.06.2013, 17.06.2013, 19.06.2013, 21.06.2013, tërhequr shuma totale 2.400 euro;
- Dt. 07.10.2014 transferuar shuma 2.000 euro nga konvertimi dhe tërhequr;
- Në datat 26.12.2014, 29.12.2014, transferuar shuma 1.926 euro nga konvertimi dhe datë 29.12.2014, tërhequr shuma 2.000 euro;

- Në datë 10.06.2015 transferuar shuma 800 euro nga konvertimi dhe në datë 16.06.2015 tërhequr shuma l. 000 euro;
- Në datë 10.09.2015 transferuar shuma 300 euro nga konvertimi dhe tërhequr;
- Në datë 02.06.2016 transferuar shuma 1.000 euro nga konvertimi dhe tërhequr;
- Në datë 08.03.2017 transferuar shuma 500 euro nga konvertimi dhe tërhequr..

Në proces-verbalin e datës 20.3.2024 të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga trupa e vlerësimit lidhur me depozitimin e shumës 4.000 euro në dt. 07.10.2009, subjekti sqaroi se: *"...këto likuiditete i ishin dhënë dorazi nga baxhanaku z. P.F për t 'ia dhënë shtetasit F.B , kunati i tij. Pas depozimit në bankë të vlerës 4.000 euro, bashkë me gjendjen që kishte në llogari, transferoi vlerën 5.000 euro shtetasit F.B , me qëllim përfitimim e një apartamenti që ky shtetas bleu në atë periudhë në qytetin e Korçës. Nga shuma 5.000 euro, i është kthyer me bankë vlere 1.500 euro, në dt. 14.08.2012, nga shtetasi F.B dhe pjesën tjetër ky shtetas i 'a ka shlyer dorazi baxhanakut të tij z. P.F.*

*Vlera 500 euro e transferuar në llogari në dt. 8.4.2010, nga shtetasi U.K , lidhet me pagesën e një siguracioni "kasko " për mjetin e markës "JEEP" në pronësi të tij, të cilën subjekti i 'a kishte porositur dhe marrë pranë "****" Sha*

*Transferta dt. 29.10.2010, në shumën 220 euro është nga "**** ", kompani kroate e dhënies së mjeteve me qira, për ndihmën teknike dhënë një klienti kroat, i cili ishte përfshirë në një aksident rrugor me pasojë, në zonën rrugore të qarkut të Shkodrës. Për transfertën e kryer në dt. 1.11 . 2012, në' shumën 2.000 euro, për shtetasin I.M (shtetas kosovar), sqaroi se e ka bërë me kërkesë të baxhanakut z. P.F, me banim në Hamburg, Gjermani, për të mundësuar nevojat e mikut të tij, I.M . 190 shumë i është likuiduar nga baxhanaku.*

*Transferta e shumës 13.000 euro, e kryer në dt. 9.7.2012, në llogarinë e subjektit nga shtetasi M.H , me përshkrimin: "Pagesë kësti për apartament privat ", si dhe tërheqjet e kryera nga subjekti në datat 9.7.2012 dhe 27.7.2012, përkatësisht në shumat 9.000 euro dhe 3.000 euro, kishin si qëllim blerjen e një apartamenti nga shtetasi M.H . Ky është shtetas gjerman me banim në Hamburg, Gjermani dhe është mik i familjes së subjektit dhe i familjes së baxhanakut P.F. Në vitin 2011, ky shtetas porositi një apartament në qytetin e Sarandës dhe ka lidhur një kontratë të ligjshme noteriale, datë 25.2011, për porositjen e apartamentit pranë sipërmarrësve z. R.DH dhe A.P , që janë administratorë të Shoq. "****" ShPK. Sipas kontratës së porosisë z. M.H ka paguar shumën 35.000 euro në momentin e lidhjes së kësaj kontrate porosie dhe pjesa tjetër do paguhej me këste deri në regjistrimin e apartamentit në ZVRPP Sarandë dhe realizimin e kontratës përfundimtare. Duke konsideruar faktin se shtetasi gjerman M.H do të largohej nga Shqipëria për në Hamburg Gjermani, pjesën e kështit të dytë të përmendur në kontratë, e depozitoi në numrin e llogarisë së subjektit në BKT, për të kryer veprimet e sipërcituara. Në periudhën e kërkuar në marrëveshje me sipërmarrësit, subjekti ka kryer pagesat për llogari të shtetasit M.H , pas muajit shtator 2011. Të gjithë veprimet dhe ndihma e dhënë për shtetasin M.H janë kryer në kuadër miqësor (pa pagesë) dhe subjekti ka ndjekur të gjithë procedurat deri në përfundimin e punimeve të apartamentit dhe marrjen e certifikatës së pronësisë për llogari të këtij shtetasi.*

Transferta e shumës 3.000 euro në dt. 26.9.2014, krijuar nga aktiviteti privat i subjektit është transferuar për "AOL Studio ShPK, për nevoja të aktivitetit privat të bashkëshortes dhe është pasqyruar në llogaritë e kompanisë.

Veprimet bankare, tërheqje dhe konvertimet nga lekë në euro dhe anasjelltas, lidhen me aktivitetin privat. Gjatë këtij aktiviteti ka pasur shpenzime apo pagesa të natyrave të ndryshme dhe në kohë e periudha të ndryshme, i është dashur të tërheqë likuiditete nga llogaria personale

apo llogaria e QSSRRR, t'i konvertonte dhe t'i depozitonte në llogari sipas rastit dhe natyrës së shërbimit. Këto veprime lidheshin edhe me nevojat familjare si psh: ushqimi, veshmbathje, udhëtime, riparime të mjeteve, shpenzime shkollimi, etj....”

Subjekti paraqiti

- **Faturë e Thjeshtë Tatimore**, datë 28.9.2010, me palë blerëse Shoqëria "****", për "Konsulencë dhe asistencë, etj. në shumën 490 euro/ 67.200 lekë. Kontratë Porosie me nr. ***rep, nr. *** kol., datë 2.5.2011, për apartament banimi me sip. Totale 78.40 m2 dhe sip. ndërtimi 56.70 m2, me adresë "****" Sarandë, me palë investitorë: sipërmarrësit z. R.DH dhe z. A.P , dhe palë porositore shtetasin M.H , në vlerën 65.000 euro (Bashkëlidhur: planimetria).
- **Kontratë Shitblerje** nr. *** rep., dhe nr. ***kol., datë 19.10.2017 për ap. me sip. 56.70 m2, Sarandë, R". "Butrinti regjistruar në ZVRPP Sarandë, me nr. pasurie ***, vol. ***,fq. ***, zk. ***, me palë shitëse: sipërmarrësit z. A.P dhe z. R.DH dhe palë blerëse shtetasin M.H , në vlerën 65.000 euro.
- **Statement bankar** nga BKT, datë 20.10.2016, që konfirmon transfertën e shumës 10.000 euro nga shtetasi M.H për shtetasin R. Dh, me përshkrimin "kalim kësti për blerje apartamenti, sipas kontratës me nr. ***rep., dhe nr. *** kol.

Konstatohet:

- ✓ *Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e BKT. Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues lidhur me transfertat e konfirmuara në llogari.*

Pasuria nr.10

Llogari rrjedhëse në ABI Bank. Vlerat: 2.208 lekë dhe 0 usd. Zotëron 100 %. Llogaria nuk është aktive prej vitit 2010.

Hetimi administrativ:

ABI Bank me shkresë me nr. ***prot., datë 7.8.2023, konfirmon:

Llogari kursimi nr. ***, hapur në datë 1.12.2010 në shumën 2.159 lekë. Në llogari nuk janë kryer veprime. Gjendja në datë 24. 1. 2023 është 2.*** lekë.

Llogari kursimi nr. ***, hapur në datë 1. 122010, në shumë 0.01 usd. Në llogari nuk janë kryer veprime. Gjendja në datë 24. 1. 2023 është 0.01 usd.

Konstatohet:

- ✓ *ABI Bank konfirmon llogari kursimi në vlerën 2.215 lekë dhe 0.01 usd.*

IV. DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

Subjekti i vlerësimit Mithat Tola ka dhënë këto deklarime të ardhurave në vite:

- Të ardhura nga paga, shpërblime, dieta, maj 2018 - shkurt 2023. Shuma totale 5.463.972 lekë. Paguar në llogarinë bankare BKT; maj 2018 - shtator 2019, shuma 1.758.684 lekë;

tetor 2019 - nëntor 2021, shuma 2.261.101 lekë; nëntor 2021 - 31.12.2021, shuma 169.011 lekë; viti 2022, shuma 1.134.970 lekë; janar 2023 — shkurt 2023, shuma 175.206 lekë.

- Të ardhura nga paga, shpërblime, veshmbathje, udhëtime + dietat, periudha 14. 11.2013 deri në 30.4.2018. Sipas të ardhurave të nxjerra nga llogaria personale në BKT dhe Raiffeisen Bank. Shuma 6.102.415 lekë.
- Të ardhura nga pagesa kalimtare (kalimi në reformë). Korrik 2007 — korrik 2009, sipas derdhjeve në numrin e llogarisë bankare në Raiffeisen Bank. Shuma 1.177.920 lekë.
- Të ardhura nga aktiviteti privat profesion i lirë "ekspert për sigurinë rrugore" (kryerje "akte ekspertimi" për organet e prokurorisë, gjykatave, konsulencë në fushën e dëmeve dhe shëndetit, komisione në sigurime, trajnime, etj., për periudhën 7.2007 deri 10.2013, jashtë radhëve të Policisë së Shtetit.
- Sipas të dhënave të nxjerra nga llogaria bankare në Raiffeisen Bank. Shuma 2.019.*** lekë. Sipas të dhënave të nxjerra nga llogaria bankare në BKT. Shuma 9.164.322 lekë.
- Të ardhura nga angazhimi si "Lektor i Jashtëm" pranë UPT, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Studimet Master për periudhën 2009 — 2014, sipas llogarisë bankare në BKT dhe Raiffeisen Bank. Shuma 198.556 lekë.
- Të ardhura nga puna, si specialist në DPRR, për periudhën 07.2001 deri në 05.2005 (Sipas vërtetimit me nr. 1656, datë 17.4.2018, i Sektorit të Financës për Aparatin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit). Shuma 2.228.722 lekë.
- Të ardhura nga puna, shpërblime, udhëtime, dieta, pagesë kalimtare nga puna në Drejtorinë e Policisë së Shtetit për periudhën prill 2005 deri në qershor 2007. Sipas të dhënave të nxjerra nga llogaria bankare personale në Raiffeisen Bank. Shuma 2.445.383 lekë.
- Të ardhura nga puna, shpërblime, udhëtime, dieta si specialist në Drejtorinë e Policisë Rrugore, për periudhën 01.1998 deri në 06.2001, sipas vërtetimit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MB. Shuma 604.289 lekë.
- Të ardhura nga puna, shpërblime, udhëtime + dieta, si kontrollor i Policisë Rrugore pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, Komisariati Nr. 3, për periudhën 12.1995 deri në 27.9.1998. Shuma 433.764 lekë.
- Të ardhura nga puna, shpërblime, udhëtime, dieta, si Shefi Komisarariatit të Policisë Librazhd dhe Gramsh, në periudhën 06.1994 deri në 1.11.1998. Shuma 216.882 lekë.
- Të ardhura nga puna, shpërblime, udhëtime + dieta, si Inspektor i Policisë Rrugore në Komisarariatit të Policisë Gramsh, për periudhën 29.10.1993 deri në 16.6.1994, të dhëna nga dosja e personelit në kartotekë. Shuma 72.294 lekë.
- Të ardhura nga aktiviteti Autoshkollë private 1993 - 1994. Shuma 1.168.000 lekë.
- Të ardhura nga puna si Inxhinier Mekanik, shkolla e mesme "Sh. Guzi", Gramsh 1988 — 1993. Shuma 40.500 lekë.

Bashkë lidhur deklaratës:

- **Vërtetim** nr. *** prot., datë 27.7.2022, nga Akademia e Sigurisë, që konfirmon se Mithat Tola ka përfituar të ardhura neto nga paga, për periudhën 1. 1.2022 - 31.7.2022.

Hetimi administrativ :

Raiffeisen Bank me shkresën nr. ***prot., datë 7.8.2023, konfirmon në emër të subjektit kreditimet e të ardhurave nga pagat, shpërblime, dietat dhe reforma, për periudhën 04.05.2005

-02.07.2009, rreth 3.261.000 lekë dhe kreditimet e të ardhurave si ekspert dhe likuidim komisionesh nga ***, për periudhën korrik 2008 — tetor 2013, rreth 1.160.000 lekë.

BKT me shkresë nr.***, datë 14.8.2023, konfirmon në emër të subjektit:

Llogari në lekë, ku kreditimet për komisione, honorare, ekspert dëmsh, etj., për periudhën 2008 — 2013, rezultojnë në shumën totale rreth 5.096.000 lekë• mësimdhënie për periudhën dhjetor 2011 - korrik 2019, rreth 250.000 lekë; pagat, dieta, shpërblime nga DPP dhe Akademia e Sigurisë, për periudhën dhjetor 2013 — mars 2023, rreth 11. 689.000 lekë. Për periudhën 2015 - 2018, janë kredituar nga Prokuroria dhe Gjykata, shuma totale rreth 156.000 lekë.

Gjithashtu, konfirmohen depozitime cash nga ana e subjektit, për periudhën mars 2008 - qershor 2014, në shumën totale 3.910.000 lekë si vijon: dt. 02.11.2009, shuma 150.000 lekë,• dt.12.02.2010, shuma 300.000 lekë,• dt. 8.6.2010, shuma 300.000 lekë, dt. 18.11.2010, shuma 300.000 lekë, dt. 24.02.2011, shuma 200.000 lekë, dt. 19.04.2011, shuma 70.000 lekë; dt. 19.07.2011, shuma 40.000 lekë; dt. 11.01.2012, shuma 300.000 lekë, dt.29.03.2012, shuma 250.000 lekë, dt. 26.04.2012, shuma 250.000 lekë, dt. 29.08.2012, shuma 150.000 lekë, dt. 09.04.2013, shuma 150.000 lekë, dt. 27.06.2013, shuma 550.000 lekë, dt. 17.07.2014, shuma 600.000 lekë, dt. 07.10.2014, shuma 100.000 lekë, dt. 26.12.2014, shuma 100.000 lekë; dt. 29.12.2014, shuma 100.000 lekë,

Llogari rrjedhëse në euro, ku të ardhurat nga komisionet për periudhën 2008 - 2013, rezultojnë në shumën totale rreth 5.880 Euro (kreditimet totale 8.880 euro, nga të cilat transferuar shtetasit B.K, shuma 3.000 euro). Në datë 05.03.2015 është kredituar nga Albtelecom për pagesë seminari, shuma 141 euro.

Credins Bank me shkresë me nr. ***prot., datë 31.8.2023, konfirmon se Mithat Tola ka pasur llogari page në lekë, e cila rezulton e mbyllur në vitin 2012. Në datë 21.2.2012, është kredituar nga UPT, Fakulteti Inxhinierisë, shuma 16.200 lekë.

OKB, me shkresë me nr.***prot., datë 7.8.2023, konfirmon se Mithat Tola nuk figuron të jetë pajisur me NUIS (NIPT), si person fizik apo të zotërojë kuota/aksione në shoqëri tregtare regjistruar pranë regjistrimit tregtar.

DPT me shkresën nr.*** prot., datë 7.8.2023, i kërkon DRT Tiranë të dërgojë informacionin e kërkuar pranë ILDKPKI.

DRT Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 17.8.2023, konfirmon se Mithat Tola, nuk figuron i regjistruar në organet tatimore për ushtrim të ndonjë aktiviteti privat.

DRT Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 21.12.2023, konfirmon se Mithat Tola, nuk është i regjistruar për përgjegjësinë tatimore DIVA. Lidhur me subjektin "**** " me NIPT K***M, rezulton se shtetasi Mithat F.T është administrator i kësaj OJF, e Cila nuk është e regjistruar për përgjegjësinë tatimore tatimfitimi. Ky subjekt, për periudhën janar 2012 deri në dhjetor 2014 ka deklaruar me zero listë pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe ka kaluar me status pasiv në dt. 17.12.2014. Nga verifikimet e kryera në arshivën e institucionit, subjekti nuk ka dorëzuar pasqyra financiare për periudhën 2007 - 2013.

DRT Elbasan me shkresën nr. ***3 prot., datë 19.01.2024, konfirmon se nga verifikimi i kryer në sistemin tatimor C@ts, shtetasi Mithat F.T, nuk rezulton i regjistruar me NIPT, Individ

Privat. Referuar "Memo " dërguar nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse (Arshiva) protokolluar me nr. *** prot., datë 12.01.2024, bëhet me dije se nga kontrolli fizik i kryer në Arkivë, në dorëzimet e bëra nga Agjencia Tatimore Gramsh, për z. Mithat F.T, nuk rezulton asnjë dosje e depozituar pranë DR T Elbasan. Bashkëlidhur dokumenti nga sistemi tatimor C@ts.

ISSH me shkresë me nr.*** prot., datë 11.08.2023, konfirmon periudha kontributeve të Mithat Tola, mars 2012 — mars 2023 pranë: AOL Studio, ***, DPP, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Akademia e Sigurisë, Shkolla e Magjistraturës.

ISSH me shkresën nr. *** prot., datë 11.08.2023, konfirmon se i ka dërguar shkresë Drejtorisë së Arkivit Qendror Lundër, për të konfirmuar të ardhurat e realizuara për periudhën para vitit 2012.

ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror me shkresën kthim përgjigje me nr.***prot., datë 17.8.2023, nuk konfirmon të dhëna për periudhën 1994 — 2012, për shtetasin Mithat F.T. Bashkëlidhur: Vërtetim negativ nr. ***, prot., datë 14.08.2023, për vjetërsinë në punë për efekt pensioni.

Në proces-verbalin e datës 20.03.2024 të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se: *"...pas përfundimit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Elektrike, Dega Mekanikë gjatë viteve 1983 - 1988, ka punuar fillimisht si mësues në qytetin e Gramshit, pranë shkollës mekanike dhe shkollës së mesme të përgjithshme "Shefqet Guzi". Me Urdhër të Ministrit të Rendit Publik, datë 29.10.1993, është emëruar në detyrën e Inspektorit të Policisë Rrugore në Komisariatin e Policisë Gramsh, dt. 01.11.1993.*

Gjithashtu, për periudhën qershor 1997 - dhjetor 2002 është trajtuar me taksë solidariteti: qershor 1997 - dhjetor 1997, trajtuar me shpërblim nga fondet e MB në shumën 15.000 lekë/muaj, gjithsej 105.000 lekë • janar 1998 - dhjetor 1998, trajtuar me taksë solidariteti 15.000 lekë/muaj, gjithsej 180.000 lekë • janar 1999 - dhjetor 1999, trajtuar me taksë solidariteti, sipas kategorizimit në urdhrat e ministrit të Brendshëm, për funksionin si oficer policie, gjithsej 180.000 lekë • janar 2000 - dhjetor 2000, trajtuar me taksë solidariteti 15.000 lekë/muaj, gjithsej 180.000 lekë.

Lidhur me vendbanimin në periudhën tetor 1993 — nëntor 1995, subjekti sqaron se: kur ka qenë i punësuar në Gramsh, deri në periudhën e transferimit me detyrë si Shefi i Komisarariatit të Policisë Librazhd, në muajin maj 1994, ka banuar së bashku me prindërit në apartamentin e përfutur nga privatizimi i banesave në zotërim të familjes, kohë në të cilën, apartamentin në Gramsh e kishin shitur "de facto " dhe pjesa tjetër e familjes ishte transferuar në Tiranë, në një ambient — dhomë, të rregulluar në atë kohë në shtëpinë aktuale, e cila ishte në ndërtim e sipër. Nga muaji qershor 1994 deri në muajin mars 1995, ka banuar në familjen e b/shortes, të fejuar në atë kohë. Në periudhën e punës në qytetin e Librazhdit, mars 1995 - nëntor 1995 ka banuar në Librazhd, në ambientet e Komisarariatit të Policisë, pasi ngjitur me zyrën e punës ka pasur një ambient banimi (fjetje), në të cilën ka banuar, pasi që në atë periudhë Komisariatit të Policisë kishte kushte dhe një sallë ngrënie — mensë, ku trajtohej me ushqim të paguar nga Ministria e Rendit Publik i gjithë efektivi i Komisarariatit.

Me urdhrin nr. ***, datë 29.6.2007, të Ministrisë të Brendshme është larguar nga Policia e Shtetit "Për shkurtim të funksionit organik" dhe është trajtuar me pagesë kalimtare për tre vite me 50 0/0 të pagës. Në vitin 2009 është ndryshuar ligji nr. 8661, datë 18.09.2000 "Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit" duke modifikuar dispozitën dhe duke përcaktuar se: "pika 2 - Paguesa kalimtare jepet kur përfituesi ka jo më pak se 3 muaj shërbim. Paguesa kalimtare llogaritet në masën 50 0/0 të pagës referuese mujore dhe fillon në muajin e tretë nga data e nxjerrjes në rezerve apo lirim. 3 - Trajtimi financiar me shpërblim e menjëhershëm dhe me pagesë kalimtare për të dy Llojet e përfitimeve së bashku, zgjat për aq muaj sa përftuesi ka vjetërsi shërbimi, por jo më shumë se 24 muaj Duke konsideruar ndryshimin e legjislacionit të mësipërm dhe ndërprerjen e pagesës për vitin e tretë, sikundër ishte përcaktuar në urdhrin e daljes në lirim të parakohshëm, dt. 22.12.2010, subjekti ka kërkuar vazhdimin e trajtimit edhe për vitin e tretë pas largimit nga Policia. Gjykata e Shkallës së Parë, me vendim nr. 5014, datë 10.06.2012 dhe Gjykata e Apelit, me vendim nr. ***, datë 27.04.2012, vendosën dëmshpërblimin dhe vazhdimin e pagesës edhe për vitin e tretë të ndërprerë arbitrarisht. Në llogarinë rrjedhëse, në datat 10.01.2014 29.04.2014 dhe 07.2014, është kredituar Ekzekutimi i Vendimit Gjyqësor, në shumën totale 392.640 lekë. Lidhur me të ardhurat e deklaruara nga aktiviteti privat për periudhën jashtë radhëve të Policisë së Shtetit, sqaroi se: në vitet 2007 — 2013, kur është larguar nga Policia e Shtetit, ka punuar në sektorin privat, në profesion të lirë, si ekspert apo në angazhime të ndryshme, po në sektorin privat. Në vitin 2007 ka themeluar organizatën "**** " OJF me "Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. ***, datë 24.09.2007" e pajisur me Licencë dhe Leje për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e konsulencës tekniko - ekonomike dhe të sigurisë rrugore nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, datë 31.12.2007. 190 qendër është certifikuar me "Certifikatën e Deklarimit të Aktivitetit në ISHP" pranë "Inspektoratit Shtetëror të Punës ". Në periudhën 2007 - 2013, aktiviteti privat është orientuar kryesisht në: Kryerjen e akteve të ekspertimit teknik dhe shkëlqes se rregullave të qarkullimit rrugor në rastet e aksidenteve rrugore me pasoja dhe me dëme materiale, si pranë organit të Prokurorisë, ashtu edhe në Gjykatat e Shkallës së Parë dhe në Gjykatat e Apelit, në të gjithë territorin e vendit; Dhënia e ndihmës automobilistike për subjekte private dhe kompani të ndryshme transporti dhe kompani që kanë administruar flota mjetesh transporti dhe kryejnë shërbime të ndryshme në rrugë.

Ndihma automobilistike dhe logjistike përfshin edhe ndërmjetësim pranë kompanive/shoqërive të sigurimit për nevoja të pajisjes me "polica sigurimi TPL " dhe "polica sigurimi kasko "për mjetet dhe për personelin që ka qenë i punësuar në këto kompani edhe ndërmjetësimin për "kontrata të sigurimit të jetës dhe të shëndetit në punë "; Trajnime të specializuara për kompani publike vendase dhe të huaja në fushën e sigurisë rrugore dhe të parandalimit të aksidenteve rrugore; Konsulencë dhe asistencë teknike dhe ligjore për familje dhe persona, të cilët kanë humbur njerëzit e tyre të afërm në aksidente rrugore, me qëllim përfitimin e "dëmit shëndetësor " pranë kompanive të sigurimit vendase dhe pranë Byrove të Sigurimit të huaja - referuar — ligjit: "Për sigurimin e detyrueshëm në fushën e transportit rrugor "; Kryerje akte vlerësimi për mjete të dëmtuara etj.; Asistencë ligjore në fushën e ndëshkimit administrativ të drejtuesve të mjeteve, pranë gjykatave civile dhe administrative.

Referuar fushave të konsulencës të përcaktuar në licencë, një nga fushat ka qenë konsulencia dhe dhënia e ndihmës për kompani dhe subjekte private, për t 'u pajisur me sigurim të detyrueshëm të mjeteve, karton jeshil, sigurim shëndeti në udhëtim, etj., që kompanitë dhe

subjektet kanë pasur në posedim pranë kompanive të sigurimit. Pagesat për shërbimet e mësipërme janë kryer në Llogarinë e "****" Për efekt të pagesave të ndryshme dhe shpenzimeve, subjektit i është dashur tërheqja e shumave, një pjesë e të cilave janë depozituar në numrin e tij të llogarisë në BKT (sikurse edhe është konstatuar). Sipas kontributit dhe punës së kryer dhe sipas përshkrimeve të mësipërme, subjekti si "Drejtor Ekzekutiv " i QSSRRR (në atë periudhë), ka kryer tërheqje nga Llogaria bankare e "QSSRRR

Shumat e evidentuara në Raiffeisen Bank, në periudhën 2007-2013, i përkasin këtij aktiviteti dhe për çdo rast janë lëshuar fatura të thjeshta tatimore sipas legjislacionit në fuqi për kohën. Gjithashtu, vlerat financiare që janë kredituar në BKT, në periudhën mars 2008 - qershor 1014, janë të ardhura nga aktiviteti i QSSRRR

Në deklarinë e të ardhurave në shumën totale 9.164.322 lekë, sipas të dhënave të nxjerra nga Llogaria bankare në BKT, ka përfshirë edhe shumat e depozituara cash, të cilat janë tërhequr paraprakisht nga Llogaria bankare e QSSRR. Pra, në mënyrë të përmbledhur, shumat e depozituara cash janë tërhequr nga Llogaria e QSSRR dhe janë përfshirë në shumën e deklaruar të të ardhurave nga aktiviteti privat.

Në ndonjë rast, nga vlerat e kredituar, një pjesë janë e ardhur e kolegut, B.K, i cili, ashtu si subjekti, ishte ekspert dhe përfaqësues i QSSRRR. Konkretisht sqaron se; dt. 26.6.2009 është kredituar shuma 5.552 euro nga ***, e cila ishte e ardhur e subjektit dhe kolegut B.K nga komisioni TPL, nga e cila ka transferuar shumën 3.000 euro, e cila ishte pjesë takuese e tij B.K; dt. 9.6.2014 është kredituar shuma 600.000 lekë nga QSSRRR, e cila ishte e ardhur e subjektit dhe kolegut B.K, me pjesë takuese 50% secili. Subjekti ka qenë personi i autorizuar për të kryer veprimet në Llogarinë e QSSR.

Lidhur me kreditimet nga prokuroritë dhe gjykatat, për periudhën 2015 - 2018, rreth 156.000 lekë, subjekti sqaron se janë pagesa të prapambetura, por edhe për çështje kur është thirrur në cilësinë e punonjësit/ekspertit të policisë rrugore, me shkresë drejtuar DPP nga prokuroritë dhe gjykatat.

Lidhur me aktivitetin e QSSRR si OJF, sqaron se janë përgatitur dhe paraqitur mjaft projekte të sigurisë rrugore pranë organizatave/institucioneve publike vendase dhe të huaja, por pa ia dalë të sigurojë financime. Nga eksperiencia dhe bazuar në legjislacionin e kohës, OJF-të nuk kishin detyrim regjistrimin për përgjegjësi tatimore tatimfitim dhe paraqitja e bilanceve ose pasqyra financiare të ardhurash, me përjashtim ndofta, të rasteve kur përfitonte projekte dhe i implementonte ato, ku duhet të raportonte mënyrën e shpenzimit të financimit, pranë donatorit dhe pranë organeve tatimore.

Lidhur me kalimin në status pasiv të QSSRR, në dt. 17.12.2014, sqaroi se prej dt. 02.11.2013 ka dhënë dorëheqjen nga detyra në këtë qendër, dorëheqje e cila është depozituar në organet përkatëse.

Për një periudhë kohe, deri në rifillimin e punës pranë DPI), sig shoq. dhe shënd. janë paguar nga Shoq. "AOL Studio ". Subjekti nuk ka marrë paga nga Shoq. "AOL Studio " Shpk, por deklarimi është bërë vetëm për efekt të sigurimeve.

Subjekti paraqiti

- Vërtetim nr. *** prot., datë 12.4.2022, "Për vjetërsinë në punë për efekt pensioni " nga DRSSH Elbasan, sipas të cilit Mithat Tola ka punuar nga data 2.12.1988, si mësues pranë Shkollës së Mesme Gramsh;

- Akt Verifikimi, datë 13.04.2022, nga DRSSH Elbasan, Agjencia Gramsh, sipas të cilit Mithat Tola periudhat 1.1.1989 - 31.12.1990 dhe 1.1.1991 - 15.11.1993, ka punuar si mësues në shkollën "Shefqet Guzi " Gramsh,.
- Dokument nr. *** prot., datë 29.10.1993, nga Ministria e Rendit Publik, për emërimin oficer të shtetasit Mithat Tola;
- Urdhër nr. *** , datë 30.07.2001, nga Ministria e Rendit Publik, për emërimin në detyrë si Shefi Zyrës së Qarkullimit Rrugor në Sektorin e Qarkullimit dhe Sigurisë Rrugore, në Drejtorinë e Policisë Rrugore, DPP;
- Urdhër nr. *** datë 15.10.2003, nga Ministria e Rendit Publik, për dhënien e gradës "Komisar " punonjësit të policisë Mithat Tola;
- Vërtetim nr. *** prot., datë 24.7.2019, nga DPPSH, që vërteton se për Mithat Tola, ish —punonjës policie në Komisariat Gramsh, DVP Elbasan, për periudhën shkurt 1993 - 28.2.1995, nuk mund të lëshohet vërtetim për pagën bruto dhe pagën neto, pasi listë pagesat janë djegur nga trazira e vitit 1997;
- Vërtetim nga DRSSH Elbasan, sipas të cilit Mithat Tola ka punuar në DVP Elbasan, për periudhën prej mars - tetor 1995 dhe ka realizuar të ardhura neto 96.392 lekë
- Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 27.11.2019, nga DPPSH që konfirmon se Mithat Tola ka përfituar të ardhura neto nga pagat, për periudhën 16.12.1998 — 30.6.2001, në shumën totale 611.726 lekë (v. 1998, shuma 16.494 lekë; v. 1999, shuma 225.266 lekë, v.2000, shuma 234.773 dhe 1.1.200/ - 30.6.2001, shuma 135.193 lekë).
- Vërtetim nga Ministria e Brendshme, që konfirmon se Mithat Tola, ish-punonjës, ka përfituar të ardhura nga pagat për periudhën l. 12.1998 — qershor 2001,.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 17.04.2018 nga DPPSH, që konfirmon se Mithat Tola, për periudhën l. 7.2001 — 31.05.2005 ka realizuar të ardhura neto nga paga në shumën 2.228.722 lekë,.
- Urdhra për trajtimin me taksën e solidaritetit: nr. *** , dt.16.04.1997; nr. *** , dt. 15.02.1999; nr.***dt. 13.05.1997; nr. *** , dt. 26.11.1998, nr. *** , dt. 13.05.1997, nr. *** , dt. 15.03.1997,
- Licencë nr. *** , datë 31.12.2007, për konsulencë tekniko — ekonomike, në veprimtarinë e transportit rrugor, lëshuar nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për personin juridik "**** „Shpk, me administrator B.K dhe Mithat Tola. Fusha e veprimtarisë së konsulencës e përcaktuar në licencë është: a). Drejtimi i veprimtarisë të sipërmarrjeve dhe agjencive të transportit rrugor për udhëtarë dhe mallra; b). Ekspertizë në njohjen dhe zbatimin e legjislacionit të trafikut rrugor, sigurisë së qarkullimit të mjeteve në rrugë, si dhe të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushat e transportit rrugor; c)përcaktimin e kërkesave tekniko - ekonomike në blerjen e makinerive dhe pajisjeve për sektorët e ndryshëm të transportit; d). Ekspertizë për llogaritjen e kostove operacionale dhe optimumeve ekonomike në operacionet e transportit të brendshëm dhe të ndërkombëtar të udhëtarëve dhe të mallrave; e). Ekspertizë në vlerësimin e dëmeve materiale që shkakton një mjet motorik në rrugë; f).Këshillimin, asistencën në lidhje me plotësimin e dokumentacionit të kërkuar për operim në transport;
- Certifikatë Regjistrimi nr. *** , datë 27.9.2007, nga DPT, për personin e tatueshëm "****" (QSRR) me NIPT K****M.
- Vërtetim me nr. *** prot., datë 4.12.2019, nga "**** Services" Shpk trajtues dëmsh, autorizuar nga shoqëria "****" Sha dhe "****" Sha, që vërteton se Mithat Tola, ing. mekanik, administrator i *****, ka kryer vlerësime të dëmeve materiale dhe jo materiale

për llogari të shoqërive "****" "Sha dhe "****" Sha, si specialist në fushën e trajtimit të dëmeve materiale dhe shëndetësore, që mbulohen nga kontrata për sigurimin e detyrimeve në; sektorin e transportit, në periudhën kohore 2008 — 2013;

- Vërtetim page me nr. *** prot., datë 10.2.2009, që konfirmon se Mithat Tola është trajtuar financiarisht nga Aparati i DPPSH, me pagesë kalimtare mujore 32.720 lekë, Vendim nr.***, datë 27.7.2012, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kërkues Mithat Tola, për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit të vendimit nr. *** , datë 10.6.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pranimin pjesërisht të padisë dhe detyrimin e palës së paditur Ministria e Brendshme që të vazhdojë pagesën kalimtare, deri në përfundimin e afatit 3 vjeçar të përfitimit në bazë të Ligjit nr. 866, datë 18.9.2000 "Për sigurimin shoqëror suplementar të; punonjësve të policisë së shtetit";
- Statement bankar nga BKT, për Llogari në emër të QSSRR, ku figurojnë tërheqjet cash nga Mithat Tola, për periudhën 2009 - 2014; dt. 2.11.2019, shuma 328.000 lekë; dt. 12.2.2010, shuma 600.000 lekë,• dt. 18.11.2010, shuma 300.000 lekë,• dt. 24.2.2011, shuma 500.000 lekë; dt. 11.1.2012, shuma 600.000 lekë; dt.29.3.2012, shuma 500.000 lekë,• dt.9.4.2013, shuma 300.000 lekë; dt. 27.6.2013, shuma 300.000 lekë,• dt. 17.6.2014, shuma 800.000 lekë.
- Vërtetim nga Sigma Viena Insurance nr. ****, dt. 8.3.2024, sipas të; cilit QSSRR ka pasur bashkëpunim, i cili është rregulluar me kontratën dt. 14.10.2009, për ofrim shërbimi, asistencë dhe përfaqësim në fushën e aksidenteve rrugore me dëme materiale dhe dëme në njerëz. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, QSSRR referuar kontratës ka përfituar pagesa për shërbimet e kryera, kundrejt faturave të thjeshta tatimore. Për përfitimet financiare, si në Çdo rast është respektuar legjislacioni tatimor ne fuqi,.
- Kontratë shërbimi dt. 14.10.2009, midis Interalbanian si klient nga njëra anë dhe QSSRR, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv Mithat Tola, nga ana tjetër, si ofrues i shërbimit, në fushën e dëmeve nga aksidentet rrugore. Klienti do t' i paguajë ofruesit të shërbimit, kundrejt faturave të thjeshta tatimore në emër të QSSRR e regjistruar me NIPT K***M vlerat financiare të dakortësuar midis palëve;
- Deklaratë dt. 5.3.2024, nga B.K, i cili deklaron bashkëpunimin në funksion të kryerjes së aktivitetit të QSSRR. Bashkëlidhur: ID e B.K nr.***;
- Deklaratë dt. 2.11.2013, ku Mithat Tola, i drejtohet bordit drejtues të QSSR për depozitim e dorëheqjes së tij nga detyra e Drejtorit Ekzekutiv. Gjithashtu, kërkohet caktimi i një personi për të kërkuar kalimin e qendrës në status pasiv, pasi të dy drejtuesit aktualë kanë dhënë dorëheqjen nga detyra në këtë qendër,.
- Vërtetim nr. *** , dt. 2.12.2020, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Zyra e regjistrimit të OJF, sipas të cilit, me vendimin nr. *** , dt. 24.9.2007 është regjistruar si person juridik, organizata jofitimprurëse QSSR,.
- Vendim nr. *** , datë 24.9.2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, "Për regjistrimin të personit juridik të Organizatës Jofitimprurëse, në formën e qendrës me emërtimin "**** (QSSRRR) " e cila ka si themelues të saj B.K dhe Mithat Tola. Pasuria e Qendrës përbëhet prej 100.000 lekë, e cila është kontribut i themeluesve në masën 50% secili,.
- Certifikatë e Deklarimit të Aktivitetit me nr. *** , datë 26.9.2007, nga ISHP, që vërteton se B.K dhe Mithat Tola, në mbështetje të Vendimit të Gjykatës nr. *** , ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në sektorin O.J. F.

Konstatohet:

- ✓ Të ardhurat e subjektit nga paga, shpërblimet, dietat, reforma, taksa e solidaritetit, mësimdhënie, etj., për periudhat mars 1995 — korrik 2009 dhe dhjetor 2013 — mars 2023, rezultojnë në vlerën totale rreth 18.954.000 lekë + 141 euro, e konvertuar rreth 18.970.000 lekë. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar të ardhura nga pagat për periudhën 1988 — 1998, në shumën totale rreth 763.000 lekë.
- ✓ Të ardhurat e subjektit nga aktiviteti privat i OSSRR, për periudhën mars 2008 — qershor 2014 (përfshihen edhe pagesat e prapambetura për v. 2013 kryer në v. 2014), rezultojnë në vlerën totale rreth 10.166.000 lekë + 5.880 euro, e konvertuar rreth 10.842.000 lekë.
- ✓ Të ardhurat nga aktiviteti privat Autoshkollë, gjatë periudhës 1993-1995, në shumën 1.168.000 lekë, janë trajtuar më sipër, në rubrikën e deklarimit të pasurive të subjektit.

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

Të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur, Periudha 01.01.2022 - 31.12.2022.

- Për furnizimin me ujë të banesës: 20.563 lekë; Për furnizimin me energji elektrike: 87.222 lekë; Për telefon fiks dhe internet: 54.428 lekë; Për shërbim celular: 10.108 lekë (unë dhe vajza). (Sipas librezave të pagesës dhe faturave bankare në BKT). Shuma 172.320 lekë.
- Shpenzime për taksa, sigurim, mirëmbajtje të mjeteve në pronësi të familjes; Shpenzime banese, punime, arredime etj. ***.000 lekë/viti 2022.
- Shpenzime periodike për apartamentin në Hamburg, Gjermani, nga Arjola Tola. Arredim/taksa/ujë/ngrohje. Shuma 2.932 euro.
- Shpenzime energjie elektrike/internet/celular nga Nedra Tola. Shuma 1.576 euro.

Hetimi administrativ

FSHU me shkresën nr. *** prot., datë 9.8.2023, konfirmon se referuar të dhënave të sistemit të faturimit, subjekti dhe personat e lidhur me të, nuk rezultojnë të jene abonent dhe të kenë kontratë të furnizimit me energji elektrike.

Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 18.8.2023, konfirmon se për subjektin dhe personat e lidhur me të, nuk rezultojnë të dhëna për kontrata shërbimi të regjistruara në sistem në emër të tyre.

Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Vlorë, me shkresën nr. *** prot., datë 16.8.2023, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur me të, nuk janë klientë.

Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë 16.8.2023, konfirmon se në emër të shtetasit Mithat F.T, figuron e lidhur kontrata nr. *** me adresë Lgj. ***, Durrës dhe janë kryer pagesat për periudhën 1.1.2022 _31.12.2022. B/lidhur vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. ***, datë 30.11.2008, për apartament banimi me sip. 60 m2, nr.***, zk.***, me adresë Plazh, AP. ***. Sh.***, K. ***, në pronësi të Mithat Tola dhe Arjola Tola.

Shtetasit: Arjola Petrit Tola, Nedia Mithat Tola dhe Hera Mithat Tola, nuk janë klientë.

12 Shoqëritë Rajonale Ujësjellës Kanalizime, nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

Vodafone Albania, me shkresën nr. *** , datë 17.11.2023, përcjell CD, ku figuron se .Mithat Tola, ka të regjistruar numrat celular: 069*** me status aktiv nga dt. 31.1.2023; 0684037316 me status aktiv, bartur dt. 3.3.2023, në shoqërinë Vodafone Alb; 069*** me status aktiv nga dt. 6.11.2013 dhe për vitin 2022 janë paguar 8.682 lekë.

AOL Studio, me administrator Arjola Tola, ka të regjistruar numrin celular 069***, me status aktiv nga data 29.3.2022 dhe për vitin 2022 janë paguar 23.482 lekë. Nedia Tola, ka të regjistruar numrat celular me status in aktiv 069*** dhe 069***.

Hera Tola, nuk i korrespondon asnjë numër celular të shoqërisë Vodafone.

Mithat Tola, Arjola Tola, Nedia Tola dhe Hera Tola, nuk kanë kontrata të telefonisë fikse dhe/ose internet.

OneAlbania sh.a me shkresën nr. *** prot., dt. 25.8.2023, konfirmon se:

Mithat F.T, ka të regjistruar numrin celular 069*** dhe për periudhën l. 1.2022 — 31.12.2022 janë shpenzuar 14.001 lekë. Nedia Mithat Tola, ka të regjistruar numrin celular 068*** dhe për periudhën 1.1.2022 — 31.12.2022 janë shpenzuar: 5.000 lekë.

Albania Satellite Communications me shkresën nr. *** prot., datë 14.8.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

Abissnet sh.a me shkresën nr. *** prot., datë 14.8.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

Digicom sh.a, me shkresën nr.*** prot., dt.9.8.2023, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur, nuk kanë marrë shërbim interneti për periudhën 1.1.2022-31.12.2022.

BKT me shkresën nr.*** prot., datë 14.8.2023, konfirmon se Mithat Tola, për periudhën 1.1.2022 — 31.12.2022, ka kryer pagesa si vijon: Pagesa ndaj FSHU, për kontratën TRIF***, në shumën 95.965 lekë; Pagesa ndaj FSHU për kontratën DU***, në shumën 7.907 lekë• Pagesa ndaj UKT, në shumën 22.443 lekë. Pagesa ndaj UKT, në shumën 9.304 lekë• Pagesa për Vodafone Albania, në shumën 10.154 lekë • Pagesa për internet ndaj Albtelecom, në shumën 52.968 lekë.

Në proces verbalin e datës 20.3.2024 të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga trupa e vlerësimit subjekti sqaroi se; “... shpenzimet e deklaruara për furnizimin me energji elektrike dhe ujë, i përkasin banesës me adresë Rr. "Mark Sopi" Tiranë dhe apartamentit në Durrës me sip. 60 m2. Këto pagesa kryen me transfertë nga llogaria e pagës në BICT.

Për arsye të mos marrjes ende në disponim/dorëzim të apartamentit në Vlorë, nuk ka lidhur kontratë të furnizimit me ujë apo energji elektrike për këtë apartament dhe në marrëveshje mes palëve, subjekti vijon të paguajë shpenzimet për ap. në Durrës. Në apartamentin në Durrës kanë hyrë në fund të vitit 2007, pas lidhjes së kontratës së shitblerjes dhe pagesat për furnizimin me energji elektrike, i kanë filluar në vitin 2007. Lidhur me apartamentin në Hamburg,

Gjermani, shpenzimet e deklaruar përfshijnë. administrim/ taksa /ujë/ngrohje. Shpenzimet e b/shortes janë si vijon..

- Qira trualli e cila paguhet çdo 3 muaj, me pagesë mujore 34.5 euro dhe viti 2022 në total është 414 euro (sipas njoftimit nga kompania ***). Sipas kontratës Arjola Tola ka pronësinë vetëm mbi apartamentin, ndërsa për truallin paguan qira, e cila merret automatikisht nga *** , nga llogaria në Haspa çdo 3 muaj. Njoftimi i bëhet motrës së b/shortes së subjektit, për arsye lehtësimi pagese, pasi M.H jeton në Gjermani dhe është e autorizuar për kryerjen e këtyre veprimeve.
- Shpenzimet për ujë/ngrohje/administrim janë mujore prej 185 euro dhe viti 2022, në total është 2.220 euro sipas planit të biznesit të kompanisë së menaxhimit të bllokut të pallateve FPP ***. Furnizimi me ujë dhe ngrohja në bllokun e pallateve janë me sistem qendror dhe për çdo apartament është i Llogaritur.
- Shpenzimet për taksën e banesës (apartamentit), paguhet çdo 3 muaj me vlerë 75,64 euro dhe viti 2022 në total është 302 euro sipas njoftimit nga Zyra e Financave /taksave e Hamburg. 190 pagesë merret automatikisht nga Llogaria e b/shortes në Haspa. Për shpenzimet e vajzës Nedja Tola, e cila është e regjistruar si banuese në apartamentin në Hamburg, Gjermani, në pronësi të Arjola Tola, sqaroi se:
- Energjia elektrike është paguar nga momenti i hyrjes në apartament në maj 2022 dhjetor 2022, në shumën 553 euro (sipas dokumentit nga kompania elektrike ***). 190 shumë është paguar për vitin 2022, pasi nga bilanci me leximin e matësit dt. 19.3.2023, konsumi ka qenë më i vogël se sa ishte paguar dhe kompania VATENFALL, ka kthyer shumën 438,85 euro.
- Shpenzimet e internetit paguar nga Nedja Tola, nga data 29.4.2022 - dhjetor 2022 janë 19.95 euro/muaj dhe në total 120 euro ndërsa për periudhën 29.10.2022 — 29.12.2022 janë shpenzuar 39,95 euro në muaj dhe në total 80 euro.
- Shpenzimet për TV Radio shtetërore (ARI), ZDF, Radio) janë paguar nga Nedja Tola në shumën mujore 18,37 euro, e cila merret çdo 3 muaj automatikisht nga Llogaria bankare e saj në HASPA Bank. Për vitin 2022, Nedja Tola ka paguar për periudhën prill — dhjetor shumën totale 165.24 euro...”

Sqaroi se: “... shuma prej ***.000 leke e deklaruar ne zërin shpenzime për v. 2022, përfshin taksat, sigurimet e mjeteve, defektet e mundshme, etj. Nuk kanë bërë ndonjë shpenzim arredimi me vlerë mbi 300.000 leke, gjatë vitit 2022.

Shpenzimet për vitin 2022, për numrin cel. dhe internetin e shtëpisë, i ka kryer nga llogaria e pagës nëpërmjet BKT dhe deklarimi i vlerës është bërë me përafërsi, pasi nuk kanë mbajtur fatura. Për numrin celular Vodafone 069***, për vitin 2022 ka shpenzuar 8.682 leke dhe këto shpenzime janë mbuluar nga DPPSH.

Numrin celular regjistruar ne emër të “AOL Studio”, që posedon b/shortja, si administratore e shoqërisë, nuk e ka deklaruar si shpenzim, pasi pagesat për këtë numër janë llogaritur në shpenzimet e shoqërisë.

Shpenzimet e deklaruar nga vajza Nedja Tola, për numrin uluar që janë përfshirë në shumën 1.576 euro, i përkasin numrit të saj në Gjermani +49 152***. Për këtë numër paguan tarife mujore ne shumën 19,99 euro, në kompaninë OTELO dhe për periudhën l. 1.2022 — 31.12.2022 këto shpenzime janë përlllogaritur rreth 240 euro....”

Subjekti paraqiti

- **Vërtetim** datë 11.12.2018, nga OSHEE, që konfirmon se abonenti Mithat Tole (Tola) për kontratën me nr. TRIF***, nuk rezulton debitor;
- **Dokument i printuar nga sistemi i FSHU**, që konfirmon se klienti Mitat Tola, për kontratën me nr. TRIF***, për periudhën l. 1.2022 — 31.12.2022, ka paguar shumën rreth 96.422 leke;
- **Kthim përgjigje** dt. 15.7.2019 nga UKT Tiranë, sipas së cilës Mithat Tola ka kontratën me nr. 192324-1 për objektin ne RF. "Mark Imzot Sopi" me status aktiv,.
- **Kthim përgjigje** nr. *** prot., datë 3.3.2020, nga OSSH, që konfirmon se kontrata me vir. DUOA020247057458, rezulton në emër të abonentit Mithat Tola dhe furnizon me energji elektrike apartamentin Lagjja nr. 13, Durrës. Dokument nga OSHEE datë 3.2.2020, për detajet e pagesës së konsumatorit për vitet 2007 dhe 2010;
- **Dokument i printuar nga sistemi i FSHU** që konfirmon se Mitat Tola për kontratën nr. DUOA***, për periudhën 1. 1.2022 - 31.12.2022 ka paguar rreth 7.896 leke;
- **Dokument nga UK Durrës**, datë 23.6.2015, që konfirmon se Mithat Tola ka lidhur Kontratën me nr. *** ;
- **Vërtetim dt. 26.1.2021, nga UK Vlorë**, që konfirmon se Mithat dhe Arjola Tola nuk janë klient;
- **Dokument nga kompania ***** , datë 20.5.2021, sipas të cilit qiraja mujore e tokës është 34 50 euro;
- **Dokument i kompanisë së menaxhimit të bllokut të pallateve "FPP ****"** , që konfirmon se pagesa mujore për ujë/ngrohje/administrim, është 185 euro;
- **Dokument nga Zyra e Financave /taksave e Hamburg**, datë 26.4.2022, që konfirmon se pagesa 3M, v. 2022, për taksën e banesës është 75 64 euro •
- **Dokument nga kompania VATENFALL**, datë 19.3.2023, që konfirmon shpenzimet e Nedia Tola për energjinë elektrike ne vitin 2022, në shumën 553 15 euro.
- **Faturë nga kompania "T COM"** datë 4.11.2022, për Nedia Tola që konfirmon pagesat mujore të internetit nga data 29.4.2022, në shumën 19.95 euro në muaj, ndërsa nga data 29.10.2022, në shumën 39.95 euro në muaj;
- **Dokument bankar nga Haspa Bank**, që konfirmon pagesat 3 mujore, në shumën 55 08 euro nga Llogaria e Nedia Tola për TV - Radio shtetërore;
- **Urdhër nr. *****, datë **26. 1. 2023**, nga DPPSH, që konfirmon se Drejtuesit të Kolegjit Profesional të Lartë në Akademinë e Sigurisë i ofrohet shërbimi celular;
- **Kontratë nr. *****, datë **29.5.2009**, për shërbimin ADSL me Albtelekom/One Albania. Aneks Kontrate për tarifë shërbimi ADSL dhe fatura pagesash, që i përkasin periudhës 2009 - 2010; Amendament m. 2356917, datë 23.8.2011, i kontratës për shërbimin ADSL mbi paketën "i-FIKS";
- **Faturë mujore telefoni nga kompania OTELO**, datë 30.11.2022, që konfirmon se Nedia Tola kryen pagesë mujore në shumën 19.99 euro. Bashkëlidhur dokumenti i përkthyer.

Konstatohet:

- ✓ *Shpenzimet për ujë, drita, telefon, internet, etj., gjatë periudhës së sipërcituar, për banesat në Shqipëri, rezultojnë në shumën 218.000 lekë, ndërsa për apartamentin në Gjermani në shumën 4.095 euro.*

Për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike), duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara - Periudha 01.01.2020 — 31.12.2022.

- Udhëtim në datat 03 — 05.03.2020, me autoveturë në Bullgari: Mithat Tola, Arjola Tola dhe Hera Tola. Shuma e shpenzuar 1.500 euro.
- Udhëtim në datat 13 - 14.12.2020, Tiranë - Sofie Bullgari. Udhëtim nga Mithat Tola me linjë transporti autobus. Shuma e shpenzuar 100 euro.
- Udhëtim në datat 24 — 27.09.2021. Udhëtim në Stamboll Turqi: Mithat Tola & Arjola Tola. Shuma e shpenzuar 1 .000 euro.
- Udhëtim zyrtar në Romë, në datat 20 — 23.07.2022. Delegacion i Policisë së Shtetit. Shpenzimet e përballuara nga DPPSH. Shuma e shpenzuar 0 euro.
- Delegacion zyrtar në Pragë - Çeki, në datat 11 — 15.10.2021. Shpenzimet e përballuara nga Policia Çeke (Drejtoria e Policisë Rrugore). Shuma e shpenzuar 0 euro.
- Udhëtim në datat 9 — 16.1.2021, në Hamburg — Gjermani nga Mithat Tola, Arjola Tola, Hera Tola. Shpenzime vetëm për bileta avioni. Qëndrimi tek motra e bashkëshortes, M.H . Shuma e shpenzuar 700 euro.
- Udhëtim në datë 22.12.2021, në Hamburg — Gjermani, në dt. 05.01.2022 kthimi nga Hamburgu, nga Mithat Tola, Arjola Tola, Hera Tola. Shpenzime vetëm për bileta avioni. Qëndrimi tek motra e bashkëshortes, M.H . Shuma e shpenzuar 800 euro.
- Udhëtim në Barcelonë, në datat I — 4.4.2022 nga Mithat Tola, Arjola Tola dhe Hera Tola. Shuma e shpenzuar 2.000 euro.
- Udhëtim për pushime në Antalia Turqi, për periudhën 12 — 19.07.2022, nga Mithat Tola, Arjola Tola dhe Hera Tola. Shuma e shpenzuar 3.660 euro.
- Udhëtim i Arjola Tola në Hamburg Gjermani, në datat 6 - 10.12.2022. Shpenzime vetëm për bileta avioni. Qëndrimi tek vajza Nedja Tola. Shuma e shpenzuar 360 euro.
- Udhëtim i Hera Tola në Hamburg Gjermani, në datat 26 - 29.11.2022. Shpenzime vetëm për bileta avioni. Qëndrimi tek vajza Nedja Tola. Shuma e shpenzuar 360 euro.
- Udhëtim i Nedja Tola, ardhur nga Hamburgu në Tiranë, në datë 20.12.2022. Në datë 10. 1 .2023, largimi për në Hamburg. Shuma e shpenzuar 180 euro.
- Udhëtim i Nedja Tola, ardhur në Tiranë nga Hamburgu (Gjermani), në datë 23.7.2022. Në datë 30.8.2022, largimi për në Hamburg. Shuma e shpenzuar 180 euro.
- Udhëtim i Nedja Tola, ardhur në Tiranë nga Hamburgu (Gjermani) dt. 7.8.2020. Në datë 2.10.2020, largimi për në Hamburg (nëpërmjet linjës Berlin). Shuma e shpenzuar 360 euro. Udhëtim i Nedja Tola, largimi për në Hamburgu dt. 2.1.2020. Shuma e shpenzuar 100 euro. Udhëtim i Nedja Tola, ardhur në Tiranë nga Hamburgu (Gjermani), në datë 5.8.2021. Në datë 15.9.2021, largimi nga Tirana për në Hamburg (Gjermani). Shpenzimi 200 euro.

Bashkëlidhur deklaratës:

Raporti i hyrje daljeve në territorin shqiptar për shtetasin Mithat F.T dhe personat e lidhur me të, për periudhën 1.1.2020 — 31.12.2022, që konfirmon si vijon.-.

Mithat Tola: Dalje në datë 1.3.2020 — kthyer në datë 5.3.2020, udhëtim me auoveturë, 'Dalje në datë 13.12.2020 — kthyer në datë 14.122020, udhëtim me autobus, ' Dalje në datë 9.1.2021 — kthyer në datë 16.1.2021, udhëtim me avion në Frankfurt, Gjermani, 'Dalje në datë

24.9.2021 — kthyer në datë 27.9.2021, udhëtim me avion në Stamboll, Turqi; Dalje në datë 11. 10.2021 — kthyer në datë 15.10.2021, udhëtim me avion në Vjenë, Austri; Dalje në datë 29.12.2021 — kthyer në datë 5.1.2022, udhëtim me avion në Hamburg, Gjermani; Dalje në datë 1.4.2022 — kthyer në datë 4.4.2022, udhëtim me avion në Barcelonë, Spanjë; Dalje në datë 12.7.2022 — kthyer në datë 19.7.2022, udhëtim me avion në Stamboll, Turqi; Dalje në datë 20.7.2022 — kthyer në datë 23.7.2022, udhëtim me avion në Romë, Itali; Dalje në datë 22.11.2022— kthyer, në datë 24. 11. 2022 udhëtim me avion në Hahn, Frankfurt.

Arjola Tola: Kthim në datë 5.3.2020, me auoveturë; Dalje në datë 9.1.2021 — kthyer në datë 16.1.2021, udhëtim me avion në Frankfurt Gjermani; Dalje në datë 24.9.2021 — kthyer në datë 27.9.2021, udhëtim me avion në Stamboll Turqi; Dalje në datë 22.12.2021 — kthyer në datë 5.1.2022, udhëtim me avion në Hamburg, Gjermani; Dalje në datë 1.4.2022 — kthyer në datë 4.4.2022, udhëtim me avion në Barcelonë, Spanjë, Dalje në datë 12.7.2022 — kthyer në datë 19.7.2022, udhëtim me avion në Stamboll, Turqi; Dalje në datë 6.12.2022— kthyer në datë 10.12.2022, udhëtim me avion në Hamburg, Gjermani.

Nedia Tola: Dalje në datë 2. 1. 2020, udhëtim me avion në Firenze, Itali; Hyrje në datë 7.8.2020, udhëtim me avion nga Hamburg, Gjermani; Dalje në datë 2.10.2020, udhëtim me avion në Berlin, Gjermani; Dalje në datë 8. 1. 2021 udhëtim me avion në Vjenë, Austri; Hyrje në datë 5.8.2021 udhëtim me avion nga Hamburg, Gjermani; Dalje në datë 15.9.2021 udhëtim me avion në Hamburg, Gjermani; Hyrja në datë 23.7.202, udhëtim me avion nga Mynih, Gjermani; Dalje në datë 30.8.2022 udhëtim me avion, Hyrje në datë 20.12.2022 udhëtim me avion.

Hera Tola: Kthim në datë 5.3.2020, me auoveturë; Dalje në datë 9.1.2021 — kthyer në datë 16.1.2021, udhëtim me avion në Frankfurt, Gjermani; Dalje në datë 22.12.2021 —kthyer në datë 5.1.2022 udhëtim me avion në Hamburg, Gjermani; Dalje në datë 1.4.2022 — kthyer në datë 4.4.2022, udhëtim me avion në Barcelonë, Spanjë; Dalje në datë 12.7.2022 — kthyer në datë 19.7.2022, udhëtim me avion në Stamboll, Turqi; Dalje në datë 26.11.2022— kthyer në datë 29.11.2022, udhëtim me avion në Hamburg, Gjermani.

Hetimi administrativ :

Raiffaisen bank me shkresën nr. ***prot., datë 7.8.2023 përcjell CD, që konfirmon se Arjola Tola, në datë 13.9.2021 ka kryer pagese me master card, të shumës l. 395 euro për Edreams, Barcelona, ndërsa në datë 1.3.2022 ka kryer pagesë me master card, të shumës 909 euro, për Club Futboll Barcelona.

Në proces verbalin e datës 20.3.2024 të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga trupa e vlerësimit subjekti sqaroi se; “... *Lidhur me udhëtimin në Sofie, Bullgari, nga data 3.3.2020 deri në 5.3.2020 kanë qëndruar në apartament me qira dhe kanë shpenzuar 433 euro. Kanë pasur edhe shpenzime të tjera për ushqim, vizita në qendra të ndryshme, si dhe shpenzime transporti vajtje — ardhje, Shqipëri - Bullgari dhe anasjelltas, për të cilat nuk kanë ruajtur fatura shpenzimesh. Në total këto shpenzime shkonin rreth 1.500 euro.*

Për udhëtimin në Stamboll, Turqi, nga data 24.9.2021 deri në 27.9.2021, pagesat ishin në shumën 1.362 euro + 465 euro. Për Mithat Tola dhe Arjola Tola, shpenzimet ishin rreth 914 euro, pasi biletat dhe hoteli përfshijnë pagesat për 2 persona të tjerë. Për udhëtimin në Hamburg, Gjermani, nga data 9.1.2021 - 16.1.2021, nga Mithat Tola, Arjola Tola, Hera Tola, shpenzimi ishte në shumën rreth 689, 76 euro.

Për udhëtimin në Barcelonë, nga data 1.4.2022 deri në 4.4.2022, shpenzimi ishte në shumën 1.261,9 euro plus 906 euro për pagesë bilete për ndeshjen e futbollit Barcelona — Servilja.

Pagesat për biletat e udhëtimit, hotelin dhe biletat e ndeshjes së futbollit, Barcelona - Servilja, përfshijnë përveç: Mithat Tola, Arjola Tola dhe Hera Tola edhe 3 persona të tjerë. Për subjektin, bashkëshorten dhe vajzën Hera Tola, shpenzimet në total për këtë udhëtim ishin në shumën rreth 1.084 euro.

Për pushimet në Antalia, Turqi, nga data 12.7.2022 deri në 19.7.2022, shpenzimet ishin në shumën rreth 3.660 euro.

Shpenzimi për biletat e udhëtimit të vajzës Nedja Tola, nga data 19.12.2022 deri në 10. 1. 2023 ishin në shumën 360,56 euro, por vlera e shpenzuar për biletën e udhëtimit për vajzën ishte 180 euro,.

Shpenzimet për biletën e udhëtimit të vajzës Nedja Tola, nga data 22.7,2022 deri në 30.8.2022 ishin 289 euro. Në deklaratën e pasurisë për vlerësimin kalimtar, vlera e shpenzuar për biletën e udhëtimit të vajzës Nedja Tola, në datat 22.7.2022 dhe 30.8.2022 është lapsus në deklaram.

Lidhur me shpenzimet e deklaruara për udhëtimin me linjë transporti, autobus, nga data 13.12.2020 deri në datë 14.12.2020, nga Tirana në Sofie, Bullgari, nuk disponon dokumentacion. Lidhur me një pjesë udhëtimesh drejt Hamburgut, Gjermani, që nuk disponon dokumentacion (biletat e udhëtimit), sqaroi se çmimet mesatare ishin rreth 290 euro/personi. Në deklaratën personale, datë 28. 11. 2023, të shtetasve P. F dhe M. H (motra e bashkëshortes dhe baxhanaku), në pikën nr. 5, citohet se: “Gjate udhëtimeve në Gjermani, Mithat, Arjola dhe Hera Tola, kanë qëndruar në shtëpinë e tyre në Hamburg dhe nuk kanë pasur kosto akomodimi apo ushqimi” Lidhur me konstatimet nga Raiffeisen Bank, sqaroi se pagesa 1.395 euro, di. 13.9.2021 nga Llogaria MC e Arjola Tola, i përket biletave të udhëtimit në Stamboll, Turqi, në datat 24 - 27.9.2021. Biletat janë prerë nëpërmjet platformës "Edreams Barcelona", në shumën 1.363 euro, pasi është mbajtur edhe një pagesë prej 33 euro. Shuma e mësipërme përfshin 4 bileta, 2 nga të cilat, u përkasin personave të tjerë, të cilët e kanë kthyer shumën e tyre në cash. Përsa i përket shumës 909 euro, për Club Futboll Barcelona, sqaroi se kjo pagesë përfshin biletat për ndeshjen e futbollit Barcelonë Servilja për 6 persona. Biletat janë prerë nga Llogaria master card e b/shortes edhe për 3 persona të tjerë; shuma 454.5 euro, paguar për Llogari të tyre është kthyer cash...”

Subjekti paraqiti.

- **Dokument i printuar për pretonim nga Airbnb**, për apartamentin ku kanë qëndruar në Sofie, Bullgari nga data 3.3.2020 deri në 5.3.2020 dhe për qira banese, shpenzuar rreth 433 euro.
- **Dokument i printuar** për rezervimin e biletave të udhëtimit dhe hotelit në Stamboll, Turqi nga data 24.9.2021 deri në 27.9.2021, që konfirmon pagesat e kryera në shumën 1.362 euro + 465 euro, nga të cilat për Mithat Tola dhe Arjola Tola, rreth 914 euro;
- **Dokument i printuar** për biletat e udhëtimit në Hamburg— Gjermani, nga data 9. 1. 2021 deri në 16.1.2021, nga Mithat Tola, Arjola Tola, Hera Tola, që konfirmon pagesat në shumën rreth 689, 76 euro;
- **Dokument i printuar** për udhëtimin në Barcelonë, nga data 1.4.2022 deri në 4.4.2022, që konfirmon pagesat në shumën 1.261,9 euro + 906 euro, për pagesë bilete për ndeshjen e futbollit Barcelona — Servile, nga të cilat për Mithat Tola, Arjola Tola, dhe Hera Tola, shpenzimet rreth 1. 084 euro;
- **Faturë pagese datë 21.6.2022**, nga Agjencia Turistike "****", për pushimet në Antalia, nga data 12.7.2022 - 19.7.2022, që konfirmojnë pagesën e shumës 3.660 euro;

- **Dokument i printuar** që konfirmon pagesën për biletë udhëtimi të Nedia Tola, dt.19.12.2022 — deri në 10. I. 2023, në shumën 180 euro;
- **Dokument i printuar** nga Austrian Airlines, që konfirmon pagesë për biletën e udhëtimit të vajzës Nedia Tola, datë 22.7.2022 — deri në 30.8.2022, në shumën totale 289 euro.

Konstatohet

- ✓ **Shpenzimet për udhëtimet private, personale dhe të personave të lidhur gjatë periudhës së sipërcituar janë deklaruar në shumën totale 11.500 euro. Subjekti ka dokumentuar hyrje - daliet nga RSH, gjatë periudhës 2020 — 2022.**

Për arsimin e fëmijëve, madhorë apo të mitur, apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore, si dhe kohëzgjatjen e studimeve, sipas Periudhës së përcaktuar në nenin 32, të Ligjit të vlerësimit - Periudha nga data e (fillimit të punës në institucionin e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrës Policore deri në ditën e plotësimit të formularit të' deklarimit të pasurisë:

Shpenzime për arsimin e vajzës Nedia Tola, gjatë shkollimit të lartë pranë Universitetit në ***— Gjermani, vitet 2017 — 2018 — 2019 - 2020, sipas depozitës së përbashkët bankare të krijuar në Bankën Intesa Sanpaolo në emër të vajzës dhe me mbikëqyrjen time. Shuma 8.624 euro x 3 vite: 25.872 euro.

Shpenzime për arsimin e vajzës Hera Tola, në shkollën jopublike "****" dhe "****", 2013-2021. Shuma 850.000 lekë.

Hetimi administrativ

Intesa Sanpaolo Bank me shkresë me nr. 41/4 prot., datë 11.8.2023, konfirmon se Mithat Tola ka qenë firmë e autorizuar në llogarinë e Nedia Tola.

Nedia Tola ka pasur 2 (dy) llogari rrjedhëse në euro, si vijon:

- Llogari rrjedhëse në euro, në të cilën në datë 09.08.2017, ka derdhur shumën 8.640 euro. Shuma 8.640 euro është transferuar periodikisht në periudhën 27.09.2017 - 27.08.2018, në llogarinë tjetër në euro (720 euro/muaj). Llogaria rezulton e mbyllur në datë 11.08.2020.
- Llogari rrjedhëse në euro e krijuar në datë 27.09.2017, në të cilën për periudhën 27.09.2017 - 27.08.2018 janë kredituar 8.640 euro (720 euro/muaj); Në datë 05.11.2018, në llogari është kredituar nga Arjola Tola shuma 8.650 euro, me përshkrimin: "marrje hua nga P.F , rikthim përsëri nëpërmjet bankës, do përdoren për vajzën në Gjermani"; Në datë 26.9.2019, Nedia Tola ka tërhequr nga llogaria shumën 9.000 euro me përshkrimin: "kthim nga depozitimi i kursimeve si studente në Gjermani "; Në datën 03.07.2020, në llogari është depozituar cash nga Mithat Tola, shuma 4.000 euro; Në datë 11.08.2020, Mithat Tola ka tërhequr nga llogaria shumën 122017 euro. Llogaria rezulton e mbyllur, në datë 11.08.2020.

Credins Bank me shkresë me nr. ***prot., datë 31.8.2023, konfirmon se Nedia Tola ka pasur llogari rrjedhëse në euro, e cila rezulton e mbyllur në vitin 2019. Në datat 11.07.2017 dhe

22.08.2017 ka kredituar në llogari shumat 185 euro dhe 390 euro. Në datat 11.07.2017 dhe 22.07.2017 ka transferuar për pagesë semestri universiteti dhe pagesë të ***Universitet Luneburg, respektivisht shumat 150 euro dhe 364 euro.

Në proces verbalin e datës 20.3.2024 të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga trupa e vlerësimit subjekti sqaroi se: “... *Nedia Tola ka vijuar studimet me kohë të plotë për periudhën shtator 2017 - dhjetor 2020, në Luneburg, Gjermani dhe është diplomuar në vitin 2022. Shuma e deklaruar si shpenzim prej 25.872 euro është shuma e llogaritur dhe kërkuar nga Ambasada Gjermane, si garanci për mbulimin e kostove të jetesës, së një studenti në Gjermani, gjatë viteve të studimit me kohë të plotë. Depozitimi i kësaj shume si garanci, ka qenë kusht nga Ambasada Gjermane, për pajisjen me vizë studimi. Vajza ka frekuentuar Universitetin *** në Luneburg,*

Gjermani dhe nuk ka paguar tarifa shkollimi, por shpenzime vetëm për kostot bazike të jetesës, si akomodim/qira dhe ushqim.

Për të evituar vonesat dhe kostot e transaksioneve bankare nga Shqipëria, shuma prej 25.872 euro i është dhënë vajzës nga familja e motrës së b/shortes, në Gjermani, (P. F dhe M.H), në formën e pagesës mujore gjatë periudhës së studimeve. Këto veprime janë kryer për shkak të marrëdhënieve familjare, si dhe për lehtësi meqenëse këta shtetas jetojnë në Gjermani. Shumat janë likuiduar herë pas here nëpërmjet Llogarisë së P. F, në Raiffeisen Bank dhe konkretisht: nga Arjola Tola i janë transferuar 7.000 euro, nga llogaria në Raiffeisen Bank, në datë 23.11.2018, ndërsa nga Nedia Tola, i janë transferuar 9.002 euro me mandat arkëtimi, datë 26.9.2019 dhe pjesa tjetër i është shlyer, duke kryer pagesa për nevoja e llogari të tij në Shqipëri, gjatë të njëjtës periudhë.

*Gjatë vitit të parë të studimeve, vajza Nedia Tola ka qëndruar në kampusin e universitetit dhe shpenzimet e qirasë për vitin e parë të studimeve ishin 480 euro/muaj, përfshirë çdo kosto tjetër, si ngrohje/energji/ujë. Për periudhën shtator 2017 — shtator 2018, shpenzimet për qira banese/ngrohje/energji/ujë ishin rreth 5.760 euro, ndërsa për, ushqim vajza ka shpenzuar rreth 2.864 euro, në total rreth 8.624 euro. Në vitet e tjera ka jetuar në apartament me qira, së bashku me një student tjetër, ku pjesa e saj e pagesës ishte 380 euro/muaj, përfshirë shpenzimet për ngrohje/energji/ujë. Në total për periudhën shtator 2018 — dhjetor 2020, shpenzimet për qira banese/ngrohje/ energji/ujë të vajzës Nedia Tola, në Gjermani ishin rreth 10.644 euro, ndërsa për ushqim, vajza ka shpenzuar 6.683 euro. Burimi financiar për këto shpenzime janë të ardhurat nga paga apo aktiviteti i bashkëshortes, gjatë periudhës mars 2015 — dhjetor 2020; Të ardhura nga pagat tek projekti TAP "****" për periudhën 2015 - prill 2017. Për shkak të pandemisë, gjatë periudhës së përgatitjes së diplomës, Nedia Tola, në vitin 2021 ka lëvizur nga Luneburgu në Hamburg Gjermani, ku ka jetuar në familjen e motrës së bashkëshortes deri në maj 2022, pa shpenzime qiraje. Në deklaratën personale, datë 28.11.2023, të shtetasve P. F dhe M.H , në pikën nr.3, citohet se: “Gjatë periudhës së përgatitjes së diplomës, nga viti 2021 deri në maj 2022, Nedia Tola ka b/jetuar me ta dhe nuk ka pasur pagesa qiraje apo shpenzime të tjera”.*

*Nga viti 2021, i ka mbuluar shpenzimet e saj me të ardhurat e krijuara nga punë të ndryshme part-time dhe punësimi pranë kompanive "****" dhe "****". Nga muaji maj 2022 e në vijim, Nedia Tola jeton në apartamentin e blerë nga Arjola Tola në Hamburg, Gjermani (shpenzimet për energji, telefon e internet janë sqaruar si më sipër). Shpenzimet e deklaruara përfshijnë administrim/taksa/ujë/ngrohje, sipas dokumentacionit b/lidhur për ap. në Hamburg.*

*Vajza, Hera Tola, për periudhën 2013 — 2021 ka ndjekur studimet në shkollat jopublike "****" dhe "****". Për studimet në shkollën jopublike "****" pagesa vjetore ishte në shumën 72.000*

*lekë dhe janë paguar në llogarinë e Shoqërisë "****" në Intesa SanPaolo Bank Për studimet në shkollën jopublike "****" nga viti mësimor 2018 — 2019, deri në vitin mësimor 2020 — 2021, përkatësisht nga klasa VI deri në IX pagesat totale ishin 430.000 lekë. Në total shpenzimet për shkollimin e saj, janë rreth 850.000 lekë.*

Lidhur me transaksionet e kryera në Intesa SanPaolo Bank, sqaroi se Llogaria e parë rrjedhëse në euro, ku është depozituar shuma prej 8.640 euro është një llogari/depozitë e krijuar sipas kërkesës së Ambasadës Gjermane, për marrjen e vizës dhe rinovimin e vizës së studentit Nedia Tola, me kusht që kjo shumë do të përdorej për mbulimin e kostove të jetesës në Gjermani, për vitin e parë të periudhës së studimit, ndërsa llogaria tjetër rrjedhëse, ku janë transferuar shumat mujore prej 720 euro, janë shuma mujore për të përballuar kostot e jetesës. Burimi i krijimit të llogarisë janë të ardhurat nga punësimi dhe aktiviteti privat i bashkëshortes Arjola Tola. Shuma 8.650 euro e derdhur në Llogari në datë 5.11.2018, nga Arjola Tola është për arsye se llogaria bankare kërkohej nga zyra për dhënien e lejeve të qëndrimit të huajve në Gjermani, për rinovim Vize studentore për Nedia Tola. 190 shumë është marrë dorazi nga P. F dhe i është kthyer nga Arjola Tola nëpërmjet sistemit bankar në llogarinë e tij në Raiffeisen Bank, më datë 23. 11. 2018. Për shkak të marrëdhënieve të ngushta familjarë me familjen e motrës, nuk kanë bërë dokument formal për këtë huamarrje. Vërtetuar edhe nga transfertat bankare dhe deklarata e lëshuar nga P.F , huaja është marrë dhe shlyer në periudhën nëntor - dhjetor 2018, ndërkohë që deklarata vjetore e interesave private është plotësuar në muajin mars 2019, kohë në të cilën ky detyrim ishte i shlyer.

Pra, llogaritë e hapura në Intesa SanPaolo Bank, kanë shërbyer për marrjen dhe rinovimin e vizës së studentit Nedia Tola, gjatë kohës së studimeve në Gjermani. Shumën 9.002 euro tërhequr në Intesa Sanpaolo Bank, Nedia Tola e ka derdhur në llogarinë e P. F pranë Raiffeisen Bank, po në datën 26.9.2019, për të shlyer pagesat që ky i fundit kishte kryer në Gjermani, për të mbuluar kostot e jetesës së saj, me qëllim shmangien e vonesave dhe kostot e transfertave bankare Shqipëri - Gjermani. Kreditimi i shumës 4.000 euro në llogari është bërë për efekt të rinovimit të lejes së qëndrimit të Nedia Tola në Gjermani dhe burimi i krijimit ishte nga arka e Shoq. "AOL Studio " Shpk, me ortake të vetme Arjola Tola. 190 shumë është kthyer më vonë me tërheqjen e shumës 12.217 euro, datë. 11.8.2020, me qëllim mbylljen e llogarisë..."

Subjekti paraqiti:

- **Dokument faqja, e informacioneve DAAD** (Deutche Akademischer Austausch Dienst) në Shqipëri, printuar në dt. 25.11.2023, ku përcaktohet se 8.640 euro/vit janë të pamjaftueshme për një jetë modeste të një studenti në Gjermani, shumë e Cila kërkohet si garanci nga Ambasada Gjermane;
- **Dokument nga Universiteti "**** " ***Gjermani**, datë 28.4.2022, që konfirmon se Nedia Tola është regjistruar për të vazhduar studimet datë 28.8.2017 dhe datë diplomimi 30.9.2022;
- **Dokument nga Universiteti "**** " ***Gjermani**, datë printimi 27.11.2023, që konfirmon se kostot e jetesës në ***Gjermani, për qira, ushqim, libra, siguracion pagesë studenti etj., janë në shumën mujore 850 euro,.
- **Dokument bankar depozitim për të tretë, datë 26.9.2019**, nga Raiffeisen Bank, që konfirmon transfertën e vlerës 9.002 euro nga Nedia Tola për P.F , me përshkrimin: kthim i pagesës mujore në llogaritë bankare në Gjermani;

- **Deklaratë personale**, datë 28.11.2023, e shtetasve P. F dhe M.H , ku deklarojnë si vijon, Pika nr. 1: "Pagesat e kryera në shumën 25.872 euro, në favor të Nedia Tola, gjatë periudhës së studimeve me kohë të plotë në Luneburg, Gjermani. Gjatë kësaj periudhe i kemi kaluar Nedia Tola, në llogari bankare ose para në dorë, në mënyrë periodike/mujore, shumën e mësipërme për qira dhe ushqim dhe shpenzime të tjera gjatë studimeve, shumë e cila është kthyer nga Nedia Tola dhe Arjola Tola nëpërmjet llogarisë bankare të P.F , në Raiffeisen Bank Tiranë dhe pjesa tjetër me para në dorë dhe nëpërmjet shumave të dhëna familjarëve tanë apo për llogarinë tonë në Shqipëri Pika nr.2: "Lidhur me huadhënien e shumës 8.000 euro, dt. 5.11.2018, për Arjola Tola, deklarojmë se këtë shumë, unë P.F , i 'a kam dhënë para në dorë kumatës sime për arsye të depozitimit në llogarinë depozitë të studimit të Nedia Tola. Kjo shumë na është kthyer; 7.000 euro nëpërmjet llogarisë në Raiffeisen Bank të P. F më datë 23. 11. 2018 dhe pjesa tjetër prej 1.650 euro është kthyer në dorë, në dhjetor 2018 ", për të konfirmuar huamarrjen dhe shlyerjen e kësaj shume me transfertë bankare, të shlyer nga Arjola Tola për P. F, nëpërmjet llogarive respektive në Raiffeisen Bank; Pila nr.4: "Deklarojmë se herë pas here, Mithat Tola dhe Arjola Tola kanë kryer shpenzime apo pagesa për llogarinë tonë, tek persona të afërm apo miq të mi, pagesa të cilat i kemi kthyer apo jemi likuiduar, nëpërmjet sistemit bankar apo para në dorë, në periudha afat shkurtra”;
- **Kontratë qiraje datë 5.9.2017**, ndërmjet Kampusit ***dhe Nedia Tola, që konfirmon se pagesa mujore e qirasë që përfshin edhe normën fikse për shpenzimet e ngrohjes është në shumën 480 euro;
- **Kontratë qiraje, datë 3.8.2018**, ndërmjet Porth Grundbesitz GmbH dhe Nedia Tola; garantore M.H , që konfirmon se pagesa mujore e qirasë për apartamentin me adresë ***, është 760 euro; Konfirmim datë 20.9.2018, sipas të cilit shtetasi I. ***, banon në adresën ***.
- **Kontratë datë 4.2.2007, nga Shkolla 9-vjeçare jopublike "****"** për pranimin e nxënësës Hera Tola, për vitin shkollor 2014 — 2015, me pagesë vjetore 72.000 lekë e cila paguhet në llogarinë e Shoqërisë "****" ISP Bank;
- **Vërtetim datë 24. 11. 2023**, nga Institucioni Arsimor Jopublik "****" që vërteton se Hera Mithat Tola, ka qenë nxënëse pranë shkollës jopublike "****" nga viti mësimor 2018 — 2019, deri në vitin mësimor 2020 — 2021;
- **Dokument nga Raiffeisen Bank datë 26.9.2019**, që konfirmon depozitimin e shumës 9.002 euro nga Nedia Tola për P.F .

Konstatohet:

- ✓ **Nedia Tola, ka ndjekur studimet e larta në Universitetin Publik në Luneburg, Gjermani, për periudhën shtator 2017 - dhjetor 2020 dhe shuma e deklaruar prej 25.872 euro, përfaqëson shpenzimet e jetesës gjatë kësaj periudhe; për periudhën 2021 - maji 2022, ka jetuar në Hamburg me familjen e motrës së Arjola Tola (pa shpenzime) dhe prej muajit maji 2022, jeton në apartamentin e blerë nga kjo fundit; shpenzimet për ushqim, për periudhën maji 2022 — mars 2023, llogariten rreth 2.400 euro, ndërsa shpenzimet e tjera janë pasqyruar më sipër.**
- ✓ **Shpenzimet për arsimin e vajzës Hera Tola, për periudhën 2013 — 2021, në vlerën 850.000 lekë. Subjekti ka paraqitur dokumentacion justifikues lidhur me shpenzimet e deklaruar dhe transaksionet konfirmuara nga Intesa Sanpaolo Bank.**

Përveç sa më sipër;

Në proces verbalin e datës 20.3.2024 të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga trupa e vlerësimit subjekti sqaroi se: “...në datë 4.12.2017 ka kryer një ndërhyrje kirurgjikale pranë ***dhe pagesa totale e shërbimit ishte 202.098 lekë. Këto shpenzime janë mbuluar nga ***, pasi ishte i siguruar pranë kësaj kompanie.

Arjola Tola, në datë 2.5.2019 ka kryer një ndërhyrje kirurgjikale pranë ***Tiranë. Pagesa totale e shërbimit ishte 128.100 lekë. Këto shpenzime i ka mbuluar me të ardhurat e saj...”

Subjekti paraqiti:

- **Vërtetim nr. *** prot., datë 8.10.2019**, nga ***, sipas të cilit, në datë 7.2.2018 është paguar për llogari të Spitalit *** Tiranë, vlera 202.098 lekë/1.800 euro, për trajtimin mjekësor të M. Tola për kryerjen e një operacioni;
- **2 (dy)fatura nga Spitali *****, datë 2.5.2019, që konfirmojnë shpenzime nga Arjola Tola, në shumat 122.500 lekë dhe 5.600 lekë.

Konstatohet:

- ✓ **Rezultojnë shpenzime mjekësore në shumën totale rreth 128.000 lekë, v. 2019.**

TË DHËNA KONFIDENCIALE

- Bashkëpronar me b/shorten i një ap. me sip.57.7 m2, Rr. "****", Vlorë. Nr. Pasurie: ***. Indeksi i hartës: ***. Zona kadastrale: ***.
- Bashkëpronar me prindërit dhe vëllain, i një shtëpie banimi ndërtuar në vitet 1992 — 1995, me Sip. trualli 332.9 m2 dhe Sip. ndërtese 136 m2, Rr. "Imzot Mark Sopi" Tiranë. Ndërtim i vërtetuar me Vendim Fakti nr.***, Viti 1995, nga Gjykata Tiranë. Shtëpia është legalizuar në qershor 2013. Vlera e shtëpisë sipas dokumentacionit të legalizimit është llogaritur 12.368.580 lekë.
- Llogari page nr. *** në BKT. Vlera e overdraft-it: 41.000 lekë.
- Llogari rrjedhëse nr. ***, në Alpha Bank.
- Llogari page nr. ***, në Raiffeisen Bank.
- Llogari rrjedhëse nr.***, në BKT.
- Llogari kursimi nr. ***, në ABI Bank.

Këto të trajtuar më sipër.

DEKLARIM I BASHKËSHORTESSË SUBJEKTIT ARJOLA TOLA **DEKLARIMI I PASURIVE**

Pasuria nr.1

Bashkëpronare me b/shortin e një ap. me sip. 57.7 m2, Rr. "Llambro Rexha", Vlorë, përfituar nga këmbimi i ap. me sip. 60 m2, Durrës, blerë në vitin 2007. Vlera 2.000.000 lekë. Zotëron 50%.

Burimi i krijimit: kursimet familjare në vite, nga punësimi dhe konsulencat/licencat, si dhe hua nga motra ime (aktualisht e shlyer). Vlera e ap. në momentin e këmbimit sipas çmimeve minimale fiskale të zonës është vlerësuar 5.000.400 lekë, vlerë mbi të cilën është paguar tatimi për diferencën, sipas legjislacionit në fuqi. Apartamenti nuk është marrë ende në disponim e

përdorim, për shkak të një konflikti gjyqësor në proces, midis pronarëve të truallit, ku është ndërtuar objekti.

Trajtuar më sipër.

Pasuria nr.2

Apartament banimi me sip. 52 m², ***, , Hamburg, Gjermani, kontratë shitblerje 19.11.2020. Vlera 180.000 euro. Zotëron 100 %.

Burimi i krijimit: të ardhura nga pagat dhe fitimet, nga aktiviteti privat "AOL Studio", si dhe hua në shumën 108.000 euro, e marrë nga motra ime dhe b/shorti i saj. Kalimi i huasë është bërë nga llogaria e tyre bankare në llogarinë time bankare Hamburg, Gjermani. Shuma prej 66.000 euro nga huaja e marrë, është shlyer nëpërmjet Llogarisë bankare me të ardhurat e krijuara nga shitja e një apartamenti 3+1 në Yzberisht, Tiranë.

Bashkëlidhur deklaratës.

Prokurë e posaçme nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 10.11.2020, ku Arjola Tola, emëron përfaqësuese të posaçme motrën, M. H, me banim në Gjermani, ta përfaqësojë dhe nënshkruajë në emrin e saj, pranë çdo personi privat apo institucioni në Republikën Gjermane, me qëllim blerjen e një apartamenti në Gjermani, të kryejë administrimin e këtij apartamenti, të lidhë kontrata qiraje me palë të treta, si dhe të kryejë çdo pagesë në lidhje me këtë apartament, takse apo tarifa të tjera.

B/lidhur praktika, si dhe dokument në gjuhën gjermane, nr. 243/2020.

Hetmi administrativ

Raiffeisen Bank me shkresë me nr. ***prot., datë 7.8.2023, përcjell CD që konfirmon se Arjola Tola, më datë 12.11.2020, ka tërhequr shumën 20.000 euro, për kalim në banka të tjera;

BKT me shkresë me nr.***prot., datë 14.8.2023 konfirmon transaksionet si vijon:

Dt. 12.11.2020, derdhur shuma 45.000 euro;

Dt.8.1.2021, transferuar nga "AOL Studio " Shpk, shuma 35.000 euro, me përshkrimin: kalim në llogari të aksionerit;

Dt. 12.1.2021, transferuar me jashtë shuma 80.000 euro, për blerje shtëpie.

OTP Bank me shkresë nr. *** prot., dt. 4.8.2023, konfirmon transferimin dt.

1.10.2021, të shumës 75.995 euro, me përshkrimin "transfertë në nisje në favor të A. Tola,,

Në proces verbalin e datë 20.3.2024 të nga mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga trupa e vlerësimit subjekti sqaroi se; *"..pagesat për blerjen e apartamentit janë kryer nga Arjola Tola, nëpërmjet llogarisë së saj bankare në "HASPA" Bank Hamburg dhe konkretisht; në datat 18.1.2021 dhe 28.1.2021 janë transferuar respektivisht shumat 80.000 euro dhe 100.000 euro për ***. Shuma 108.000 euro nga M. H është transferuar në llogarinë e Arjola Tola në HASPA Bank Hamburg, si vijon: dt. 13.1.2021, shuma 3.000 euro; dt. 27.1.2021, shuma 50.000 euro; dt. 28.1.2021, shuma 50.000 euro; dt. 15.3.2021, shuma 5.000 euro. Shumat 3.000 euro + 5.000 euro janë pjesë e huamarrjes ndaj M. H, por janë përdorur për pagesën taksave të mbartura që kishte apartamenti, për shkak të detyrimeve të krijuara nga A.S, e cila ishte qiramarrëse, prej vitit 1996. Burimi financiar i huasë në shumën 108.000 euro është kredia e marrë nga M. H dhe P.F , në shumën 100.000 euro, pranë HASPA Hamburger Sparkase, për*

të cilën kanë lënë si kolateral pronën e tyre në ***, Hamburg, si dhe diferenca të ardhurat nga puna e tyre në Gjermani.

Shuma 45.000 euro e kredituar nga b/shortja, në datë 12.11.2020, ka si burim tërheqjet nga llogaritë e saj në Raiffesisen Bank, me burim të ardhurat nga pagat nga projekti TAP (shuma 20.000 euro) dhe të ardhurat/fitimet e aktivitetit privat (shuma 25.000 euro). Shuma 20.000 euro është tërhequr nga RFZ Bank, me përshkrimin "kalim në banka të tjera ", pasi transferimi nëpërmjet bankave kishte kosto dhe vonesa.

Shuma 35.000 euro e transferuar në datë 8.1.2021, nga Shoqëria "AOL Studio " Shpk është nga shpërndarja e fitimit të shoqërisë "AOL Studio " Shpk, në vite, shuma për të cilat është paguar tatimi përkatës, sipas legjislacionit tatimor.

Shuma 80.000 euro është transferuar në datë 18. 1. 2021, nga llogaria në BKT të llogaria në HASPA Bank, Hamburg e Arjola Tola, me qëllim blerjen e apartamentit

Pas transferimit të shumës 75.775 euro nga OTP Bank në HASPA Bank, kanë shlyer një pjesë të huamarrjes prej 66.000 euro dhe detyrimi i mbetur pashlyer deri më datë 8.3.2023 është 42.000 euro. Duke qenë se interesat e kredisë janë pothuaj të papërfillshme, detyrimi është deklaruar sa është marrë huaja në total. Këstet e kredisë i shlyhen motra e b/shortes, ndërkohë që kjo e fundit shlyhen huanë sipas mundësive financiare. Apartamenti është blerë i arreaduar dhe nuk kanë pasur shpenzime mobilimi..."

Subjekti paraqiti:

- **Dokument nr. ***, 19.11.2020**, përballë noterit R.G, me seli në Norderstedt, ndërmjet Ch.M.S dhe M. H (e cila vepron për Arjola Tola, në bazë të prokurës);
- **Kontratë datë 30.11.2020**, për blerje ap. banimi me çmim 180.000 euro, që do të paguhet më dt.29.1.2021, me kusht që blerësi të ketë marrë letrën e regjistruar nga noteri. Palë shitëse Ch.M.S dhe palë blerëse Arjola Tola. Çmimi i blerjes do të paguhet vetëm me transfertë bankare në llogarinë e Ch.M.S . Prona e blerë aktualisht i është dhënë me qira A.S dhe marrëveshja e qirasë është përfundimtare. Blerësi është në dijeni të përmbajtjes së plotë të marrëveshjes së qirasë të datës 1.12.1996;
- **Prokurë e posaçme me nr. *** rep. , dhe nr. *** kol.**, datë 10.11.2020, me anë të së cilës Arjola Tola, emëron përfaqësuese të posaçme motrën, M. H me qëllim blerjen në emrin e saj, të një apartamenti në Gjermani, plus dokumente në gjuhën gjermane.
- **Nxjerrje llogarie nga HASPA Bank Hamburg**, datë 1.3.2023, që konfirmon se në llogarinë e Arjola Tola janë transferuar nga M.H , shuma totale 108.000 euro, në datat 13.1.2021, 27.1.2021, 28.1.2021 dhe 15.03.2021, si dhe transferimi i shumave 80.000 euro dhe 100.000 euro në dt. 18.1.2021 dhe 28.1.2021, për shtetasen ***;
- **Dokument bankar nga HASPA Hamburger Sparkase**, datë 28.12.2020, që konfirmon se M. H dhe P.F , kanë marrë kredi në shumën 100.000 euro, me interes 1.020% në vit;
- **Deklarata të tatimit vjetor** në emër të M. H dhe P.F , sipas të cilave, të ardhurat totale për vitin 2018 janë në shumën 137.527 euro; v. 2019, në shumën 150.351 euro dhe v. 2020 në shumën 136.586 euro.
- **Deklaratë personale** datë 28.11.2023, e shtetasve P. F dhe M.H , ku në pikën nr. 6, citohet se: "Kemi ndihmuar me një hua prej 108.000 euro, për blerjen e një apartamenti në Hamburg, Gjermani, hua e cila është transferuar në Llogarinë e Arjola Tola, nëpërmjet sistemit bankar, nga e Cila është shlyer aktualisht shuma prej 66.000 euro dhe ka mbetur pa shlyer vlera prej 42.000 euro, me afat të papërcaktuar."

- **Nxjerrje Llogarie nga HASPA Bank Hamburg**, datë 28.2.2023, në emrin e Arjola Tola që konfirmon se në datë 5.10.2021 është transferuar shuma 75.755 euro dhe në datë 21.10.2021, Arjola Tola ka transferuar për P.F , shumën 66.000 euro;
- **Mandat bunker**, datë 3.11.2020, nga Raiffeisen Bank, që konfirmon se Arjola Tola ka tërhequr nga llogaria nr. *** (AOL Studio), shumën 3.000 euro;
- **Mandat bunker**, datë 3.11.2020, nga Raiffeisen Bank, që konfirmon se Arjola Tola ka tërhequr nga llogaria me nr. 0001115017, shumën 3.000 euro.
- **Mandat bankar** datë 12.11.2020, nga Raiffeisen Bank, që konfirmon se Arjola Tola ka tërhequr nga llogaria me nr. 0001115017, shumën 20.000 euro;
- **Mandat bunker**, datë 12.11.2020, nga Raiffeisen Bank, që konfirmon se Arjola Tola ka tërhequr nga llogaria, me nr. *** (AOL Studio), shumën 25.000 euro;
- **Vendim, dt.1.6.2019**, i ortakut të vetëm të shoqërisë "AOL Studio " shpk, me NIPT ***i Cili ka vendosur: Miratimin e pasqyrave financiare të v. 2018; Fitimi i vitit ushtrimor 2018, në shumën 3.332.332 lekë do të destinohet: Shuma 3.000.000 lekë për shpërndarje dividendi dhe shuma 332.332 lekë, për shtim të rezervës ligjore;
- **Vendim, datë 30.6.2020**, i ortakut të vetëm të shoqërisë "AOL Studio " shpk., me NIPT *** i cili ka vendosur: Miratimin e pasqyrave financiare të vitit 2019; Fitimi i vitit ushtrimor 2019, rezulton në shumën 6.051.880 lekë dhe do të destinohet si vijon: Shuma 4.000.000 lekë për shpërndarje dividendi dhe shuma 2.051.880 lekë për shtim të rezervës ligjore dhe përfitime të pashpërndara;

Konstatohet:

- ✓ *Apartamenti me sip. 52 m2, Hamburg, Gjermani, në pronësi të b/shortes, është përfituar në v. 2021, me kontratë blerje në vlerën 180.000 euro, me burim 108.000 euro huamarrje nga motra e saj dhe 80.000 euro të ardhura nga pagat dhe aktiviteti privat. Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka dokumentuar burimin e krijimit të huasë në shumën 108.000 euro, nga të cilat 100.000 euro janë marrë kredi dhe diferenca nga ardhurat nga puna në Gjermani. Huaja është shlyer në shumën 66.000 euro, me burim shitjen e apartamentit në Yzberisht, Tiranë, në vlerën në vlerën 76.000 euro. Subjekti ka dokumentuar gjithashtu, lidhur me burimin e shumës 80.000 euro, nga të ardhurat nga pagat dhe aktiviteti privat. QKB dhe organet tatimore konfirmojnë aktivitetin privat, të ardhurat neto pas tatimit, si dhe shpërndarje dividendi në v. 2020.*
- ✓ *Transaksionet e marrjes së huasë, blerjes dhe shlyerjes së saj janë kryer nëpërmjet sistemit bankar në Shqipëri dhe Gjermani.*
- ✓ *Subjekti ka dhënë shpjegime se nuk ka pasur shpenzime për mobilim banese, pasi apartamenti është blerë i mobiluar.*
- ✓ *Deklarimi bazohet në dokumentacionin e dorëzuar dhe shpjegimet e dhëna. Apartamenti me sip. 52 na2, ndodhet në Hamburg, Gjermani.*
- ✓ *Dokumentacioni i burimit të krijimit të shumës 80.000 euro, nga të ardhurat nga pagat dhe fitimet nga aktiviteti privat "AOL Studio", trajtohet në vijim, në rubrikën e të ardhurave të b/shortes, ndërsa i shimë 66.000 euro, nga shitja e apartamentit në Yzberisht, Tiranë, shumë e cila është përdorur për shlyerjen pjesërisht të huasë, është trotuar më sipër, në rubrikën e deklaramit të pasurive të subjektit.*

Pasuria nr.2

Automjet Mercedes Benz E 200 CDI, viti i prodhimit 2012. Kontrata e shitblerjes dt. 9.2.2017.

Burimi i krijimit: të ardhurat nga pagat dhe biznesi. Vlera 13.000 euro. Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

Certifikatë pronësisë datë 10.2.2017, për mjetin me targa AA ***P V, marka Mercedes Benz, regjistruar në datë 9.2.2014, në pronësi të Arjola Tola.

Hetimi administrativ

DPSHTRR, me shkresë nr.*** 7, datë 10.8.2023, konfirmon se:

Arjola Tola ka të regjistruar automjetin me targa AA ***P V, tip Mercedes Benz, modeli E 200CD1, blerë me kontratë shitje automjeti me nr. 514 rep., dhe nr. 188 kol. datë 9.2.2017, në vlerën 9.000 euro, me palë shitëse Mithat Tola.

Mithat Tola, me kontratë blerje datë 9.1.2017 (në gjuhën gjermane), ka blerë në Gjermani automjetin tip Mercedes Benz, në vlerën 6.300 euro, me palë shitëse ***. B/lidhur dokumenti i zhdoganimit, në shumën 460.359 leke.

Raiffeisen Bank me shkresë me nr. ***prot., datë 7.8.2023, konfirmon se Arjola Tola ka llogari rrjedhëse në euro dhe në datë me 7.2.2017 ka tërhequr shumën 8.000 euro me përshkrimin "për blerje makine".

Në proces verbalin e datës 20.3.2024 të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga trupa e vlerësimit në datë 20.3.2024, subjekti sqaroi se vlera e deklaruar nga b/shortja është vlera e tregut. Vlera e blerjes së mjetit nga subjekti, në janar 2017, ishte 6.300 euro, Plus ç doganimi në vlerën 463.500 lekë, është vlerë e përafërt me vlerën 9.000 euro, që konfirmohet nga kontrata e shitjes me b/shorten.

Konstatohet

- ✓ *Automjeti tip Mercedes Benz, me targa AA ***P V, në pronësi të b/shortes Arjola Tola është blerë në v. 2017, nga subjekti, në vlerën 6.300 euro, për të cilin janë paguar shpenzime zhdoganimi prej 463.500. Mjeti i është shitur b/shortes në vlerën 9.000 euro. Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me vlerën e deklaruar të mjetit.*
- ✓ *Automjeti Mercedes Benz, me targa AA 785PV, konfirmohet sipas kontratës dt. 9.2.2017, DPSHTRR, në vlerën 9.000 euro.*

Pasuria nr.3

Aksione në AOL Studio Shpk me NIPT ***. Data e regjistrimit: 6.4.2011. Adresa Rruga: "Imzot Mark Sopi", Tiranë. Burimi: Vlera fillestare në 2011, prej 10.000 leke, nga të ardhurat nga paga. Rritja në 50.000 nga të ardhurat nga fitimi i kompanisë. Vlera 50.000 lekë. Zotëron 100%.

Hetimi administrativ

QKB, me shkresë me nr. ***prot., datë 7.8.2023, konfirmon se Arjola Tola figuron e regjistruar si administratore dhe ortakë e vetme me 100% të kapitalit në shoqërinë "AOL Studio" Shpk, me NUTS (NIPT) ***. Regjistruar datë 5.4.2011. Vlera e kapitalit: 50.000. Statusi: Aktiv. Objekti i veprimtarisë: "Realizim i mbrojtjes ligjore, avokatisë për çështje të ndryshme, realizimi i asistencës ligjore dhe ekspertizës teknike për fitimin, mbrojtjen, regjistrimin dhe zhvillimin e pasurive të paluajtshme, kryerja e shërbimeve të konsulencës për

projektive, mbikëqyrje, kolaudime dhe ndërtime për Objekte të ndryshme ndërtimore, infrastrukturës, teknologjisë së ndërtimit. Realizimi i anës ndërtimore të objekteve të ndryshme civile dhe të infrastrukturës. Aktive në menaxhimin e projekteve të ndryshme. Konsulencë tekniko-ekonomike në fushën e transportit rrugor. Ekspertizë në Llogaritjen e dëmeve materiale që shkakton një mjet motorik në rrugë”.

DRT Tiranë, me shkresën nr.***prot., datë 17.8.2023, konfirmon se Arjola Tola rezulton e regjistruar si aksioner individ i kompanisë AOL Studio Shpk, me NIPT ***, regjistruar në sistemin tatimor, në datë 6.4.2011, me "Aktivitete juridikë.”

Konstatohet

✓ ***Konfirmohet deklarimi me përgjigjet e QKB dhe DRT Tiranë.***

Pasuria nr.4

Llogari personale në euro, Raiffeisen Bank. Vlera 21.976 euro. Zotëron 100 %/0. Burimi i krijimit: Të ardhura nga pagat si konsulente dhe menaxhere e sigurimit të tokës, Projekti Trans Adriatic Pipeline (TAP).

Hetimi administrativ

Raiffeisen Bank me shkresë me nr. ***prot., datë 7.8.2023, përcjell CD që konfirmon se Arjola Tola ka llogari rrjedhëse në euro, me gjendje, në datë 8.3.2023, në shumën 21.976 euro. Në llogari janë kryer transaksione, si vijon:

- Në datë 08.09.2015 derdhur në llogari shumën 7.500 euro, me përshkrimin kthim borxhi;
- Në datë 05.11.2015, tërhequr nga llogaria, shuma 5.000 euro;
- Në datë 26.05.2017, shtetasi P.F ka kredituar shumën 4.500 euro, me përshkrimin: "Kthim huaje”.
- Në datë 04.09.2018, AOL Studio ka kredituar shumën 5.000 euro, për shpenzime, për llogari të AOL Shpk;
- Në datë 23.11.2018, transferuar nga llogaria shuma 7.000 euro, për shtetasin P.F, me përshkrimin: kthim borxhi,
- Në datë 23.11.2018, derdhur shuma 3.500 euro;
- Në datë 03.08.2020, tërhequr shuma 3.000 euro;
- Në datë 22.09.2020, tërhequr shuma 3.000 euro;
- Në datë 03.11.2020, tërhequr shuma 3.000 euro;
- Në datë 29.12.2020, AOL Studio ka kredituar shumën 5.000 euro, për shpenzime për llogari të AOL Shpk;
- Në datë 03.03.2021, tërhequr shuma 4.000 euro;
- Në datë 04.05.2022, tërhequr shuma 4.000 euro;
- Në datë 20.06.2022, tërhequr shumën 4.000 euro;

Në proces verbalin e datës 20.3.2024 të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga trupa e vlerësimit, lidhur me depozitimin e shumës 7.500 euro, dt. 08.09.2015, me përshkrimin "Kthim huaje subjekti sqaroi se; “... duke konstatuar debitimet në periudhat para kësaj date, nga llogaritë e Shoq "AOL Studio " apo llogaritë personale, ka si burim tërheqje të kryera për

ndonjë shpenzim që nuk është kryer dhe është depozituar në bankë për të mos e mbajtur në gjendje cash. Përshkrimi, si kthim huaje, është shënuar gabimisht nga punonjësja e bankës. Në këtë periudhë b/shortja ka pasur burime të ardhurash nga "AOL Studio" dhe pagat në projektin TAP. Tërheqja nga llogaria, e shumës 5.000 euro, në datë 05.11.2015 është kryer në vijim për shpenzime të ndryshme familjare.

Lidhur me transfertën nga shtetasi P.F, dt. 26.05.2017, në shumën 4.500 euro me përshkrimin "Kthim huaje", si dhe transferimin dt. 23.11.2018 i shumës 7.000 euro për këtë shtetas, me përshkrimin: "Kthim borxhi", sqaroi se; shtetasi P. F është bashkëshorti M.H, motra e Arjola Tola dhe jetojnë në Hamburg, Gjermani prej 25 vitesh, ku kanë aktivitetin/biznesi të tyre në fushën e ndërtimit, prej vitit 2006 deri sot. Në periudhën e këtyre viteve, për vetë natyrën e ngushtë marrëdhënieve familjare, kanë kryer pagesa për llogari të tij, tek familjarët/të afërmit e tij, si edhe ai ka kryer pagesa për llogari të subjektit apo të familjes së subjektit dhe kanë marrë hua, pa pasur nevojën të nënshkruajnë marrëveshje apo deklarata. Në varësi të shumave, nevojave dhe gjendjes financiare të momentit, disa nga këto veprime janë pasqyruar edhe me transferta bankare, siç edhe është rasti për shumën 4.500 euro, në datë 26.5.2017, e Cila është kthim huaje për të njëjtën shumë prej 4.500 euro, që i është transferuar nga bashkëshortja më datë 8.5.2017, nga e njëjta llogari z. F.C, për llogari të P.F, me kërkesën e këtij të fundit. Lidhur me këtë rast, sqaroi se, vëllai i z. F.C, ka qenë dhe është i punësuar pranë kompanisë së z. P.F, në Hamburg, Gjermani. Transferimi i shumës prej 7.000 euro nga Arjola Tola, për P.F, është kthim i shumës së marrë hua, cash, nga P.F, në datë 5. 10. 2018, vlerë e cila ishte depozituar në llogarinë e dedikuar për studimet e Nedja Tola, në Intesa Sanpaolo Bank, ndërsa pjesa tjetër prej 1.650 euro i është kthyer cash këtij shtetasi (sqaruar më sipër). Në deklaratat e interesave privatë ndër vite këto transaksione (huadhënie - huamarrje), janë kryer brenda të njëjtit muaj: transaksioni i parë brenda muajit maj 2017 dhe transaksioni i dytë brenda muajit tetor 2018 dhe në periudhat e deklarimit pasardhës kjo marrëdhënie nuk ka ekzistuar.

Kreditimet e kryera nga Shoqëria AOL Shpk, në datat 4.9.2018 dhe 29.12.2020, në shumën totale 10.000 euro, janë pagesa e shpenzime të kryera për llogari të aktivitetit. Burimi i shumës 3.500 euro, datë 23.11.2018, është tërheqje nga arka apo llogaritë bankare të Shoq. "AOL Studio" shpk. dhe qëllimi është për shpenzime të kryera për llogari të aktivitetit. Në llogarinë personale të Arjola Tola, rezultojnë derdhje cash apo transferta nga Shoq. "AOL Studio" shpk, meqenëse ajo është pronare e vetme e Shoq. "AOL Studio" Shpk. Fitimi i realizuar nga "AOL Studio" në vite është transferuar në llogarinë personale të bashkëshortes në periudha të caktuara, sipas nevojave pas pagimit të tatimit të fitimit, sipas legjislacionit në vite.

Shumat e tërhequra në datat 3.8.2020, 22.9.2020, 3.11.2020, 3.3.2021, respektivisht në shumat 3.000 euro, 3.000 euro, 3.000 euro dhe 4.000 euro, nga b/shortja, kishin si qëllim përballimin e shpenzimeve të ndryshme familjare dhe shëndetësore gjatë kohës së pandemisë Covid 19. Shumat e tërhequra në datat 4.5.2022 dhe 20.6.2022, respektivisht prej 4.000 euro/secila, janë përdorur për pushimet e vitit 2022 dhe shpenzime të tjera familjare..."

Konstatohet:

- ✓ **Llogaria rrjedhëse në euro, në Raiffeisen Bank, në emrin e Arjola Tola është krijuar në v.2015, me burim të ardhurat nga pagat. Në këtë llogari janë kryer një sërë transaksionesh, për të cilat subjekti ka dhënë shpjegime.**
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e Raiffeisen Bank dhe shpjegimet e dhëna.**
- ✓ **Dokumentacioni i burimit të krijimit të Llogarisë nga të ardhurat nga papat, trajtohet në vijim, në rubrikën e të ardhurave të b/shortes.**

Pasuria nr.5

Llogari biznesi në euro AOL Studio Shpk, Banka Raiffeisen. Vlera 11.661 euro. Zotëron 100%. **Burimi i krijimit:** Aktiviteti i kompanisë.

Hetimi administrativ

Raiffeisen Bank, me shkresë me nr.*** prot., datë 7.8.2023, nuk e konfirmon llogarinë.

Në proces verbalin e datës 20.3.2024, të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga trupa e vlerësimit **subjekti paraqiti:**

- Nxjerrje llogarie nr. *** , nga Raiffeisen Bank, datë 20.12.2023, që konfirmon llogari në emër të AOL Studio Shpk, në shumën 11.661 euro, datë 8.3.2023.

Konstatohet:

- ✓ *Deklarimi bazohet në dokumentacionin e paraqitur. Raiffeisen bank nuk e konfirmon llogarinë, e cila i përket aktivitetit privat të b/shortes.*

Pasuria nr.6

Llogari personale në BKT. Vlera 263.806 lekë. Zotëron 100 %.

Burimi i krijimit: Të ardhura nga pagat si administratore "AOL Studio" dhe shefe sektori, "Njësia Skavica", "KESH Sha".

Hetimi administrativ

BKT, me shkresë me nr.***prot., datë 14.8.2023, konfirmon se Arjola Tola ka llogari rrjedhëse në lekë, me gjendje në datë 8.3.2023, në shumën 243.706 lekë. Në llogari janë kryer transferta, si vijon:

- Dt. 8.10.2015, *** Sha, ka transferuar shumën 1.030.000 lekë, me përshkrimin "pagesë e dëmeve rasti L.K , 20693 "
- Dt. 19.5.2016, Arjola Tola ka derdhur shumën 500.000 lekë,
- Dt. 12.12.2016, Mithat Tola ka derdhur shumën 400.000 lekë,
- Dt. 9.6.2017, A.V ka transferuar shumën 500.000 lekë, me përshkrimin paradhënie për dëm shëndetësor.

Raiffeisen Bank, me shkresë me nr.***prot., datë 7.8.2023, konfirmon tërheqje cash nga llogaria, për periudhën mars —prill 2016, shuma totale 9.400 euro dhe shtator — nëntor, shuma totale 3.700 euro.

Në proces verbalin e datës 20.3.2024 të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se: "... transferimi i shumës l. 030.000 lekë, në datë 8.10.2015, nga ***" Sha, i përket një praktike të dëmit shëndetësor për shtetasin L.K , praktikë kjo e ndjekur prej tij dhe z. B.K, nga viti 2011 gjatë periudhës së aktivitetit privat, sipas marrëveshjes në vitin 2011. Çështja është ndjekur në vijim nga Arjola Tola dhe A.K dhe pas ndërprerjes së procesit gjyqësor është arritur marrëveshja me shoqërinë siguroese, për pagesën në muajin

janar të vitit 2015. Pagesa i përket shpenzimeve të përfaqësimit dhe parapagesave të kryera për I.K, gjatë kohës së trajtimit të praktikës.

Kreditimi dt. 19.5.2016, i shumës 500.000 lekë, ishte nga tërheqja e kryer nga Arjola Tola, nga llogaria e saj në euro, në Raffeyisen Bank, e konvertuar në lekë, për t'u përdorur për shpenzime familjare, pasi në këtë periudhë, pagat ishin kryesisht në euro.

Kreditimi nga subjekti, i shumës 400.000 lekë, në datë 12.12.2016, ishte tërheqje e kryer nga Arjola Tola, nga llogaria në euro pranë Raiffeisen Bank dhe është konvertuar në lekë nga subjekti për llogari të saj. Më pas e ka depozituar në llogarinë në lekë të Arjola Tola në BKT, për t'u përdorur për shpenzime familjare, duke qenë se në këtë periudhë pagat e Arjola Tola kanë qenë kryesisht në euro.

Për transfertën e kryer nga shtetasi A.V, në datë 9.6.2017, në shumën 500.000 lekë, me përshkrimin "paradhënie për dëm shëndetësor sqaroi se, në periudhën 2012 – 2013, gjatë aktivitetit privat, subjekti ka ndjekur të gjithë procedurat e përfitimit të dëmit shëndetësor për këtë shtetas, si pasojë e një aksidenti rrugor, datë 15.6.2011, i autorizuar me Prokurë të Posaçme me nr. *** rep., dhe nr. ***kol., datë 14.1.2012. Janë suportuar të gjithë procedurat pranë korrespondentit të Byrosë Greke të Sigurimeve "****" për të përfituar dëmin shëndetësor në zbatim të dispozitave të legjislacionit shqiptar, procedura që u finalizuan në vitin 2017, me Vendim të Gjykatës së Apelit në Tiranë. Shuma prej 500.000 lekë e transferuar nga ky person në llogarinë e Arjola Tola ka qenë kompensimi për asistencën e dhënë gjatë proceseve për përfitimin e dëmit shëndetësor, sipas marrëveshjes në vitin 2012..."

(Dokumentacion trajtuar më sipër).

Subjekti paraqiti

- **Kërkesë, datë 1.11.2013**, drejtuar shoqërisë "****" Sha., nga Mithat Tola dhe B.K , për njoftim të kalimit të së drejtës së përfaqësimit për finalizimin e procedurave të praktikës së demit shëndetësor të shtetasit L.K , datë 6.7.2011, tek Arjola Tola dhe A.K ;
- **Akt Marrëveshje**, datë 1.11.2013, me palë e parë Mithat Tola dhe B.K dhe palë e dytë Arjola Tola dhe A.K , për kalimin e të drejtës së përfaqësimit për finalizimin e procedurave të praktikës së demit shëndetësor, të shtetasit L.K , datë 6.7.2011;
- **Akt marrëveshje për shlyerjen e detyrimit me këste**, datë 22.1.2015, midis shtetasve I.K , L.K, P.K të përfaqësuar nga Mithat Tola dhe B.K dhe shoqërisë "****" Sha, në shumën 7.796.138 lekë, nga e cila l. 560.000 lekë do t' i kalojë përfaqësuesve (M. Tola dhe B.K), si shpenzim përfaqësimi, ndërsa shuma 500.000 lekë do të paguhet, po ashtu, në favor të përfaqësuesve, pasi përbën një parapagesë të dhënë nga përfaqësuesit në favor të znj. I.K ; Kopje pasaporte e shtetases L.K;
- **Kërkesë Padi**, datë 10.11.2014, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë paditëse I.K dhe L.K dhe palë e paditur "****" Sha, për dëmshpërblimin për dëmin e plotë pasuror dhe jo pasuror, të pësuar në aksidentin automobilistik, datë 6.7.2011, me pasojë vdekjen e shtetasit L.K .,
- **Autorizim në Athinë**, datë 23.3.2012, nga shtetasit I.K dhe L.K, të cilat emërojnë përfaqësues të posaçëm "Qendrën e Studimeve të Sigurisë Rrugore " përfaqësuar nga Mithat Tola dhe B.K , për të ndjekur të gjitha procedurat përkatëse për aksidentin automobilistik, të ndodhur në datë 6.7.2011, ku u aksidentua shtetasi L.K ; Deklaratë datë 22.1.2015, nga I.K dhe L.K të përfaqësuar nga Arjola Tola, "Për lëshimin e vlerës së dëmshpërblimit" të cilat pas diskutimeve me shoqërinë "****", deklarojnë se janë dakord për zgjidhjen me mirëkuptim të çështjes së dëmshpërblimit të demit;

Konstatohet

- ✓ **BKT konfirmon Llogari në vlerën 243.706 lekë, dt. 8.3.2023.**
- ✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues, lidhur me transaksionet e konfirmuara në llogari.**

Pasuria nr.7

Llogari personale në BKT. Vlera 226 euro. Zotëron 100⁰/0.

Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga dhe konsulentat.

Hetimi administrativ

BKT, me shkresë me nr.***prot., datë 14.8.2023, konfirmon Llogari rrjedhëse në euro me gjendje, në datë 8.3.2023, në shumën 226 euro. Në llogari janë kryer transfertat. .

Dt. 14.5.2012, transferuar nga AOL Studio SHPK, shuma 6.000 euro, .

Dt. 22.6.2012, Mithat Tola ka derdhur shumën 5.500 euro.

Dt. 4.10.2012, Mithat Tola ka derdhur shumën 10.000 euro, .

Dt. 2.5.2017, Mithat Tola ka derdhur shumën 3.500 euro, .

Konfirmohet gjithashtu;

Llogari në lekë në emër të Arjola Tola, nga ku figuron se, në datat 31.1.2017 dhe 1.3.2017, është tërhequr cash shuma totale 450.000 lekë.

Llogari në emër të Mithat Tola, nga ku figuron se në datat 28.2.2012, 20.3.2012, 5.4.2012, subjekti ka tërhequr shumën totale 5.500 euro.

Credins Bank me shkresë me nr.***prot., datë 31.8.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në euro, në emër të Arjola Tola, nga ku figurojnë transaksione tërheqjeje cash, për periudhën prill — tetor 2012, në shumën totale 12.000 euro.

Në proces verbalin e datës 20.3.2024 të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga trupa e vlerësimit subjekti sqaroi se; "... transferimi në datë 14.5.2012 nga AOL Studio, i shumës 6.000 euro është kryer pasi, në këtë periudhë kjo shoqëri ka pasur kontratë shërbimi me shoqëritë "****". Transferimet janë kryer për të mbuluar shpenzimet e kryera për realizimin e kësaj kontrate, kryesisht shpenzime transporti dhe akomodimi, duke qenë se projekti ishte i shtrirë në gjithë Shqipërinë.

Kreditimi nga subjekti në datë 22.6.2012, i shumës 5.500 euro, ka si burim tërheqjet e kryera nga llogaria personale në euro në BKT, në datat 28.2.2012; 20.3.2012 dhe 5.4.2012. Këto shuma janë depozituar në llogarinë e Arjola Tola, për t'i përdorur për shpenzime dhe kursime. Kreditimi nga subjekti, në datë 4.10.2012, i shumës 10.000 euro, ka si burim tërheqjet e kryera nga Arjola Tola, në periudhën prill — tetor 2012, në shumën 12.000 euro, nga llogaria personale e saj në Credins Bank dhe janë derdhur dorazi nga subjekti në llogarinë e Arjola Tola, në BKT. Burimi i kreditimeve në Credins Bank, janë të ardhurat nga punësimi i Arjola Tola, në shoqërinë "****".

Kreditimi nga subjekti, në datë 2.5.2017, i shumës 3.500 euro, ka si burim tërheqjet nga llogaria personale në lekë e Arjola Tola, në BKT, të cilat janë konvertuar në euro dhe depozituar nga subjekti në llogarinë e saj në euro, po në BKT.

Në përmbledhje të shpjegimeve më sipër, shumat e derdhura nga subjekti në llogarinë e bashkëshortes, kanë si burim të ardhura të ligjshme të krijuara nga puna dhe aktiviteti privat në vitet e kryerjes së transaksioneve...”

Konstatohet

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e BKT.**
- ✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime, lidhur me transaksionet e kryera në llogari.**
- ✓ **Dokumentacioni i burimit të transaksioneve nga të ardhurat nga pagat dhe aktiviteti privat, trajtohet në rubrikat përkatëse të të ardhurave.**

Pasuria nr.8

Depozitë bankare në BKT. Vlera 11.857 euro. Zotëron 100 %.

Burimi i krijimit: Kursime familjare ndër vite.

Hetimi administrativ

BKT me shkresë me nr. ***prot., datë 14.8.2023, konfirmon llogarinë në vlerën 11.800 euro, dt. 8.3.2023. Konstatohet depozitimi i shumës 11.000 euro, dt. 21.1.2009 dhe kalimi i saj në depozitë, në datë 22.1.2009.

Konstatohet

- ✓ *Depozita në euro në BKT, në emrin e Arjola Tola është krijuar në v. 2009, me burim të kursime familjare, ndër vite.*
- ✓ *BKT konfirmon depozitë në shumën 11.800 euro, dt. 8.3.2023. Dokumentacioni i burimit të krijimit të shumës, nga kursime familjare ndër vite, trajtohet në rubrikat përkatëse të të ardhurave.*

Pasuri nr.9

Llogari biznesi e "AOL Studio Shpk", në BKT. Vlera 1.125.886 lekë. Zotëron 100%.

Burimi i krijimit: Aktiviteti i kompanisë.

Hetimi administrativ

BKT me shkresë me nr.***prot., datë 14.8.2023, nuk e konfirmon llogarinë.

Subjekti paraqiti

- Nxjerrje llogarie bankare, në emër të AOL Studio Shpk, datë 18.11.2023, nga BKT, me gjendje, në datë 27.2.2023, shumën 1.179.427 lekë.

Konstatohet

- ✓ ***Deklarimi bazohet në dokumentacionin e paraqitur.***
- ✓ ***BKT nuk e konfirmon llogarinë, e cila i përket aktivitetit privat të b/shortes.***

Pasuria nr.10

Llogari biznesi e "AOL Studio Shpk", BKT. Vlera 56.543 euro. Zotëron 100 %/0.

Burimi i krijimit: Aktiviteti i kompanisë.

Hetimi administrativ

BKT me shkresë me nr.***prot., datë 14.8.2023, nuk e konfirmon Llogarinë.

Subjekti paraqiti

- Nxjerrje Llogarie bankare, në emër të AOL Studio Shpk, datë 18.11.2023, nga BICT, me gjendje, në datë 27.2.2023, shumën 1.179.427 lekë.

Konstatohet

- ✓ **Deklarimi bazohet në dokumentacionin e paraqitur.**
- ✓ **BKT nuk e konfirmon llogarinë, e cila i përket aktivitetit privat të b/shortes.**

Pasuria nr.11

Llogari personale në "HASPA, Hamburger Sparkasse", Gjermani. Vlera 21.851 euro. Zotëron 100%.

Burimi i krijimit: Transferim nga llogaria personale bankare në BKT dhe të ardhura nga qiraja e apartamentit në Hamburg.

Hetimi administrativ

Raiffeisen Bank me shkresë me nr. ***prot., datë 7.8.2023, përcjell CD, që konfirmon se Arjola Tola, në datë 28.4.2021, ka transferuar shumën 12.036 euro, në Llogari personale në Gjermani.

Në proces verbalin e datës 20.3.2024, të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga trupa e vlerësimit subjekti sqaroi se; “... Llogaria është krijuar në datë 18.12.2020 dhe gjendja e saj në datë 8.3.2023, është në shumën 21.751 euro
Sqaroi se transferta e kryer në RFZ Bank, dt. 28.4.2021, në shumën 12.036 euro kishte qëllim mbulimin e shpenzimeve për mirëmbajtjen e apartamentit në Hamburg, Gjermani dhe për t'i pasur gjendje në llogari. Në dokumentin "nxjerrje Llogarie bankare " nga HASPA Bank Hamburg, pasqyrohen kreditimet dhe debitimet përkatëse, konkretisht në datë 30.4.2021 është kryer transferimi i vlerës 12.000 euro...”

Subjekti paraqiti

- **Nxjerrje Llogarie**, datë 19.11. 2023, nga HASPA, Hamburger Sparkasse, Gjermani, për llogari në emrin e Arjola Tola, hapur dt. 17.12.2020 dhe gjendje në datë 8.3.2023, në shumën 21.751 euro. Konstatohet kreditimi i shumës 12.000 euro, dt. 30.4.2021, si dhe kreditime për qira apartamenti.

Konstatohet

- ✓ *Deklarimi bazohet në dokumentacionin e paraqitur, shpjegimet e dhëna dhe konfirmimin nga Raiffeisen Bank. Llogaria është hapur më dt. 17.12.2020, në bankë gjermane.*
- ✓ *Burimi i krijimit të llogarisë me të ardhurat nga paga dhe qiraja e apartamentit, në Gjermani, trajtohet në vijim, në rubrikën përkatëse të të ardhurave.*

Pasuria nr.12

Llogari personale në Alpha Bank, jo aktive. Vlera 0 lekë. Zotëron 100%.

OTP Bank me shkresë me nr. *** prot., datë 4.8.2023, konfirmon llogari në vlerën 0 lekë (duke qenë se Alpha Bank është përthithur nga OTP Bank, duke filluar nga data 1.12.2022, banka ka dhënë informacionin edhe mbi llogaritë, që klientët kanë patur në dy sistemet bankare).

Konfirmohet deklarinin me përgjigjen e OTP Bank.

Pasuria nr.12

Fonde investimi/Pensioni, pranë "Sigal Uniqa Group Austria". Vlera 167.032 lekë. Zotëron 100%. **Burimi i krijimit:** Kontributi nga punëdhënësi Projekti TAP.

Hetimi administrativ

Në proces verbalin e datës 20.3.2024, të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga trupa e vlerësimit **subjekti paraqiti.**

- **Dokumentin Fond Pensioni** nga Shoq. "Sigal Uniqa Group Austria ", që konfirmon hapjen e fondit të pensionit në emrin e Arjola Tola dhe deri në datë 31.12.2022 ka këto të dhëna: Data e anëtarësimit 22.2.2021; Kontribute gjithsej të paguara 162.739 lekë (kontribut i punëdhënësit 162.739 lekë, kontribut i punëmarrësit 0 lekë); Shuma totale e llogarisë: 169.318 lekë; Interesi i fituar: 6.579 lekë. Për vitin 2022 kontributet janë investuar në obligacione të emetuara nga Qeveria Shqiptare.

Konstatohet

- ✓ *Deklarimi bazohet në dokumentacionin e paraqitur. Llogaria është hapur në dt. 22.2.2021.*

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Të ardhura nga fitimi në Vite nga "AOL Studio", aksioner i vetëm: 2011 - 2021. Shuma 24.206.151 lekë.
- Të ardhura nga paga si administratore e AOL Studio, 2011 e në vijim. Shuma 4.000.000 lekë.

- Të ardhura nga paga si shefe sektori, projekti Skavica, KESH Sha, 19 janar 2023 — shkurt 2023. Shuma 228.882 lekë.
- Të ardhura nga paga e shpërblime si Menaxhere për Tokën, Projekti TAP-AG. Janar 2021 — mars 2022. Shuma 42.088 euro.
- Të ardhura nga paga si këshilltare për pronat, pranë projektit TAP. Mars 2015 — prill 2017. Shuma 45.498 euro.
- Të ardhura nga paga si konsulente projekti, kompania Tracas & Inypsa. Shuma 24.000 euro.
- Të ardhura nga paga / konsulenca për subjektin "Lorenzo Shpk". Shuma 672.000 lekë. Të ardhura nga paga pranë Sekretariatit Teknik të KQT (nga MBUMK). Dhjetor 2009 — mars 2011. Shuma 1.958.792 lekë.
- Të ardhura nga paga pranë "Dijon Albania" sha & "CAE" shpk. Shuma 300.000 lekë.
- Të ardhura nga konsulenca të ndryshme apo komisione për periudhën 2003 — 2011, sipas licencave të vlerësueshme dhe licencave të tjera. Shuma 19.000 euro.
- Të ardhura nga konsulenca të ndryshme apo komisione, për periudhën 2003 — 2011, sipas licencave të vlerësueshme dhe licencave të tjera; si dhe nga fitimi i gjyqit me ZQRP. Shuma 2.393.279 lekë.
- Të ardhura nga paga neto, pranë ZVRPP Tiranë. Korrik 2003 - 2008. Shuma 1.800.000 lekë.
- Të ardhura nga paga neto pranë "Entit Kombëtar të Banesave" si Specialiste, Ing. Ndërtimi dhe Përgjegjëse Sektori. Qershor 2000 — qershor 2003. Shuma 848.358 lekë.
- Të ardhura nga qiraja e apartamentit, Hamburg. Mars 2021 — e në vijim. Shuma 11 .383 euro.

Hetimi adminsitrativ

Raiffeisen Bank me shkresë me nr. ***prot., datë 7.8.2023, përcjell CD që konfirmon se për periudhën 7.4.2015 — 7.7.2017, janë kredituar të ardhura nga pagat nga Dr. Pendl & Dr. PisëabG, në shumën rreth 52.269 euro ndërsa për periudhën 25.1.2021 13.4.2022, është kredituar nga "Adriatic Pipeline AG" shuma rreth 44.750 euro; Në datë 3.8.2020, AOL Studio ka kredituar dividendin e v. 2019, në shumën 33.000 euro.

Raiffeisen Bank, me postë elektronike datë 10.11.2023, konfirmon se për periudhën 13.5.2005 — 14.1.2009 janë kredituar pagat, shpërblime dhe Sig. shoq. në shumën rreth 1.303.216 lekë.

BKT me shkresë me nr.***prot., datë 14.8.2023, konfirmon se për periudhën 17.2.2009 — 2.3.2023, janë kredituar të ardhura nga dëmshpërblimi i pagave, nga ZQRPP, shuma 463.279 lekë; pagat nga AOL Studio Shpk, shuma rreth 3.714.000 lekë dhe nga KESH, shuma 228.862 lekë; shuma totale rreth 4.406.000 lekë.

Credins Bank me shkresë me nr. ***prot., datë 31.8.2023, konfirmon:

Llogari në lekë, ku figuron se në datë 20.10.2014, janë kredituar paga nga AOL Studio Shpk, në shumën 239.760 lekë.

Llogari në euro, ku për periudhën 2.12.2011 — 2.2.2017, janë kredituar të ardhura nga paga, nga BPSH Tracasa —Inypsa dhe QSA, në shumën rreth 29.100 euro.

OTP Bank me shkresë me nr.*** prot., datë 4.8.2023, konfirmon se për periudhën 25.4.2016 — 27.12.2017, janë kredituar të ardhura nga pagat e kompanisë dhe nga Lorenzo and Co Shpk, në shumën rreth 563.205 lekë.

OKB, me shkresë me nr.***prot., datë 7.8.2023 konfirmon se Arjola Tola, figuron e regjistruar si administratore dhe ortakë e vetme me 100% të kapitalit në shoqërinë "AOL Studio" Shpk, me NUIS (NIPT) Li1606008L. Regjistruar në datë 5.4.2011.

DRT Tiranë me shkresë me nr.***prot., datë 17.8.2023, konfirmon se Arjola Tola rezulton aksioner individ i kompanisë "AOL Studio " Shpk, me NIPT ***, regjistruar në sistemin tatimor, në datë 6.4.2011. Aktiviteti: Aktivitete juridikë.

Të ardhurat e deklaruara nga ky subjekt, sipas të dhënave të deklaratave të të ardhurave të dorëzuara në sistemin tatimor C@ts, janë si vijon:

<i>Viti</i>	<i>Qarkullimi</i>	<i>Fitimi</i>	<i>Fitimi pas tatimit</i>
2012	340.000	18.000	18.000
2013	3.071.032	1.001.425	901.282
2014	4.847.781	3.023.304	2.801.181
2015	935.520	199.007	174.007
2016	670.124	299.740	299.740
2017	4.747.241	3.676.825	3.676.825
2018	5.825.577	3.497.181	3.322.322
2019	8.000.000	5.962.874	5.664.730
2020 T. fit. Thjesht.	3.916.457	2.380.861	2.261.818
2020 T. fitimi.	6.067.723	2.964.400	2.816.180
2021	1.417.000	606.228	606.228
2022	4.092.920	2.308.496	2.308.496

Ka shpërndarë dividend si vijon:

<i>Periudha e deklarimit</i>	<i>Dividenti i shpërndarë</i>	<i>Paguar tatimi mbi dividendin</i>
2020/06	4.000.000	320.000
2021/07	2.000.000	160.000

Fitimi pas tatimit për periudhën 2012 - 2020, rezulton në shumën totale rreth 19.120.000 lekë dhe dividenti për periudhën 2020 - 2021, në shumën totale neto 5.520.000 lekë.

Nuk ka detyrime të paguara. Bashkëlidhur: Formularët e deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël, periudha tatimore 2012 - 2014; Formularët e deklarimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, periudha tatimore 2015 2020; Formularët e deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi fitimin, periudha tatimore 2020 - 2022; detyrimet në kohë reale.

ISSH me shkresë me nr.***prot., datë 11.8.2023, konfirmon periudha kontributive të Arjola Tola, janar 2012 — mars 2023.

ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror, me shkresën kthim përgjigje nr. ***prot., datë 17.8.2023, nuk konfirmon të dhëna për periudhën 1994 — 2012, për Arjola Petrit Tola. Bashkëlidhur: Vërtetim negativ nr. *** prot., datë 14.8.2023, për vjetërsinë në punë për efekt pensioni.

Në proces verbalin e datës 20.3.2024 të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga trupa e vlerësimit subjekti sqaroi se; "...aktiviteti i Shoq. "AOL Studio Shpk", me NIPT***, në të cilin Arjola Tola është administratore dhe aksionere me 100% të kuotave, ka si Objekt: shërbime profesionale konsulence e realizuar kryesisht nga vetë ortaku. Për periudha të caktuara, pavarësisht se me klientë të ndryshëm është lidhur kontratë shërbimi me shoq. "AOL Studio " Shpk, marrëdhënia me klientin ka qenë marrëdhënie punësimi për Arjola Tola.

Tërheqja e fitimeve të shoqërisë është bërë jo në mënyrë periodike, por me tërheqje të kryera nga ortaku i vetëm sipas nevojave, gjithmonë duke paguar detyrimin tatimor përkatës pranë organeve tatimore, si për llogari të shoqërisë ashtu edhe tatimin mbi të ardhurat personale si individ

Shoq. "AOL Studio" Shpk, me NIPT***, ka operuar si biznes i vogël dhe si e tillë, bazuar në nenin 5.6 "Vendimi për destinimin e fitimit" të UMF nr.5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, subjekti nuk ka pasur detyrimi të depozitave pranë Administratës Tatimore, vendimin e organit kompetent të shoqërisë, lidhur me rezultatet financiarë të vitit paraardhës dhe destinimin e fitimit pas tatimit, pasi është biznes i vogël me përgjegjësi tatimore për "Tatimin e Thjeshtuar " mbifitimin. Për kreditimet e pagave nga kompania "Dr. Pendl & Dr.Pisëanger People " Shpk, në llogarinë në Raiffeisen Bank, sqaroi se kjo kompani ka kryer rolin e agjencisë së punësimit për projektin TAP "Trans Adriatic Pipeline AG" dhe punësimi i Arjola Tola në këtë projekt, ka qenë nëpërmjet kësaj agjencie. Për vlerën e të ardhurave të deklaruara për pagat, bashkëshortja i është referuar pagesës mujore të kontratave me "Dr.Pendl & Dr.Pisëanger".

Gjatë periudhës janar 2009 — mars 2011, Arjola Tola ka qenë e punësuar pranë Sekretariatit Teknik të Komisionit Qeveritar të Tokës, pranë MBUMK dhe ka realizuar të ardhura, mbi të cilat është derdhur kontributi në subjektin, Ministria e Bujqësisë, në shumën l. 782.***lekë. Për të ardhurat e deklaruara pranë kompanisë "Dijon Albania" sha, nuk disponohet kontratë pune.

Të ardhurat mujore nga pagat, pranë kompanisë *** Shpk, sipas kontratës janë 100.000 lekë neto dhe janë marrë cash. Të ardhurat janë deklaruar në shumën totale 300.000 lekë pasi kontrata është ndërprerë, para përfundimit të afatit.

Lidhur me të ardhurat e deklaruara për periudhën 2003 — 2011, nga konsulenca të ndryshme apo komisione, sipas licencave të vlerësueshme dhe licencave të tjera, subjekti shpjegon se Arjola Tola ka ushtruar profesionin e inxhinieres së ndërtimit nga viti 1998 dhe është pajisur me licenca nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit për ushtrimin e profesionit të inxhinieres për ndërtime civile dhe industriale, si dhe për ushtrimin e profesionit të vlerësuesit të pasurive të paluajtshme. Gjatë kësaj periudhe, ka krijuar të ardhura nga ekspertiza apo konsulenca të ndryshme për individë apo subjekte privatë, si vijon: Raporte Vlerësimi për Pasuri të Paluajtshme me vlerë mesatare 120 - 250 euro ose 15.000 lekë - 30.000 lekë, për raport vlerësimi; Projekte të ndryshme për ndërtime individuale, përfshirë ndjekjen e punimeve, si dhe përgatitjen dhe mbajtjen e dokumentacionit tekniko - ligjor, me vlerë mesatare 500 euro — 1.500euro, në varësi të projektit dhe angazhimit. Plane të ndryshme rievrimi apo planimetri për ndarje pasurish, për efekt të regjistrimi apo konflikte gjyqësore me vlerë mesatare 50 euro — 200 euro, në varësi të pronës apo angazhimit të kërkuar; Konsulenca të ndryshme për individë apo subjekte, lidhur me përgatitje dokumentacioni tekniko-ligjor për kthim-kompensim prone, çështje gjyqësore pronësie apo lidhur me ndërtimin, analizë dokumentacioni dhe asistencë në përgatitjen e dosjeve/dokumentacionit për leje ndërtimi, etj. Gjatë kësaj periudhe ka punuar privatisht, kryesisht pa kontrata deri në momentin e rregullimit

me ligj të profesioneve të lira dhe nuk ka mbajtur të dhëna apo dokumentacion mbi shërbimet e kryera dhe pagesat gjatë kësaj periudhe. Më pas, ka vijuar të krijojë të ardhura nga konsulentat dhe ekspertizat, duke krijuar shoqërinë "AOL Studio " Shpk, regjistruar në organet tatimore dt.6.4.2011, aktivitet të cilin e vazhdon edhe sot.

Lidhur me të ardhurat nga qiraja e apartamentit në Hamburg, Gjermani, sqaron se sipas legjislacionit gjerman, pronari i ri ishte i detyruar të vazhdonte marrëdhënien e qirasë me qiramarrësin, deri sa ky i fundit të gjente një akomodim tjetër. Për arsye se qiramarrësi ekzistues, në momentin e blerjes së apartamentit, kishte banuar në të njëjtin apartament, prej më shumë se 10 vitesh, kjo marrëdhënie qiraje është vazhduar edhe pas blerjes së apartamentit. Kjo pasqyrohet edhe në kontratën e blerjes, datë 30. 11. 2020, ku citohet se: "Prona e blerë aktualisht i është dhënë me qira A.S dhe marrëveshja e qirasë është përfundimtare. Blerësi është në dijeni të përmbajtjes së plotë të marrëveshjes së qirasë, të datës l. 12.1996 ". Si rezultat i kësaj marrëdhënie qiraje të detyruar nga ligji, qiramarrësja, Angelika Seraphin ka kredituar shumën e qirasë në llogarinë e bashkëshortes në HASPA Bank Hamburg Gjermani, deri në muajin mars 2022. Pas kësaj periudhe, apartamenti është shfrytëzuar për banim nga vajza, Nedia Tola, e cila ka kredituar në llogarinë b/shortes, për periudhën qershor 2022 — shkurt 2023, rreth 2.978 euro, shumë e cila përfaqëson shpenzimet e kryera për apartamentin, dhe të deklaruara nga b/shortja...’

Subjekti paraqiti:

- **Vendim datë 30.06.2020**, i ortakut të vetëm të Shoq. "AOL Studio" Shpk, me NIPT ***, që ka vendosur: Të miratojë pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin 2019; Rezultati neto pas zbritjes së tatim fitimit të shoqërisë për vitin 2019, është me fitim në shumën 6.051.880 lekë; Fitimi i vitit 2019 do të destinohet si vijon: Për tatimin e plotë të vitit 2019, të shpërndajë dividend në shumën 4.000.000 lekë; Për fitimet e pashpërndara dhe rezervat, të mos shpërndajë dividend: 2.051.880 lekë.
- **Vendim datë 30.06.2021** i ortakut të vetëm të Shoq. "AOL Studio" Shpk, me NIPT ***, që ka vendosur: Të miratojë pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin 2020; Rezultati neto pas zbritjes së tatim fitimit të shoqërisë për vitin 2020, është me fitim në shumën 6.184.264 lekë; Fitimi i vitit 2020 do të destinohet si vijon: Për tatimin e plotë të vitit 2020: Pjesa prej 2.000.000 lekë nga fitimi i vitit 2020, për shpërndarje dividend; Pjesa që mbetet prej 4.184.264 lekë, të mbartet tek fitimet e pashpërndara.
- **Vendim datë 01.06.2022**, i ortakut të vetëm të Shoq. "AOL Studio" Shpk, me NIPT ***, që ka vendosur: Të miratojë pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin 2021; Rezultati neto pas zbritjes së tatim fitimit të shoqërisë për vitin 2021, është me fitim në shumën 606.228 lekë, që do të kalojë në fitime - humbje të shoqërisë.
- **Vërtetim nga e-albania**, datë 12.11.2023, që konfirmon se Shoq. "AOL Studio" Shpk, me NIPT ***, nuk ka asnjë detyrim tatimor papaguar, deri në datë 12.11.2023.
- **Vendim dt. 25.06.2023**, i ortakut të "AOL Studio" shpk, me NIPT ***, i cili ka vendosur: Miratimin e pasqyrave financiarë të v. 2022; Fitimi i vitit ushtrimor 2022 rezulton në shumën 2.308.406 lekë. Fitimi i vitit dhe fitimet e pashpërndara në vitet paraardhëse do të destinohen: 4.300.000 lekë për shpërndarje dividenti.
- **Kthim përgjigje nr. 4172 prot., datë 06.09.2019**, nga DRT Tiranë, drejtuar Komisionit të Jashtëm të Kualifikimit, nëpërmjet të cilës konfirmon se individi Arjola Tola është administratore dhe aksionere me 100% të kuotave të Shoq. "AOL Studio " Shpk, me NIPT ***. Ky subjekt nuk ka pasur detyrim të depozitave pranë administratës tatimore, vendimet e organit vendimmarrës të shoqërisë, lidhur me rezultatet financiarë, pasi është biznes i

vogël, me përgjegjësi tatimore ”përgjegjësinë tatimore për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin ". Të ardhurat e realizuara për vitin 2011; deklaruar të ardhura 4.012.927 lekë, shpenzime 769.013 lekë, fitimi neto pas tatimit: 3.229.711 lekë.

Fitimi pas tatimit për vitin 2011, rezulton në shumën 3.229.711 lekë.

- **Kontratë pune, datë 16.03.2015**, lidhur midis kompanisë "****" Shpk. dhe Arjola Tola, që konfirmon pagën mujore bruto 2.500 euro; Kontratë pune datë 20.3.2016, lidhur midis kompanisë "****" Shpk dhe Arjola Tola, që konfirmon pagën mujore bruto 2.500 euro; Kontratë pune datë 31.3.2017, ku palët bien dakord të shtyjnë afatin kohor të kontratës së shërbimit, nënshkruar mes palëve, në datë 15.6.2017. 190 shtojcë marrëveshje bëhet efektive më 1.1.2018 dhe vazhdon deri në datë 31.12.2018.
- **Marrëveshje nr. *** prot., datë 05.07.2017**, për ndërprerje me mirëkuptim të marrëdhënies së punës midis ***Shpk dhe Arjola Tola, ku palët konfirmojnë se detyrimet e hapura të P&P ndaj Arjola Tola janë si më poshtë. paga për periudhën l. 1.2017 — 14.6.2017 do t' i paguhet punëmarrësit, në shumën 2.500 euro; kontratë pune datë 17.12.2020 (në gjuhën angleze) midis kompanisë TAP "****" dhe Arjola Tola, për periudhën e punësimit 1.1.2021 — 31.3.2022.
- **Marrëveshje shërbimi, datë 01.04.2011**, me palë Shoq. "AOL Studio " Shpk dhe "****". Objekti: regjistrimi fillestar sistematik i pasurive të paluajtshme, sipas kërkesave të projektit LAMP, me afat të pacaktuar, por minimumi 6 M, me pagesë mujore 1.200 euro në muaj, plus tatimi mbi vlerën e shtuar.
- **Kontratë Pune Individuale, datë 01.11.2011**, me palë shoqëritë "****" dhe Arjola Tola, me afat kohe të pacaktuar, me pagesë mujore 1.500 euro.
- **Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme me nr. *** prot., datë 24.07.2019**, nga DRSSH Tiranë, që vërteton se Arjola Tola, për periudhën janar 2009 — mars 2011 ka realizuar të ardhura mbi të cilat është derdhur kontributi në subjektin Ministria e Bujqësisë, në shumën l. 782.***lekë, Llogaritur neto rreth 1.426.000 lekë.
- **Kontratë Individuale Pune**, lidhur midis Shoq. "****" Shpk dhe Arjola Tabaku (Tola), me afat 1 vjeçar nga data 24.10.2008 — 23. 10. 2009, me pagë mujore 100.000 lekë, sipas së cilës, detyra e Arjola Tola (punëmarrësit) është Drejtues Teknik.
- **Licencë Z. ***, datë 11.06.2003**, nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, për Arjola Tola, për ushtrimin e profesionit të Inxhinieres për Ndërtime Civile dhe Industriale, regjistruar në regjistrin themeltar, që nga data 11.6.2003.
- **Licencë nr. ***, datë 23.12.2003**, nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit për Arjola Tola, për ushtrimin e profesionit të Vlerësuesit (Shkalla e 11-të).
- **Diplomë me nr. ***, datë 20.07.1998**, nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, që konfirmon se Arjola Tabaku, i jepet titulli Inxhinier Ndërtimi;
- **Diplomë me nr. ***, datë 20.02.2005**, nga Fakulteti i Drejtësisë, që konfirmon se Arjola Tabaku, i jepet titulli Jurist.
- **Vendim nr. ***, datë 17.03.2009**, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e Cila vendosi: Pranimin e pjesshëm të kërkesës së palës paditëse; Detyrimin e të paditurit ZQRPP Tiranë të dëmshpërblejë paditësen Arjola Tola për zgjidhjen e kontratës së punës me pagën e 9 (nëntë) muajve, në masën që e ka pasur ditën e zgjidhjes së kontratës së punës, datë 13.8.2008.
- **Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme me nr. *** prot., datë 24.07.2019**, nga DRSSH Tiranë, që vërteton se Arjola Tola, për periudhën shkurt 2000 — qershor 2003, ka realizuar të ardhura, mbi të cilat është derdhur kontributi në subjektin EKB, në shumën 810.921 lekë, llogaritur neto rreth 649.000 lekë.

- **Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme nr. *** prot., datë 25.07.2019**, nga DRSSH Tiranë që vërteton se Arjola Tola, për periudhën korrik 2003 — prill 2005 ka realizuar të ardhura mbi të cilat është derdhur kontributi në subjektin ZQRPP Tiranë, në shumën 321.009 lekë, llogaritur neto rreth 257.000 lekë.
- **Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme nr. *** prot., datë 25.07.2019**, nga DRSSH Tiranë, që vërteton se Arjola Tola, për periudhën janar 2007 — gusht 2008 ka realizuar të ardhura në subjektin ZQRPP Tiranë.
- **Nxjerrje llogarie nga HASPA Bank Hamburg, Gjermani, datë 19.11.2023**, që konfirmon kreditimet për qira apartamenti, periudha mars 2021 — shkurt 2023, rreth 11.100 euro, nga të cilat 8.100 euro për periudhën mars 2021 - mars 2022, nga A.S dhe qershor 2022 — shkurt 2023, në shumën 2.978 euro, nga Nedra Tola.
- **Vërtetim (Për pagim detyrimesh)** me nr. ***, datë 12.11.2023, që konfirmon se AOL Studio, me NIPT ***, nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri në datë 12.11.2023.

Konstatohet

- ✓ *Të ardhurat nga pagat e b/shortes për periudhën, shkurt 2000 — mars 2023, rezultojnë rreth 9.145.000 lekë + 126.000 euro e konvertuar rreth 23.641.000 lekë.*
- ✓ *Të ardhurat nga aktiviteti privat i shoq. "AOL Studio" Shpk, për periudhën 2011-2022, rezultojnë rreth 27.870.000 lekë; Për periudhën 2011 — qershor 2020, rreth 22.349.609 lekë, trajtuar si biznes i vogël me përgjegjësi tatimore për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin); Për periudhën qershor 2020 — korrik 2021, është trajtuar si biznes i madh dhe ka shpërndarë dividend në shumën totale 6.000.000 lekë, për të cilat është paguar tatimi mbi dividendin, në shumën 480.000 lekë, neto 5.520.000 lekë;*
- ✓ *Të ardhurat nga qiraja e apartamentit në Gjermani, për periudhën mars 2021 -shkurt 2023, rezultojnë rreth 11.100 euro.*

DEKLARIM I VAJZËS SË SUBJEKTIT NEDIA TOLA **DEKLARIMI I PASURIVE**

Pasuria nr.1

Llogari personale në Credins Bank. Vlera 0 lekë. Zotëron 100%.

Hetimi administrativ

Credins Bank me shkresë me nr. ***prot., datë 31.8.2023, nuk konfirmon llogari në lekë, por konfirmon llogari në euro, për periudhën 11.07.2017 - 22.08.2017, e cila rezulton e mbyllur dhe me vlerë 0.

Konstatohet:

- ✓ **Credins Bank konfirmon llogari në vlerën 0 euro.**

Pasuria nr. 2

Llogari personale në Hamburg Sparkase, Hamburg, Gjermani. Vlera 3.529 euro. Zotëron 100%. Burimi: Të ardhura nga pagat.

Hetimi administrativ

Në proces verbalin e datës 20.03.2024, mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga trupa e vlerësimit subjekti sqaroi se; “...*HASPA Bank, është shkurtim i Hamburger Sparkase dhe se llogaria në HASPA, Gjermani, deklaruar nga vajza ndër vite, është e njëjta llogari e deklaruar në deklaratën e vlerësimit kalimtar...*”

Subjekti paraqiti:

- Dokument bankar, datë 27.11.2023 nga HASPA Bank Gjermani (shkurtim i Hamburger Sparkase), hapur më dt. 5.12.2022 dhe gjendje në dt. 09.03.2023, në shumën 3.896 euro.
- Dokument bankar, datë 27.11.2023, nga HASPA Bank Gjermani, që konfirmon gjendjen e Llogarisë në euro, në emrin Nedra Tola, në 30.12.2022, në shumën 1.103 euro.

Konstatohet

- ✓ **Deklarimi bazohet në dokumentacionin e dorëzuar. llogaria është hapur në dt. 5.12.2022 në Gjermani.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Të ardhura nga paga, kompania ***, Hamburg, Gjermani. Shuma 14.980 euro.
- Të ardhura nga paga, kompania ***GmbH, Hamburg Gjermani, janar 2023 — në vijim. Shuma 3.875 euro.

Hetimi administrativ

Në proces verbalin e datës 20.3.2024, të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga trupa e vlerësimit subjekti sqaroi se; “... *periudha e punësimit pranë kompanisë *** është nga data 15.11.2021 - 30.9.2022, me pagë neto rreth 1.248 euro/muaj, ndërsa pranë ***GmbH, është nga muaji janar 2023 e në vijim, me page bruto 2.900 euro dhe neto rreth 2.213 euro/muaj. Nga data 01.10.2022 - 31.12.2022, nuk ka qenë në marrëdhënie pune...*”

Subjekti paraqiti:

- Kontratë Pune, datë 15. 11. 2021, lidhur midis kompanisë "****, Hamburg Gjermani 20 " dhe Nedra Tola, paga mujore bruto 1.425 euro,.
- Kontratë e përhershme pune, datë 01.01.2023, lidhur midis kompanisë "****GmbH", Hamburg, Gjermani dhe Nedra Tola, paga mujore bruto 2.900 euro,.
- Listë pagesë e kompanisë "****", Hamburg, Gjermani 20 datë 08.12.2021, ku konfirmohen pagat neto 1.248 euro,.
- Listë pagesë e kompanisë "****, Hamburg, Gjermani 20", datë 15.07.2022, ku konfirmohen pagat neto 1.262 euro.

Konstatohet

- ✓ ***Të ardhurat e vajzës nga pagat, për periudhën nëntor 2021 — mars 2023, Llogariten rreth 18.180 euro.***

Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, subjekti Mithat Tola, ka deklaruar adresat:

- Njësia Administrative nr. 11, Rruga "Imzot Mark Sopi", Nr. ***, Tiranë. _
- *** ***, Hamburg, Gjermani.

Adresat e deklaruara, i përkasin shtëpisë së banimit në Tiranë, në b/pronësi të subjektit dhe babait të tij, si dhe apartamentit në Gjermani, në pronësi të b/shortes, trajtuar më sipër, në rubrikat përkatëse të deklaramit të pasurive.

Banka e Shqipërisë, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Banka e Parë e Investimeve, Union Bank Raiffeisen Leasing, Porche Leasing, Albania Leasing, Landesleasing, Raiffeisen Invest, Credins Invest, Unioni Financiar i Tiranës, AK Invest, Easypay, Pondi Besa, Institucioni Financiar NOA, lute Credit Albania, Kredo Finance, Konfirmojnë se subjekti Mithat Tola, dhe personat e lidhur me të nuk janë klientë të tyre, çka konfirmohet me deklaramin.

Drejtoritë dhe Zyrat Vendore te ASHK-se, dhe konkretisht: Librazhd, Mallakastër, Fier, Gjirokastrë, Devoll, Lushnje, Korçë, Berat, Pogradec, Kukës, Kavaje, Malësi e Madhe, Kuçovë, Kamzë Vorë, Puke, Peqin, Skrapar, Bulqizë, Has, Kolonie, Elbasan, Mirdite, Tropojë, Tepelene, Përmet, Mat, Shkodër, Sarandë, Krujë, Kurbin, Dibër, Lezhe, si dhe ASHK Online (përveç pasurive të konfirmohen më lart), nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme të regjistruara apo në proces legalizimi, në emër të subjektit dhe personave të lidhur.

BKT, me shkresë nr.41/3, date 14.08.2023, konfirmon se subjekti Mithat Tola, ne date 23.7.2008, ka hapur depozite ne shumën 10.000 euro. Në datë 07.08.2013 ka tërhequr cash shumën 7.000 euro dhe ne date 16.09.2013 ka mbyllur depozitën.

Konfirmohet gjithashtu llogari karte krediti me limit, ne shumen 100.000 leke, ne emër te subjektit.

Në proces verbalin e datës 20.03.2024, të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar subjekti sqaroi se; “...depozita ne shumën 10.000 euro është krijuar me burim kursimet nga të ardhurat familjare nga punësimi dhe aktiviteti privat në vite. Shuma 7.000 euro, në vitin 2013 është përdorur për shlyerjen e huas ndaj motrës se b/shortes...”

Konstatohet

- ✓ ***Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur burimin e krijimit të depozitës në shumën 10.000 euro, v. 2008, nga kursimet familjare ndër vite (trajtuar me sipër, në rubrikat përkatëse të të ardhurave), si dhe qëllimin e përdorimit të shumës 7.000 euro në v.2013. për shlyerjen e huasë ndaj motrës së b/shortes.***

Tirana Bank, me shkresë me nr. *** prot., datë 8.8.2023, konfirmon se: Mithat Tola, ka pasur të drejtë veprimi në llogarinë e shtetasit B.K . Arjola Tola, ka pasur të drejtë veprimi në llogarinë e subjektit Bordi i Shkollës së Mesme "****".

Në proces verbalin e datës 20.03.2024, të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar subjekti sqaroi se; “... llogaria në Tirana Bank është hapur dhe përdorur vetëm për transferimin e një shume për dëm shëndetësor, në favor të shtetasit G.M, i cili lidhi Prokurën e Posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., date 22.2.2012, ku emëroi përfaqësues të posaçëm "Qendrën e Studimeve të Sigurisë Rrugore", përfaqësuar nga Mithat Tola dhe B.K , për ndjekjen e të gjitha procedurave për aksidentin automobilistik, ndodhur në dt. 12.8.2009. Lidhur me të drejtën e veprimit të Arjola Tola në llogarinë subjektit "Bordi Shkollës së Mesme ""***", sqaroi se kjo e drejtë në cilësinë e kryetares së bordit të kësaj shkollë, si përfaqësuese e prindërve të nxënësve, bazuar në Vendimin nr. *** , datë 22.11.2022 dhe kuadrit ligjor për institucionet arsimore në Shqipëri.

Subjekti paraqiti;

- **Prokurë e Posaçme** nr. *** rep., nr. *** kol., date 22.02.2012, ku G.M, emëron përfaqësues te posaçëm "Qendrën e Studimeve të Sigurisë Rrugore", përfaqësuar nga Mithat Tola dhe B.K , për ndjekjen e të gjitha procedurave përkatëse për aksidentin automobilistik ndodhur në dt. 12.8.2009, ku është aksidentuar ky shtetas, plus praktika Mithat Tola dhe B.K , për ndjekjen e të gjitha procedurave përkatëse për aksidentin automobilistik ndodhur në dt. 12.8.2009, ku është aksidentuar ky shtetas, plus praktika;
- **Vendim** mbi përbërjen e Bordit të Shkollës, për vitin shkollor 2022 — 2023, me nr. *** prot., datë 21.11.2022, për ri ngritjen e Bordit të Institucionit arsimor ""***" ,që konfirmon se kryetare e këtij bordi është Arjola Tola.

Konstatohet

Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me konfirmimet nga Tirana Bank.

ProCredit Bank, me shkresë me nr. *** prot., datë 09.08.2023, konfirmon se Arjola Tola ka pasur Llogari rrjedhëse në lekë, për periudhën 07.05.2008 — 29.05.2009, me status: Anulluar.

QKB, me shkresë me nr. ***prot., datë 07.08.2023, konfirmon se shtetasit: Nedja Tola, Hera Tola, F.T, N.T, P.T dhe Sh.T, nuk figurojnë të jenë pajisur me NUIS (NIPT), si persona fizik apo të zotërojnë kuota/aksione në shoqëri tregtare të regjistruar pranë regjistrit tregtar.

DPT, me shkresë me nr.***prot., datë 07.08.2023, konfirmon se i ka kërkuar informacion D.R.Tatimore Tiranë, lënda: "Kërkim të dhënash", për të dërguar informacion pranë ILDKPKI, për subjekte të cilët janë administruar nga DRT Tiranë.

DRT Tiranë, me shkresën nr. ***prot., datë 17.8.2023, konfirmon se shtetasit: Nedja Tola, Hera Tola, F.T, N.T, P.Tdhe Sh.T, nuk figurojnë të regjistruar në organet tatimore, për ushtrim të ndonjë aktiviteti privat.

Drejtoria e Përgjithshme Detare, me shkresën nr. *** , datë 11.08.2023, nuk konfirmon mjete lundruese në pronësi të Mithat Tola dhe personave të lidhur.

Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruar dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruar, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesave, u bë analiza e të dhënave të deklaruar nga

subjekti me informacionet e ardhura nga institucionet e specializuara, proces nga i cili, në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se;

- ✓ Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, pasuria totale deri në datë 8.3.2023, është deklaruar bruto 6.247.548 lekë + 250.539 euro, e konvertuar rreth 35.045.000 lekë dhe neto rreth 30.218.000 lekë.
- ✓ Të ardhurat e subjektit nga pagat, shpërblimet, mësimdhënia, etj., për periudhën mars 1995 - mars 2023, janë në vlerën totale rreth 18.970.000 lekë.
- ✓ Të ardhurat e subjektit nga aktiviteti privat, për periudhën mars 2008 - qershor 2014, janë në vlerën 10.166.000 lekë + 5.880 euro, e konvertuar rreth 10.842.00 lekë.
- ✓ Të ardhurat e b/shortes nga pagat, shpërblime, etj., për periudhën shkurt 2000 - mars 2023, janë në vlerën totale rreth 23.641.000 lekë.
- ✓ Të ardhurat e b/shortes nga aktiviteti privat, për periudhën 2011 - 2022, janë në vlerën totale rreth 27.870.000 lekë.
- ✓ Të ardhurat e b/shortes nga qiraja e apartamentit në Gjermani, për periudhën mars 2021 shkurt 2023, janë në vlerën 11.100 euro, e konvertuar rreth 1.276.000 lekë.
- ✓ Të ardhurat e vajzës nga pagat, për periudhën nëntor 2021 — mars 2023, janë në vlerën 18.180 euro e konvertuar rreth 2.090.000 lekë.

Gjithashtu, janë deklaruar dhe përdorur si burim:

- Të ardhura nga pagat e subjektit për periudhën 1988 - 1998, rreth 763.000 lekë.
- Të ardhura nga aktiviteti privat i subjektit për periudhën 1993 - 1995, rreth 1.168.000 lekë.
- Hua në shumën 108.000 euro. Detyrimi i mbetur 42.000 euro, e konvertuar rreth 4.827.000 lekë.
- Të ardhura nga shitja e apartamentit me adrese Kashar - Tiranë (blerë 47.880 euro/shitur 76.000 euro) në shumën 28.120 euro, e konvertuar rreth 3.232.000 lekë.
- Huamarrje në shumën 50.000 euro, e konvertuar rreth 6.089.000 leke. (Shlyer).

Për periudhën 01.01.2000 - 08.03.2023, referuar treguesve statistikorë të INSTAT, janë shpenzuar minimalisht për konsum familjar, rreth 13.628.000 lekë.

- Për periudhën shtator 2017- dhjetor 2020, janë shpenzuar për jetesën e vajzës në Gjermani, gjatë studime të larta në Universitet Publik, rreth 25.872 euro, e konvertuar rreth 2.974.000 lekë, ndërsa për periudhën maj 2022 — mars 2023, shpenzimet për ushqim rreth 2.400 euro, e konvertuar rreth 276.000 lekë.
- Për periudhën 01.01.2022 — 31.12.2022, janë shpenzuar për ujë, drita, telefon dhe internet, në Shqipëri, rreth 218.000 lekë.
- Për periudhën 01.01.2022 — 31.12.2022, janë shpenzuar për ujë, drita, telefon, internet, etj., për apartamentin në Hamburg, Gjermani rreth 4.095 euro, e konvertuar rreth 471.000 lekë.
- Për periudhën 01.01.2020 — 31.12.2022, janë shpenzuar për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar, në total 11.500 euro, e konvertuar në shumën rreth 1.322.000 lekë.
- Për periudhën deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, janë shpenzuar për arsimin e fëmijës, rreth 850.000 lekë.

- Për periudhën deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, janë shpenzuar për mobilim, në total 5.250 euro + 390.000 lekë, e konvertuar rreth 993.000 lekë.
- Për periudhën deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, janë shpenzuar për trajtim mjekësor nga b/shortja, rreth 128.000 lekë.

✓ **Në përfundim të hetimit të kryer:**

Trupa e vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, ka analizuar dhe verifikuar të dhënat e mbledhura nga institucionet e ndryshme dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar, në vlerësimin përfundimtar, bazuar në parimin e kontradiktorialitetit u mbështet edhe në shpjegimet që dha subjekti pas dërgimit të relacionit si dhe ato në seancën dëgjimore dhe në përfundim arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit:

- **Ka bërë deklaram të saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;**
- **Nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;**
- **Nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- **Nuk është kryer deklaram i rremë;**
- **Subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit**

B. KONTROLLI I FIGURËS

Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.”

✚ Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre element:

1. Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
2. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
3. Verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, germa (ë), e ligjit 12/2018, i ndryshuar.

✚ Trupa e Vlerësimit ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të vlerësimit z. **Mithat Fari Tola** me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë së deklarimeve si dhe të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar.

✚ **Për kontrollin e figurës Trupa e vlerësimit administroi:**

- a. Deklaratën e “Kontrollit të Figurës”
 - b. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
 - c. Korrespondencën me institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë.
- ✚ Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore si organ ndihmës, në përputhje me nenin 42 të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, për vlerësimin e kontrollit të figurës ka dorëzuar nëpërmjet shkresës Nr.*** datë 05.02.2024 raportin e kontrollit të figurës² ku ka konstatuar se:
- ✚ **Për subjektin e vlerësimit Drejtues Mithat Fari Tola j, me detyrë Drejtor, Kolegji Profesional i Formimit Policor, në Akademinë e Sigurisë, dhe "personave të lidhur", nuk administrohen të dhëna, fakte apo prova, që punonjësi është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, apo që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar .**

Në deklaratën e Kontrollit të Figurës subjekti ka deklaruar se:

- Nuk është njohur nga të tjerët me ndonjë nofkë, emër apo mbiemër tjetër nga ai që ka patur apo ka regjistruar në gjendjen civile.
- Nuk ka pasur apo ka shtetësi tjetër.
- Nuk ka qenë asnjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligj zbatuese shqiptare apo të huaja për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk ka është caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo.
- Nuk është lëshuar asnjëherë ndaj tij një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Nuk është marrë asnjëherë ndaj tij masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- Subjekti ka deklaruar që nuk ka dijeni se ndonjë nga anëtarët e familjes së tij bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët, bashkëjetuesi/t si dhe personat e përfshirë në certifikatën familjare) është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës së subjektit.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar
- Subjekti nuk është në dijeni që një nga anëtarët e familjes së tij të kenë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.

² Raporti mbi kontrollin e figurës nr.***** datë 05.02.2024

- Nuk ka dijeni se një person i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s gjatë 10 viteve të fundit.
- Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas neneve të ligjit për garantimin dhe integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- Nuk ka fshehur apo keq prezantuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre sigurie të veçantë apo të ketë gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
- Nuk ka kryer shkelje sigurie, apo të ketë nëpërkëmbur në mënyrë të përsëritur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, apo të ketë tentuar të kryej aktivitet të paautorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
- Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
- Nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- Nuk ka pasur asnjëherë varësi ndaj alkoolit apo lojërave të fatit
- Nuk ka vuajtur nga çrregullime mendore kronike
- Nuk ka qenë asnjëherë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish- Sigurimi i Shtetit para vitit 1990, sipas ligjit nr. 45/2015 “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish – shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
- Nuk ka pasur emër apo mbiemër tjetër më parë.

Po ashtu, subjekti ka nënshkruar edhe dy vetdeklarimet për vërtetësinë e të dhënave dhe saktësinë e tyre të paraqitura në deklaratën e kontrollit të figurës si dhe deklaratën për dhënien e pëlqimit për mbledhjen e të dhënave, kryerjen e kontrollit të figurës dhe aksesin për njohjen dhe administrimin e të dhënave personale.

Hetimi administrativ:

Për të vijuar me kontrollin tërësor të figurës dhe saktësinë e deklaratimit të subjektit të vlerësimit lidhur me këtë aspekt, në bazë të nenit 36 dhe 37, të Ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, janë kryer veprimet e tjera duke kërkuar të dhëna nga institucionet përgjegjëse, të shprehura në këtë ligj si më poshtë:

- **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile** me shkresën nr.***. Prot, dt. 15.08.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Mithat Fari Tola j, bën me dije se:
Është shpërngulur nga ZGjC Peshkopi në ZGjC Gramsh, sipas Rregjistrit Themeltar “”Xhile Lici””, 05/7- ref. Në ZGjC Gramsh **babai**, shtetasi Fari Tola, **ka ndryshuar datëlindjen** nga 30.09.1939 në 30.01.1934, si dhe emrin nga Tahir në Fari, rubrikë e cila është pasqyruar edhe tek shtetasi Mithat Tola.
- Nuk ka ndryshim të gjeneraliteteve të subjektit të vlerësimit Z. Mithat Fari Tola.

- **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve**, me shkresën nr. ***. Prot, dt. 09.08.2024 për subjektin e vlerësimit Z. Mithat Fari Tola j, bën me dije se:
 - Nuk rezulton i dënuar.

- **Institucionet Ligjzbatuese**, me shkresën nr. ***, prot, dt. 16.08.2023 informojnë se për subjektin e vlerësimit Mithat Fari Tola dhe personat e lidhur me të disponojnë informacione.
 - Këto të dhëna nuk vërtetojnë/ dokumentojnë implementimin e tij
 - E dhëna nuk ka vijueshmëri, nuk është sqaruar/thelluar dhe vërtetimi më tej.
 - Nuk disponohen të dhëna të tjera.

- **Institucionet Ligjzbatuese**, me shkresën nr. ***, prot, dt. 24.08.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Mithat Fari Tola, si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, **nuk kanë:**
 - Të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cënimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta;
 - Të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në *krimin e organizuar*, (sipas përcaktimeve të bëra në ligjin Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”) ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike, etj.;
 - Të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona (*persona të dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të Ligjit nr. 10 192, dt. 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar*);
 - Të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një vepre penale;
 - Të dhëna në lidhje nëse ka qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një vepre penale;
 - Të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhër ndërkombëtar, për kryerjen e një vepre penale;
 - Të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj;
 - Të dhëna në lidhje nëse gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATOS-s;
 - Të dhëna nëse nga subjekti është kërkuar azil politik në ndonjë shtet,

- **Institucionet Ligjzbatuese**, me shkresën nr. ***, prot, dt. 31.10.2023, dhe me nr. ***, prot. dt. 05.02.2024, informojnë se për subjektin e vlerësimit Mithat Fari Tola **nuk**:
 - Është nxjerrë urdhër ndalimi;
 - Është kërkuar masë e sigurimit personal dhe nëse po, vlerësimi i tyre nga gjykata;
 - Është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale;
 - Ka pasur regjistrim të njoftimit të veprave penale;
 - Ka pasur raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit.

- **Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes**, me shkresën nr.***. Prot, dt. 11.08.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Mithat Fari Tola j bën me dije se:
 - Nuk disponon të dhëna.

- **Agjencia e Mbikëqyrjes Policore**, për subjektin e vlerësimit Z. Mithat Fari Tola dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se:
 - Nuk ka procedime penale të referuara;
 - Për subjektin e vlerësimit nuk disponohen ankesa, të dhëna ose informacione që lidhen me objektin e kërkesës.

- **Prokuroria e Përgjithshme**, me shkresën nr.***. Prot, dt. 31.10.2023, dhe me shkresën nr.***. Prot, dt. 04.03.2024 për subjektin e vlerësimit Z. Mithat Fari Tola, bën me dije se, **nuk**:
 - Është nxjerrë urdhër ndalimi;
 - Është kërkuar masë e sigurimit personal dhe nëse po, vlerësimi i tyre nga gjykata;
 - Është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale;
 - Nga verifikimet e kryera në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për shtetasin Mitat Tola, rezulton të jenë regjistruar kallëzimi nr. 10531, viti 2020 dhe kallëzimi nr. 2285, viti 2020 ku është vendosur "*Për mosfillimin e procedimit penal*".
 - Nuk ka pasur raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit.

- **Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave**, me shkresën nr.***, Prot, dt. 14.08.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Mithat Fari Tola j dhe personat e lidhur me të sipas certifikatës familjare, bën me dije se:
 - Rezultuan raportime për subjektin e vlerësimit Z. Mithat Tola me sipas Aneks I, bashkëlidhur,
 - Nuk rezultuan raportime për personat e lidhur Arjola Tola.

- **Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar**, me shkresën nr.***, Prot, dt. 15.08.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Mitat Tola , bën me dije se:
 - Nuk është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), të vlefshme.
 - Nga AKSIK nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP.
 - AKSIK nuk disponon rekorde për Shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror", të NATO, BE, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.
 -

- **Avokati i Popullit**, me shkresën nr.***, Prot, dt. 14.08.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Mitat Tola , bën me dije se:
 - Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.
 - Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.

- **Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit**, me shkresën, nr.***, Prot, dt. 24.11.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Mithat Fari Tola j, bën me dije se:
 - Nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri 2 Korrik 1991.

Në vlerësim të të dhënave që disponohen për subjektin e vlerësimit rezulton se:

Në deklaratën e Kontrollit të Figurës subjekti i vlerësimit z. Mithat Tola, ka pasqyruar se ka shtetësi Bullgare dhe me dekret të Presidentit të Republikës Bullgare është pajisur me pasaportë në vitin 2020. (Dekreti Nr.96 datë 18.06.2020 i Presidencës Bullgare në bazë të miratimit të aplikimit m. 122239/2017.

Nga analizimi i kallëzimit referuar pranë Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, më datë 31.10.2023, kallëzimi penal, referuar për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës" parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, më datë 24.09.2020 është marrë vendim për mosfillimin e procedimit penal.

Nga analizimi i kallëzimit referuar pranë Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me nr. 2285 viti 2020, kallëzimi penal, referuar për veprën penale "Ekspertim i rremë " parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal, më datë 18.02.2020 është marrë vendim për mosfillimin e procedimit penal

Për subjektin e vlerësimit Z. Mithat Fari Tola, me detyrë Drejtor, Kolegji Profesional i Formimit Policor, në Akademinë e Sigurisë dhe "personave të lidhur", nuk administrohen të dhëna, fakte apo prova, që punonjësi është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, apo që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar. (Sipas nenit 39 të ligjit nr. 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme I ndryshuar.)

Testi për përdorim lëndësh narkotike:

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38 të Ligjit 12/2018, të ndryshuar, ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara testimi për përdorim lëndësh narkotike, kolaudohet se subjekti vlerësimit **Z. Mitat Tola :**

Me shkresë nr. ***, prot., dt. 11.01.2024, protokolluar me nr. ***, prot., dt. 15.01.2024, Instituti i Mjekësisë Ligjore ka dërguar dokumentacionin përkatës, analizuar dhe vlerësuar nga Trupa e Vlerësimit, konkretisht:

- Akt Ekspertimi Toksikologjik – Ligjor nr. ***, dt. 11.01.2024, për subjektin e vlerësimit Mithat Fari Tola;
- Deklaratë Eksperti

Në bazë të rezultateve të përfituara nga ekspertiza toksikologjike për përdorim lëndësh narkotike, konkludohet se subjekti vlerësimit Z. Mitat Tola , aktualisht nuk rezulton përdorues i lëndëve narkotike.

Denoncimet nga publiku

Denoncimet nga publiku Nga verifikimet e kryera nga Trupa e Vlerësimit, rezulton se nuk ka informacione të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin, veprimtarinë e subjektit të vlerësimit apo të personave të lidhur me të.

Në përfundim të hetimit të kryer:

Trupa e vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pas një hetimi të thelluar të kontrollit të figurës për subjektin e vlerësimit Mithat Tola, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, analizimit dhe verifikimit të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjensitë ligjzbatuese, vlerësimit të testit për përdorim lëndësh narkotike, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar, arriti në konkluzionin se:

Subjekti i vlerësimit z. Mithat Tola:

- *Ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;*
- *Nuk ka informacion në deklarimin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.*

C . VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të “Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.

Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:

- të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
- raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore/standartet profesionale në Policinë e Shtetit, dërguar me shkresën nr. 36/11 prot., datë 05.07.2023, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, ligjit 12/2018, i ndryshuar

Subjekti i vlerësimit **Z. Mithat Tola** në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin e “Drejtor, Kolegji Profesional i Formimit Policor, në Akademinë e Sigurisë, . . ”

Periudha e vlerësimit në zbatim të nenit 44 pika 2 të ligjit 12/2018 i ndryshuar është periudha 5-vjeçare (2018-2022). Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale do të shkrihet brenda këtij harku kohor.

C/1 RAPORTI I VLERËSIMIT PROFESIONAL POLICIA E SHTETIT.

Struktura e burimeve njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit si organ ndihmës për vlerësimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin nr.12/2018 i ndryshuar ka dorëzuar nëpërmjet shkresës nr. ***, datë 01.09.2023, raportin e vlerësimit profesional është shprehur me Konkluzion përfundimtar si më poshtë vijon:

“Punonjësi i Policisë z. Mithat Fari Tola j është i përshtatshëm për pozicionin e tij të punës, ka arsimin dhe trajnimet përkatëse për funksionin që mban, ka treguar cilësi të pranueshme në punë, aftësi në zbatim të detyrave sipas përshkrimeve të punës, ka

respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, është i frytshëm dhe efektiv në masë të pranueshme duke rezultuar i kualifikuar për të ushtruar funksionin që mban”.

C/2 HETIMI I TRUPËS SË VLERËSIMIT PRANË AGJENCISË SE MBIKËQYRJES POLICORE:

Trupa e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në përputhje me ligjin e vlerësimit si dhe ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar, ka zhvilluar një hetim administrativ të plotë dhe të bazuar në fakte dhe prova duke u bazuar në:

- Të dhënat e administruara në dosjen personale të subjektit;
- Të dhënat e administruara në sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale sipas përcaktimeve të nenit 44 pika 1 të ligjit nr.12/2018 i ndryshuar.
- Të dhënat e siguruar nga Drejtoria e Standardeve Profesionale mbi performancën e subjektit.

Punonjësi i Policisë, Drejtues Mithat Fari Tola j është i emëruar në detyrë “Drejtor, Kolegji Profesional i Formimit Policor, në Akademinë e Sigurisë.

Në zbatim të ligjit 12/2018 i ndryshuar, funksioni që mban Z. Mitat Tola e bën atë subjekt të ligjit sipas nenit 6.

Në zbatim të ligjit 12/2018 i ndryshuar, funksioni që mban z. Mithat Tola e bën atë subjekt të ligjit sipas nenit 6.

Hetimi i zhvilluar nga Trupa e Vlerësimit mbi nivelin e arsimit në përputhje me nenin 43-45 të ligjit 12/2018 i ndryshuar.

Bazuar në vetë deklarinimin e subjektit Mitat Tola, janë marrë të dhënat si më poshtë:

1. Arsimi

Niveli i arsimit	Institucioni ku janë ndjekur studimet	Fillimi	Përfundimi	Vendi	Titulli/Diploma
DND	Universiteti Tiranës Fakulteti Inxhinieri Mekanike elektrike	1983	1988	Tirane	Diplome
Master	Fakulteti Ekonomisë Shkolle 2 vjeçare pasuniversitare	2004	2006	Tirane	Diplome
Kurs 4 mujor	Për formimin Profesional te Punonjësve te Policisë Roli mesëm. (Akademia e Policisë)		2005	Tirane Sauk	Dëshmi

Trupa vlerësuese konstaton se,

- ✓ Trupa e vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore administroi nga dosja e subjektit të vlerësimit diplomën me nr. serie 1280.
- ✓ Në kuptim të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” të ndryshuar, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar punonjësi/subjekti përmbush kriterin e nivelit arsimor për funksionin që mban pranë Policisë së Shtetit, në momentin e dorëzimit të deklaratës së vlerësimit të aftësive profesionale.

2. Ecuria në karrierë

Nga verifikimi i të dhënave të deklaramit të subjektit të vlerësimit, raportit të vlerësimit profesional nga Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, subjekti i vlerësimit Mitat Tola ka një karrierë në Policinë e Shtetit prej 23 vitesh e 5 muaj. Nga verifikimi në dosje personale rezulton se gjatë periudhës 5-vjeçare objekt deklarimi, subjekti mban:

Data e fillimit		Data e përfundimit		Institucioni	Funksioni	Emri dhe mbiemri i punëdhënësit apo eprorit të drejtpërdrejtë	Adresa e plotë e institucioni	Arsyet largimi
Muaji	Viti	Muaji	Viti					
08.07.2022		Aktualisht		Akademia e Sigurisë	Drejtor	Prof. Doktor Ilir Mandro	Sauk Tirane	Pune
15.11.2021		07.07.2022		Akademia e Sigurisë	Profesor, Departamenti Ruajtjes dhe Sig.	Ilir Mandro, Ilia Nasi	Sauk Tirane	Pune
29.10.2021		14.11.2021		Akademia e Sigurisë	Lektor Departamenti Hetimit te krimet. Ak.Sig.	Prof-Doktor Ilir Mandro Ilia Nasi	Tirane Sauk	
30.09.2019		28.10.2021		DPP	Shef sektori Analizes dhe planif.Drejt. Pol.Rrugore	E.Tarkaj Gj.Loka N.Nallbati	Tirane	
25.05.2017		29.09.2019		DPP	Drejtor Drejtorja Policise Rrugore	Altin Qato GJ.Loka	Tirane	

- Gradën “Drejtues i Parë”

Emërtimi i gradës	Arsyeja e ndryshimit	Nr. Urdhrit	Data	
			Nga	Deri
Kryekomisar	Ripranuar në polici	2283/2 date 31.10.2013	01.10.2013	31.05.2014
Drejtues	Ricertifikuar për gardë policore	Nr. 1704 date 02.06.2014	01.06.2014	20.05.2024
Drejtues i Parë	Ngritje në gradë	Nr. 1591 date 21.05.2024	21.05.2024	

Trupa vlerësuese konstaton se:

- ✓ Subjekti i vlerësimit, Mitat Tola është transferuar dhe emëruar në pozicionin aktual me Urdhër nr.806/3, dt. 09.12.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
- ✓ Me urdhër nr. 1591 datë 21.05.2024, “Për dhënien e gradës policore një punonjësi policie”, bazuar në ligjin nr.108/2014,i ndryshuar të Policisë së Shtetit dhe Rregullores së Policisë së Shtetit, të ndryshuar subjektit të vlerësimit i është dhënë grada policore “Drejtuesi Parë”.
- ✓ Sipas deklarimeve të vetë subjektit dhe vërtetimeve që ka sjellë, ai ka një karrierë në Policinë e Shteti rreth 23 vite e 5 muaj.

3. Trajnime / Kualifikime

- ✚ Trupa e vlerësimit pas administrimit të dosjes së personelit, raportit të vlerësimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, konstatoj se gjatë periudhës 5 vjeçare të vlerësimit në zbatim të ligjit 12/2018 i ndryshuar.

	Viti	Emërtimi i trajnimit	Lloj i dokumentit
1	2018	TAIEX workshop on Accrediation of road Traffic Management system certification Bodies	Certifikatë
2	2018	Për pranimin e normave dhe kritereve për përdorimin e pajisjeve rrugore	Certifikatë
3		Programi Intensiv i Gjuhës Angleze	Certifikatë
4	2018	Rishikimi i Sigurisë Rrugore	Certifikatë
5	2018	Sistemi i menaxhimit të sigurisë rrugore dhe trupat certifikuese	Certifikatë
6	2021	Kategorizimi i sigurisë rrugore (RSP) në rrjetin rrugor të ARRSHA	Certifikatë
7	2022	Standardet evropiane të kërkimeve shkencore dhe botimeve të tyre	Certifikatë

4. Vlerësimet e Punës.

Sipas të dhënave të administruara në dosjen personale , pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit si dhe verifikimeve në sistemin RMIS, subjekti për periudhën 2018-2023 objekt verifikimi ka rezultuar:

Bazuar në informacionin e marrë nga institucionet lidhur me “Vlerësimin e rezultateve individuale të punës”, sipas viteve ka rezultuar si më poshtë:

- | | | |
|---|---------|------------|
| • Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2018 | 28 pikë | Shumë mirë |
| • Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2019 | 27 pikë | Shumë mirë |
| • Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020 | 28 pikë | Shumë mirë |
| • Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021 | 28 pikë | Shumë mirë |
| • Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2022 | 92 pikë | Shumë mirë |

Në vlerësimet e mësipërme vlen të theksojmë së në periudhën 2018 — 2021 vlerësimi maksimal i punonjësve sipas formularit të vlerësimit ishte me 28 pike, ndërkohë nga Viti 2022 e në vazhdim vlerësimi maksimal është 100 pike.

Vlerësimi i aftësive individuale të punës sipas standardeve të përcaktuara bëhet nga eprori i drejtpërdrejtë, bazuar në vlerësimin e integritetit, profesionalizmit, komunikimit, qëndrimit konstruktiv, paanshmërisë, punës në grup si dhe planifikimit dhe organizimit të punës.

5. Masa Disiplinore

Nga verifikimet në dosjen personale si dhe në sistemin RMIS, rezulton se gjatë periudhës 5 vjeçare, (2018-2023) të përcaktuar në pikën 2 të nenit 44 të ligjit 12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit, nuk është ndëshkuar disiplinarisht me masë disiplinore.

- ✚ Hetimi i zhvilluar nga Trupa e Vlerësimit mbi ecurinë në karrierë të subjektit të vlerësimit në përputhje me nenin 43-45 të ligjit 12/2018 i ndryshuar.

✚ Në përfundim të hetimit të kryer:

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi kreu një hetim të thelluar për vlerësimin e aftësive profesionale, nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit, vlerësimin e përmbushjes së detyrave funksionale dhe respektimin e rregullave të etikës në ushtrimin e detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, arrin në konkluzionin se:

Subjekti i vlerësimit Mithat Tola:

- ✓ Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;
- ✓ Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban;
- ✓ Ka vlerësime pozitive pune.

Konkluzione përfundimtare:

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të vlerësimit, relacionin e relatores së çështjes, shpjegimet me shkrim të dhëna nga subjekti i vlerësimit gjatë hetimit administrativ, si dhe pasi u njoh me qëndrimin e subjektit të vlerësimit në seancën dëgjimore publike të datës 27.12.2024, ftoj subjektin në seancën e dhënies së vendimit të datës 20.01.2025, dhe arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, z. Mithat Fari Tola , në përputhje me nenin 60 të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- *Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;*
- *Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës;*
- *Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.*

PËR KËTO ARSYE

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në bazë të germës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar;

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit Mithat Tola, me funksion aktual Pedagog, në Departamentin e Ruajtjes dhe Sigurisë Publike, në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, në Akademinë e Sigurisë
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Ky vendim u shpall sot datë 20.01.2025, në Tiranë.

Ky vendim u shpall në Tiranë, sot datë 20.01.2025.

KRYESUES

HENRI NAQELLARI

RELATOR

EDONA DUSHAJ

ANËTAR

ORNELA DYLI